

QYTETE **MË TË MIRA**
PËR **KOSOVËN**



VIZIONIMI

VIZIONIMI SI MJET I PLANIFIKIMIT PJESËMARRËS
TË MËSUARIT NGA PRAKTIKAT E KOSOVËS

PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION



SWEDEN

NJOFTIM

Emërtimet e përdorura dhe prezantimet e materialit në këtë botim nuk paraqesin shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të ndonjë shteti, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve të tij, apo në lidhje me caktimin e kufijve apo kufijve të tij administrativ, apo në lidhje me sistemin e tij ekonomik apo nivelin e zhvillimit. Analizat, konkluzionet dhe rekomandimet e raportit nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore, të Këshillit Drejtues të Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore apo të Shteteve Anëtare të tij.

Për UN-Habitat, të gjitha referencat për Kosovën janë bërë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).

E drejta e autorit © Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat), 2012

HS Nr.: HS/084/12

ISBN Nr.: 978-92-1-132498-3

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat)

PO Box 30030, Nairobi 00100, Kenya

Tel: +254 20 7623120;

Fax: +254 20 76234266/7 (Zyra qendrore)

infohabitat@unhabitat.org

www.unhabitat.org

FALËNDERIMET

Fotografitë e paraqitura në këtë dokument përshkruajnë aspekte të ndryshme të punës së UN-Habitat-it në Kosovë. Për të gjitha fotografitë e drejta e autorit është me © UN-Habitat-in në Kosovë, përveç nëse është specifikuar ndryshe në tekst. Fotografitë mund të riprodhohen nëse burimi është i është shtypur me fotografinë.

Teksti dhe materialet ilustruese janë përgatitur nga Frank D'hondt. Ai shërbeu si Koordinator i Planifikimit Hapësinor në Programin e parë për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal të implementuar nga UN-Habitat-i. Në vitin 2009 ai u bë këshilltar për politika në Zyrën Civile Ndërkombëtare në Kosovë, me fokus në planifikim hapësinor dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Gjatë karrierës së tij, Frank D'hondt ka vepruar gjithashtu si kryetar i Shoqatës Flamane të projektuesve hapësinor, si dhe Zëvendës-kryetar i Këshillit Evropian të Planifikuesve Hapësinor (ECTP).

Anëtarët e mëposhtëm të bordit recensues kanë kontribuar në tekstin e përmbajtur në këtë broshurë: Krystyna Galezia (Shefe e zyrës së UN-Habitat-it në Kosovë), Arijeta Himaduna (UN-Habitat Kosovë), Crystal Whitaker (Trashëgimia Kulturore pa Kufij), Besa Luzha (Fondacioni Friedrich-Ebert në Kosovë).

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë financohet nga Qeveria e Suedisë përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Aktivitetet e paraqitura janë mbështetur edhe nga shumë donatorë dhe organizata partnere, të cilëve ju falënderojmë në mënyrë kolektive për mbështetjen e tyre.

Dizajni dhe faqosja: Rrota

QYTETE

MË TË MIRA

PËR

KOSOVËN

VIZIONIMI

VIZIONIMI SI MJET I PLANIFIKIMIT PJESËMARRËS
TË MËSUARIT NGA PRAKTIKAT E KOSOVËS

PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



SWEDEN

PARATHËNIE



Ligji mbi Planifikimin Hapësinor, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2003, i ka bërë komunat përgjegjëse, për hartimin e planeve zhvillimore lokale dhe urbane, si dhe përcaktimin e vizionit të tyre strategjik.

Mirëpo, për shumë komuna kjo detyrë ishte e vështirë për t'u zbatuar sepse atyre u mungonte përvoja paraprake si dhe për arsye se shumica e stafit nuk kishte kryer trajnimet e nevojshme. Kjo gjendje ishte rënduar akoma më shumë nga problemet e lidhura me konfliktin ushtarak të vitit 1999.

Në përgjigje të kërkesave ligjore, disa komuna kishin angazhuar konsulentë. Të tjerat filluan hartimin e planeve të tyre me mbështetjen e UN-Habitat-it, dhe së fundi edhe me mbështetjen e organizatave tjera donatore. Megjithatë, sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë, prej gjithsej 37 komunave, 13 sish ende kanë ngelur pa këto mjete udhëzuese.

Prej vitit 2001, UN-Habitat-i ka bashkëpunuar ngushtë me komunat e Kosovës duke i ndihmuar ato në ngritjen e kapaciteteve të tyre për këtë detyrë, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës. Prezenca e UN-Habitat-it me vite, mundësoi trajnimin e zyrtarëve komunalë për planifikim strategjik dhe po ashtu mundësoi sigurimin e asistencës në vendin e punës në adresimin e detyrave të planifikimit.

Rishtazi, në bazë të Programit për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor në Komuna, UN-Habitat-i ka marrë një detyrë ambicioze për mbështetjen e komunave partnere më të vogla në hartimin e planeve komunale dhe atyre urbane duke i përdorur burimet e brendshme dhe duke promovuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje në procesin e planifikimit.

Kjo punë nënkupton përvojën shumëvjeçare të UN-Habitat-it dhe bashkëpunimin me partnerët në organizimin e punëtorive për një numër të komunave të Kosovës. Të dhjetë punëtoritë e organizuara deri në kohën e publikimit të këtij dokumenti, e thyen stereotipin e të menduarit se planifikimi urban dhe ai hapësinor ishin aktivitete krejtësisht teknike, të rezervuara vetëm për profesionistët. Pra, erdhi deri te një pranim i ideve që vinin prej njerëzve të rëndomtë, qytetarët – të vjetër e të rinj, burra dhe gra, me aftësi dhe me aftësi të kufizuara.

Këtu kemi paraqitur një kombinim të analizës së planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë, vrojtimet dhe mësimet e nxjerra nga punëtoritë e organizuara nëpër komunat e Kosovës dhe përmbledhjen e mjeteve të planifikimit, ushtrimeve dhe ideve për fasilitatorët e interesuar për testimin e kësaj metode në punën e tyre.

Ky publikim është dizajnuar për të frymëzuar gjeneratën e re të planerëve nga Kosova dhe të aktivistëve të shoqërisë civile. Po ashtu do t'i ndihmojë edhe publikut në një rrafsh më të gjerë për të pasur qyteza dhe qytete më të mira, më të bukura, më të gjelbëruara, dhe më të sigurta, të cilat do të ofrojnë mundësi të barabarte për të gjithë qytetarët.

Dr. Joan Clos

Nënskretar i Përgjithshëm, Kombet e Bashkuara,
Drejtor Ekzekutiv, UN-Habitat

PËRMBAJTJA

Parathënie	2
Hyrje	4
Kapitulli 1. Planifikimi në tranzicion	5
Kapitulli 2. Vizioni	13
Kapitulli 3. Mekanizmi i vizionimit	19
Kapitulli 4. Vizionimi në praktikë – Përvoja nga Kosova	27
Kapitulli 5. Rezultatet e vizionimit	35
Kapitulli 6. Mësimet e nxjerra për vizionimin e ardhshëm	39
Kapitulli 7. Perspektiva për te ardhmen	43
Fjalorthi	46
Shtojca 1. Partnerët në vizionim	55
Shtojca 2. Nevoja për dizajn urban në Kosovë	56
Shtojca 3. Parimet udhëzuese për planifikim dhe vizionim nga komuniteti	57
Shtojca 4. Shembull i praktikës së mirë 1: ‘Spoor Noord’ në Antwerp/Belgjikë	60
Shtojca 5. Vizioni i planerëve evropianë	61
Shtojca 6. Planifikuesi është...	62
Shtojca 7. Pasqyrë e shkurtë për Kosovën	63
Shtojca 8. Format i punëtorive të vizionimit	65
Shtojca 9. Punëtorja	67
Shtojca 10. Hapat e vizionimit	70
Shtojca 11. Shoqëria civile për vizionimin	71
Shtojca 12. Vënia e vizionimit në veprim: ‘Demo-projektet’ dhe ‘Projektet e Investimeve Kapitale’	72
Shtojca 13. Shembull i praktikës së mirë 2: Juniku: Fshat malor unik me ambicie të larta	74
Shtojca 14. Shembull i praktikës së mirë 3: Mitrovica: Qytet i ndarë me vizion të përbashkët	75
Shtojca 15. Shembull i praktikës së mirë 4: Hani i Elezit -Vizionimi si ndërmjetësim dhe shtytje	77
Shtojca 16. “Charrette” Punëtorja për planifikim: Vizionimi i avancuar	78
Shtojca 17. Shtëpia e vizionimit	80
Shtojca 18. Termet e referencës për Këshillin Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile	82

HYRJE

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë në vitin 1999, UN-Habitat-i ka promovuar qeverisjen e mirë, sigurinë e pronësisë, vendbanime të qëndrueshme dhe planifikim hapësinor gjithëpërfshirës në Kosovë dhe më gjerë në rajon. Ndërhyrjet e UN-Habitat-it ishin përqendruar në themelimin e institucioneve që do të merreshin me pronë dhe planifikim, si Drejtoria për Banim dhe Çështje Pronësore, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Instituti për Planifikim Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Intervenimet tjera ishin drejtuar drejt ngritjes së kapaciteteve për menaxhimin efikas të qeverive lokale përmes programeve për ngritje të kapaciteteve dhe mbështetje në vendin e punës: Programi për Qeverinë Lokale, dhe Programi për Mbështetje të Komunave (2000-2001), Programi për Planifikim Urban dhe Menaxhim (2001-2003), Programi për Qeverisje dhe Planifikim Zhvillimor (2003-2006), Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikimin Hapësinor (2005-2011) dhe Programi aktual për Mbështetjen e Komunave në Planifikimin Hapësinor. Fillimisht, programet janë financuar nga Qeveria e Holandës, ndërsa Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikimin Hapësinor financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

UN-Habitat-i filloi me punëtoritë në fillim të vitit 2007 për të gjeneruar idetë ,me bazë nga komuniteti, për një planifikimin urban dhe hapësinor afatgjatë dhe afatshkurtër si një ushqim (input) për Planet Zhvillimore Urbane dhe Komunale dhe zba-

timin e tyre. Punëtoritë ishin dizajnuar si një bashkëpunim tre-drejtimesh duke përfshirë komunën, shoqërinë civile , dhe UN-Habitat-in si facilitator. Shumë punëtori ishin bashkë-organizuar me grupet që punojnë në Kosovë, *Trashëgimia Kulturore pa Kufij* “*Cultural Heritage without Borders*” dhe të bashkëfinancuara nga *Fondacioni Friedrich-Ebert*. Gjithësej janë organizuar 10 punëtori të vizionimit në një periudhë kohore prej 2007-2011. Në nëntor të vitit 2010, është mbajtur një konferencë, me të gjitha palët me interes, me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku janë paraqitur rastet e suksesshme të vizionimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit gjatë gjithë procesit, duke përfshirë zbatimin e disa projekteve për investimet kapitale.

Konferenca shpalosi nevojën për një kuptim më të mirë të rolit dhe të procesit të vizionimit si një mjet planifikimi për pjesëmarrje. Si rezultat i kësaj, u iniciua hartimi i një libri bazë dhe i veglave për punëtoritë e vizionimit. Këto mekanizma shpjegojnë: a) rolin e vizionimit në planifikimin me pjesëmarrje; b) metodologjinë e vizionimit; dhe c) të mësuarit nga përvojat e fituara në Kosovë.

Qëllimi është të hulumtohen idetë dhe mjetet për aktivitetet e ardhshme të vizionimit në komunitet, të zgjerohet dhe thellohet qasja gjithëpërfshirëse e planifikimit dhe përfundimisht të kontribuojë dhe të këshillojë përmes mënyrave praktike për përmirësimin e kualitetit të jetës për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe gjetiu.

Përdorimi i këtyre veglave

Kjo punë është e ndarë në shtatë kapituj. I pari përgatit skenën për planifikimin hapësinor pas konfliktit në Kosovë, i përshtatur në kuadër të literaturës ndërkombëtare për planifikimin strategjik me pjesëmarrje. Kapitulli i dytë hulumton më thellë nocionin e ‘vizionimit në komunitet’ me një numër parimesh dhe udhëzimesh, kryesisht të bazuara në literaturën ndërkombëtare dhe përvojat më të mira. I treti përshkruan mënyrat e ndryshme dhe hapat për krijimin e një projekti ose punëtorie të vizionimit, duke përfshirë metodat dhe teknikat më bashkëkohore me rezultate të dëshmuara. Kapitulli i katërt paraqet praktikën e vizionimit në Kosovë, me fokus në dhjetë punëtoritë e vizionimit të organizuara në Kosovë nga UN-Habitat-i dhe partnerët. Kapitulli pestë hulumton rezultatet dhe ndikimet indirekte të këtyre punëtorive të vizionimit në Kosovë. Kapitulli gjashtë paraqet mësimet që duhen mësuar, duke përfshirë disa propozime për ‘Vizionimin e Ardhshëm’. Pjesa e fundit përmbyllet me ‘Aktivitetet e mëtuajshme.

KAPITULLI 1

PLANIFIKIMI NË

TRANZICION

Më shumë se një dekadë pas përfundimit të konfliktit nga mesi i vitit 1999, dhe më shumë se katër vite pas Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova ende përballet me një proces të vështirë të tranzicionit.

Institucionet e reja të Kosovës janë duke ndërmarrë hapa të ngadalshëm por që definitivisht çojnë drejt demokracisë, ekonomisë së tregut dhe integritimit evropian. Megjithatë, nuk mund të thuhet se këta hapa do të çojnë lehtë drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm për tërë shoqërinë dhe të gjitha komunitetet e saj.

Zhvillimi urban kaotik, ndërtimi i paligjshëm, vendbanimet jo formale, ajri dhe lumenjtë e ndotur, deponitë e paligjshme, dendësia në rritje e automjeteve dhe humbja substantive e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, janë vetëm disa prej faktorëve që paraqesin kërcënim për kualitetin e jetës.

Që nga fundi i konfliktit, UN-Habitat-i ka promovuar konceptin e *Planifikimit gjithëpërfshirës, strategjik, urban dhe hapësinor me orientim veprimi në Kosovë*. Përshtatja për të arritur standardet ndërkombëtare ka nënkuptuar legjislacion të ri të planifikimit, institucione dhe praktika të reja. Legjislacioni i vjetruar për planifikimin hapësinor në Kosovë është zëvendësuar me qasjen për një planifikim gjithëpërfshirës, modern dhe multidisiplinar.

Ligji i ri për Planifikimin Hapësinor ishte hartuar me ndihmën e UN-Habitat-it dhe është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në korrik 2003. Gjithashtu, me ndihmën e UN-Habitat-it, është themeluar Instituti i ri për Planifikimin Hapësinor, i cili, teorinë akademike i ka vënë në praktikë duke e hartuar Planin Hapësinor të Kosovës. *Plani Hapësinor i Kosovës*, përfundimisht është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor 2011, përcakton vizionin strategjik për Kosovën dhe komunat e saj sipas Ligjit të ri për Planifikimin Hapësinor i cili nga komunat kërkon që të hartojnë planet e veta urbane dhe hapësinore.

Planifikimi strategjik u lejon planerëve dhe palëve me interes që së bashku të përcaktojnë një perspektivë zhvillimore të përgjith-

shme, të identifikojnë fushat prioritare për veprim, dhe përqendrimin e zbatimit në këto fusha në vend të bërjes së “master planeve” tradicionale jo reale. Megjithatë, kultura e ‘master planifikimit’ dhe ‘planifikimi për shfrytëzimin e tokës’ është ende thellë e rrënjësuar në komunitetin e arkitektëve të planifikimit në Kosovë dhe përgjithësisht në gjithë rajonin e Ballkanit.

Në ligjëratën e mbajtur në një konferencë ndërkombëtare të planifikimit, e organizuar në Stamboll 2006, autori kishte paraqitur disa ide kritike për planifikimin dhe planifikuesit në Kosovë. (D’hondt F., 2008, *Re-Creating Kosovo Cities*). Ndryshimi nuk është bërë plotësisht, por ka disa shenja dhe trende të cilat tregojnë drejtimin kah ndryshimi. Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës është duke u rivendosur ngadalë në skenën profesionale, ndërsa së fundi është themeluar Asociacioni i Planerëve të Kosovës dhe që të dyja avokojnë për një planifikim më strategjik dhe me pjesëmarrje.

Shoqëria civile dhe qeveritë lokale, po ashtu janë gjithnjë e më shumë në dijeni për nevojën për planifikim dhe veprim me pjesëmarrje, mirëpo ato shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme se si të ndikojnë në këtë me tutje, përveç mjeteve tradicionale të informimit dhe konsultimit edhe diçka më shumë sesa vetëm shenjat e një procesi të vendimmarrjes.

Për të arritur nivele më të larta të angazhimit të njerëzve të rëndomtë, përfshirje të drejtpërdrejtë dhe transparente të të gjitha palëve relevante me interes në aktivitetet e planifikimit të qeverive lokale, ende nuk është bërë një praktikë e zakonshme, e cila mundëson një mënyrë më bashkëpunuese të planifikimit strategjik dhe me orientim kah veprimi. (shih ‘Shkallën e Pjesëmarrjes’ në katrore).

KATRORI 1.

SHKALLA E Pjesëmarrjes

Një tipologji prej tetë niveleve të pjesëmarrjes mund të ndihmojë në analizimin e kësaj çështjeje hutuese. Për qëllime ilustruese këto tetë tipe janë renditur sipas modelit të shkallës ku secila pjesë e shkallës i përgjigjet masës së fuqisë së qytetarit në përcaktimin e produktit përfundimtar. Pjesët e fundme të shkallës përshkruajnë nivelet e 'mospjesëmarrjes' të rregulluara nga dikush si zëvendësim për një pjesëmarrje të mirëfilltë. Niveli i shkallës 3 dhe 4 çojnë kah niveli i 'tokenizmit' që u lejon qytetarëve të dëgjojnë dhe të dëgohen, por pa ndonjë zotim se vendimmarrësit do të marrin parasysh mendimet e tyre. Kur pjesëmarrja në këto nivele është e kufizuar, atëherë nuk ka siguri se do të arrihet deri te ndryshimi i "status qos". Niveli 5 i shkallës, 'qetësimi', është thjeshtë një nivel më i lartë i tokenizmit sepse rregullat themelore i lejojnë qytetarët të këshillojnë, por edhe që për pushtetmbajtësit të mbajnë vazhdimësinë e së drejtës për të vendosur. Përpjetë shkallës gjenden nivelet e pushtetit të qytetarëve me një shkallë në rritje të ndikimit në vendimmarrje. Qytetarët mund të hyjnë në një 'partneritet' (niveli 6) që ju mundëson atyre të negociojnë dhe të angazhohen në shkëmbime me pushtetmbajtësit tradicional. Në nivelet më të larta të shkallës gjenden 'pushteti i deleguar' (7) dhe 'kontrolli qytetar' (8), qytetarët marrin kompetenca menaxhuese të plota.

Me sa duket, shkalla me tetë nivele paraqet një thjeshtësim – në botën reale të njerëzve dhe të programeve, mund të ketë edhe shkallë me 150 nivele me karakteristika më pak të dallueshme ndërmjet tyre – mirëpo kjo ndihmon në ilustrimin e qëllimit se ekzistojnë shkallëzime të rëndësishme të pjesëmarrjes së qytetarëve. Duke ditur se shkallëzimet mundësojnë të kuptuarit e kërkesave solide në rritje për pjesëmarrje publike sikurse edhe përgjigjet konfuze nga pushtetmbajtësit dhe vendimmarrësit. Burimi, duke përfshirë edhe figurën e shkallës së pjesëmarrjes: <http://lithgow-schmidt.dk/sherry-arnstein/ladder-of-citizen-participation.pdf> (Origjinali i publikuar: "A Ladder of Citizen Participation," S. Arnstein / Shkalla e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, S. Arnstein)




Fig. 1

Mirëpo, ende shumë shpesh, planifikimi me pjesëmarrje zhvillohet thjeshtë për të iu përmbajtur ligjit ose për të kënaqur kërkesat e donatorëve ndërkombëtarë duke mbështetur procesin e planifikimit. Ekziston një nevojë e qartë për qasje në pjesëmarrje më autentike dhe e përshtatshme, e cila merr parasysh kulturat dhe rregullat lokale.

Përveç trajnimeve të përgjithshme dhe përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve nga organizatat si UN-Habitat-i, ekziston nevoja për më shumë veprime specifike lokale dhe pilot projekte të planifikimit gjithëpërfshirës dhe të bazuar në komunitet, siç ishte kërkuar edhe me programet e para dhe të dyta për planifikimin hapësinor komunal. Por një qasje më inovative për arritjen e planifikimit gjithëpërfshirës në Kosovë, po ashtu është e nevojshme në nivelin qendror.

Ligji i ri për Planifikimin Hapësinor është i bazuar në konceptin e planifikimit strategjik me pjesëmarrje, mirëpo interpretimi i tij praktik shpesh kufizohet me një informacion dhe konsultim njëdrejtimësh, që paraqet hapa të thjeshtë të shkallës së pjesëmarrjes. Për të qenë efektiv, planifikimi me pjesëmarrje ka nevojë të angazhojë metoda të komunikimit dhe të angazhimit qytetar (të paraqitur në 'Shkallën e Pjesëmarrjes'). Standardet e informimit i referohen praktikës së sigurimit të qasjes publike në informacion rreth procesit të planifikimit dhe të rezultateve të tij (p.sh. Profili komunal, Analiza e palëve me interes, Vlerësimi për kapacitetet investimeve, Vizioni dhe Strategjia, drafti i Planit Zhvillimor Komunal dhe/ose Urban). Informacioni duhet të jetë i qasshëm përmes mjeteve të ndryshme si: faqja e internetit të komunës, fletëpalosjet, broshurat, afisheet, debatet publike, ekspozitat dhe mediat lokale, etj.

Praktika aktuale e konsultimit për rezultatet kyçe të planifikimit, ligjërisht është e obligueshme para dërgimit të draftit të Planit Zhvillimor Komunal për miratim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. (shih po ashtu, *Planifikimi dhe Ligji* në Katrorin 2). Ai përmban aktivitete të llojit të prezantimeve publike dhe debateve për draft dokumentet dhe atë nëpër disa vende brenda territorit të komunës, për të arritur kështu deri te mjediset më të largëta dhe për t'u dhënë banorëve vendas mundësinë për të komentuar për draftin e dokumentit. Pas mbylljes së shqyrtimit publik, komuna duhet të bëjë një raport për të gjitha vërejtjet dhe të përvijojë mënyrën e adresimit të këtyre vërejtjeve në draftin përfundimtar.

Në rast se komentet ose amendamentet refuzohen, atëherë vendimet e tilla duhet të arsyetohen. Kjo praktikë ende gjendet në një fazë tranzitore, pjesërisht për shkakun se planifikimi

KATRORI 2.

PLANIFIKIMI DHE LIGJI

Ligji për Planifikimin Hapësinor, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik 2003, mund të konsiderohet si një ligj ambicioz për të nxitur një zhvillim hapësinor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në Kosovë. Qëllimi i tij është të "promovojë një proces gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje për formulimin e strategjive të zhvillimit dhe të planeve fizike, të cilat përfshijnë të gjitha palët me interes dhe komunitetet pa kurrfarë diskriminimi, burra dhe gjithashtu edhe gra." (Neni 3b, i Ligjit për Planifikimin Hapësinor). Në nivel qendror, Ligji thotë, "Plani Hapësinor i Kosovës do të themelojë parime dhe synime afatgjata të planifikimit hapësinor për gjithë territorin e Kosovës për një periudhë prej së paku dhjetë viteve. Plani Hapësinor i Kosovës do të jetë një plan strategjik multi-sektorial, i cili do të bazohet në vizionet dhe synimet e propozuara nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, përmes pjesëmarrjes publike" (neni 11a). Veç kësaj, "secila komunë do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal i cili mbulon gjithë territorin për një periudhë kohore prej së paku pesë viteve" (neni 13.2). "Ai do të jetë në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës" (neni 13.5). "Plani Zhvillimor Komunal përmban komponentët e nevojshme tekstuale dhe grafike (neni 1 i Udhëzimit administrativ nr. 33), duke përfshirë një Vizion për të ardhmen e komunës, parimet dhe synimet, Kornizën e zhvillimit hapësinor dhe zbatimin e strategjive dhe veprimeve. Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh strukturën hapësinore të dëshiruar për territorin e një apo më shumë komunave. Strategjitë zbatuese dhe veprimet sigurojnë një urë lidhëse për tranzicion ndërmjet situatës ekzistuese dhe kornizës hapësinore." Neni 19 në mënyrë specifike merret me rishikimin dhe pjesëmarrjen publike, mirëpo detajet praktike të procedurës sigurohen me një udhëzim administrativ. Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe UN-Habitati në Kosovë ka publikuar një fletëpalosje të veçantë për të promovuar dhe shpjeguar kërkesat ligjore të pjesëmarrjes publike. Ky prezantim i shkurtër i Ligjit për Planifikimin Hapësinor në Kosovë arsyeton rëndësinë e vizionimit hapësinor dhe përdorimin e koncepteve hapësinore për zbatimin e Ligjit. **Shih po ashtu:** *Fletëpalosja mbi pjesëmarrjen e publikut në planifikim*, UN-Habitat Kosovë.

strategjik dhe edukimi për planifikimin me pjesëmarrje është ende shumë i kufizuar në Kosovë. Në Universitetin e Prishtinës ende nuk ekziston ndonjë fakultet ose program master për planifikim hapësinor dhe urban.

Prapëseprapë, planerit e trajnuar mirë dhe me përvojë nuk mjaftojnë për të siguruar një pjesëmarrje të mirëfilltë qytetare në planifikim hapësinor dhe në vendimmarrje. Kjo qartazi ishte demonstruar nga shumë shtete evropiane që kishin një edukim solid mbi planifikimin, mirëpo me një mangësi të pjesëmarrjes së publikut.

Shtytësit kryesor për ndryshimin prej 'mospjesëmarrjes' drejt 'partneritetit' dhe 'kompetencave të qytetarëve' nuk janë planerët por është vetë shoqëria civile, së bashku me një pjesë të klasës politike, synimi i së cilës është të fuqizojë njerëzit dhe të krijojë një 'kulturë të pjesëmarrjes'.

Megjithatë, një shoqëri civile me një 'bazë' dhe klasë politike të dobët që mbron interesat e korporatave, në vend të interesave publike, me gjasë janë faktorët më kritikë të cilët deri në një masë e bëjnë të vështirë arritjen e planifikimit me pjesëmarrje të mirëfilltë në Kosovë.

Meqë pozitat udhëheqëse në administratën publike shpesh janë të lidhura me politikën, shumë shërbyes civilë nuk janë në gjendje të plotësojnë zbrazëtirën ndërmjet shoqërisë civile dhe politikanëve të zgjedhur, pjesërisht për shkak të kësaj lidhjeje dhe pjesërisht për shkak të një punësimi të madh që pasoi pas periudhave të shkurtra të zgjedhjeve të nivelit lokal dhe nivelit qendror.

Përkundër përpjekjeve për trajnime nga organizatat ndërkombëtare si UN-Habitat-i, kapacitetet komunale të menaxhimit dhe të planifikimit veçanërisht kërkojnë forcim në mënyrë që të përballen me sfidat dhe detyrat e radhës.




Fig. 2

Kjo edhe më tej është komplikuar nga të metat e financimit publik dhe të shpenzimit: a) nuk ka një lidhje të qartë ndërmjet alokimit prej linjave buxhetore dhe të projekteve për investime kapitale të zgjedhura në planet zhvillimore lokale; b) buxheti i alokuar për planifikimin hapësinor kryesisht përdoret për t'ia lënë gjithë procesin e planifikimit një personi privat ose një kontraktuesi; dhe c) nuk ka një linjë buxhetore specifike për pjesëmarrje dhe përfshirje të publikut.

“Lakesa e mësimt” nga diagrami ilustron procesin e të mësuarit i cili gjithashtu është i aplikueshëm në planifikimin me pjesëmarrje në Kosovë.

Lakesa e mësimt fillon nga aneksi i kuq në pjesën që në rend të parë karakterizohet me një kombinim pa pjesëmarrje në ‘plane për shfrytëzimin e tokës’ dhe ‘masterplane’, si një bazë për lëshimin e lejeve të planit dhe të ndërtimit. Kjo ishte qartazi

praktikë në ish- Jugosllavi, mirëpo kjo praktikë vazhdon edhe sot, ndonëse nganjëherë paraqitet e ‘servuar’ me një shije kinse të pjesëmarrjes së publikut. Sidoqoftë, lakesa e mësimt duhet të gjallërojë veçanërisht komunitetin e planerëve dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi drejt një hapësire diametralisht të kundërt, e cila karakterizohet me një planifikim strategjik me veprim dhe pjesëmarrje të vërtetë. Ky lloj i ‘Planifikimit Hapësinor Strategjik’ veçohet me një ‘proces me katër shtigje’, i cili është paraqitur në fig. 3.

Programi i Agjendës Lokale 21 (shih Katrorin 3) ka miratuar një proces me shumë shtigje si një proces i vazhdueshëm i vizionimit. Shtegu i parë shpie drejt një kornize të planifikimit afatgjatë me një vizion që synon zhvillimin e hapësirës së planifikimit, konceptet hapësinore, programin afatgjatë dhe planin e shkurtë të veprimit.

PLANIFIKIMI HAPËSINOR STRATEGJIK

Proces me katër shtigje

1. Puna drejt **vizionit afatgjatë**
2. Daily policy - solving pengesat - **veprimet**
3. Angazhimi i akterëve dhe qytetarëve në planifikim dhe **proceset e vendim-marrjes** - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
4. Veprim i përhershëm - **pjesëmarrje civile**




Fig. 3

KATRORI 3.

AGJENDA LOKALE 21

Agjenda Lokale 21 është versioni lokal i ‘Agjendës 21’, një plan veprimi gjithëpërfshirës, i cili bëhet në nivel global, kombëtar dhe atë lokal nga organizatat e Kombeve të Bashkuara, në çdo hapësirë me ndikim të njeriut në hapësirë. Në Kapitullin 28 thuhet se pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i autoriteteve vendore do të jenë faktor përcaktues për përmbushjen e objektivave të veta. ‘Plani Udhëzues për Agjendën Lokale 21’ është përgatitur për të ndihmuar qeveritë lokale dhe partnerët e tyre lokalë që të mësojnë dhe të marrin detyrën sfiduese të planifikimit zhvillimor të qëndrueshëm. Kjo qasje për planifikimin paraqet hapin e parë themelor i cili do t’u mundësojë atyre që banorët në komunitet të pajisen me vlera që do të plotësojnë kërkesat njerëzore themelore, të drejtat, dhe mundësitë ekonomike dhe njëkohësisht të sigurojnë një mjedis vital, të shëndoshë dhe natyral; me fjalë tjera, qasja në planifikim do t’u mundësojë atyre që të menaxhojnë me qytetet dhe qytezat e veta ose vendbanimet rurale në një mënyrë të qëndrueshme. Udhëzimi ofron këshilla të testuara dhe praktike për mënyrën e zbatimit të Planit të Veprimit 21 të Agjendës së Kombeve të Bashkuara për një zhvillim të qëndrueshëm dhe Agjendën e Kombeve të Bashkuara për habitatin (mjedisi i jetesës). Burime: <http://www.un.org/esa/dsd/agenda21> dhe (përfshirë ilustrimin lart, diagrami djathtas) <http://www.idrc.ca/openebooks/448-2/>



Shtegu i dytë ka të bëjë me menaxhimin e jetës së përditshme, zgjidhjen e konflikteve, shënimin e 'pikëve' dhe krijimit të besimit duke zgjidhur problemet dhe zbatimin e projektit urgjent dhe strategjik për një afat të shkurtër. Shtegu i tretë angazhon të gjitha palët me interes për të bashkëpunuar, planifikuar dhe për procesin e vendimmarrjes. Shtegu i katërt është për të arritur një proces më të përhershëm të përfshirjes së publikut dhe të palëve me interes gjatë gjithë fazave të planifikimit, duke përfshirë zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e planeve.

Udhëzimi i Planifikimit për AL 21 (shih Katrori 3) skicon elementet e ndryshme dhe hapat që duhen ndërmarrë për të arritur një planifikim zhvillimor të qëndrueshëm (fig 3). Kjo i angazhon banorët, partnerët kyç institucional dhe grupet e interesit, që shpesh emërtohen si palë me interes, në projektimin dhe zbatimin e planeve të veprimit. Planifikimi zbatohet kolektivisht ndërmjet këtyre grupeve. Ai organizohet në atë mënyrë që të përfaqësojë dëshirat, vlerat dhe idealet e palëve të ndryshme me interes brenda komunitetit, veçanërisht të shfrytëzuesve të shërbimeve lokale. Ekziston një dallim mahnitës ndërmjet palëve të ndryshme të interesit, të cilat janë angazhuar në planifikim prej komuniteteve të ndryshme. Në përgjithësi, krijimi i një strukture të përkushtuar ose Grupit të palëve me interes për të bashkëpunuar dhe mbikëqyrë përfshirjen e palëve me interes në planifikim paraqet një hap të parë dhe të rëndësishëm për përpjekjet për një planifikim të qëndrueshëm. Në mënyrë tipike, detyra e parë e një

Grupi të palëve me interes është formulimi i 'Vizionit të Komunitetit', me të cilin përshkruhet e ardhmja ideale e komunitetit dhe shprehet konsensusi lokal rreth parakushteve themelore për një qëndrueshmëri.

Tani është e qartë se Vizioni i Komunitetit është pika e parë ni-store në Planifikimin Hapësinor Strategjik. Ndërsa kjo është në kuadër të një kornize më të gjerë të 'Planifikimit Zhvillimor të Qëndrueshëm' që është i nevojshëm për të drejtuar zhvillimin hapësinor dhe urban më të qëndrueshëm në shoqëri. Mirëpo, duhet të jetë e qartë se qasja për një planifikim reagues strategjik dhe dinamik mund të funksionojë përmes zbatimit proaktiv të projekteve strategjike, masave, veprimeve, masave nxitëse etj. Mirëpo, të gjitha projektet dhe veprimet duhet të futen në një kornizë brenda vizionit. Vizioni hapësinor strategjik shërben si një kornizë e referencës e cila e drejton zhvillimin hapësinor.

Bashkëveprimi i vizionit dhe i veprimit nuk është vetëm vendimtar por është edhe më i vështiri për t'u arritur dhe atë jo vetëm në Kosovë (shih Katrorin 4 për 'Projekti Urban i Negociuar'). Prapë, pa ndonjë të dhënë empirike ose hulumtim, mund të deklarohej vetëm si hipotezë, se shumica e intervenimeve urbane dhe hapësinore dhe vetë projektet janë projektuar dhe zbatuar krejtësisht aty për aty (*ad hoc*), pa ndonjë referencë për ndonjë vizion udhërrëfyes. Në disa raste vizionet dhe planet ekzistojnë, mirëpo është e vështirë të shihet lidhja ndërmjet vizionit dhe veprimit.

KATRORI 4.

PROJEKTIMI URBAN I NEGOCIUAR



Ky libër merret me të ashtuquajturat 'trialogje' ndërmjet tre dimensioneve të planifikimit urban dhe zhvillimit: vizionet, veprimet dhe projektet, dhe 'koproduksionet'. E frymëzuar nga 'Planifikimi Strategjik i Strukturuar', kjo qasje i është përshtatur qëllimeve dhe mjeteve specifike të procesit AL21 nëpër qytete, duke përfshirë Nakuru (Keni), Essaouira (Marok), Vinh (Vietnam), dhe Bayamo (Kubë).

"Projektimi urban është një mjet i fuqishëm. Ai luan një rol kyç në formulimin dhe realizimin e projekteve urbane strategjike. Ai paraqet një levë për inovacione dhe një portë drejt zgjidhjeve të papritura. Ai ka kapacitetin të shërbejë si medium për negociim dhe rrjedhimisht dhe njëkohësisht çon drejt planeve të hapura, të fuqishme dhe stimuluese, duke i lënë margjinat për evolucion dhe përshtatje; kundërtshëniet mund të kalojnë në paradokse frytdhënëse." ('Urban Dialogues', fq.196)

Më poshtë janë përshkruar Vizioni për Eko-Qytetin Nakuru dhe Projekti për skajet e parkut në Nakuru.

Projektet për skajet e parkut – me një projektim të një peizazhi të lehtë – i ka kontribuar dhe e ka mbështetur vizionin për qytetin Nakuru si një eko-qytet. Kjo paraqet njëri prej shumë ilustrimeve të dialogut të pasuruar ndërmjet vizionit dhe veprimit.

Burimi: Urban Dialogues: Localising Agenda 21, UN-Habitat, PGCHS, K.U.Leuven (author), 2004 (shih gjithashtu http://www2.unhabitat.org/programmes/agenda21/urban_dialogues.asp)

DIZAJNI URBAN

Përveç shkaktarëve rrënjësor që lidhen me bashkëpunimin e dobët ndërmjet qeverive lokale dhe shoqërisë civile dhe mungesës së sistemit arsimor, një prej arsyeve kryesore për këtë bashkëveprim ndërmjet vizionit dhe projekteve është mungesa e dizajnit urban dhe hapësinor.

Në këtë libër burimesh, dizajni urban konsiderohet si arti i 'rregullimit të vendit me pjesëmarrje'. Dizajni urban mund të shihet si urë lidhëse ndërmjet regjistrave të planifikimit dhe arkitekturës, ndërmjet shoqërisë dhe njerëzve, ndërmjet vizioneve abstrakte të vizionimit dhe vendeve reale; dhe edhe ndërmjet shkollës së vjetër të master planifikimit dhe shkollës së re të planifikimit strategjik.

Ndonëse dizajni urban është më i prekshëm në 'nivel të rrugës' (një shesh, një park, bllok i ndërtesave, një lagje, një rreth i qytetit), ai po ashtu zbatohet edhe në shkallë më të gjerë në qytet dhe nivel rajonal, përmes inkorporimit të dimensionit të tretë (lartësia), dhe projektimin e peizazheve urbane më harmonike dhe peizazheve të tjera.

Dizajni urban dhe arkitektura e peizazhit si dhe planifikimi konsiderohen si disiplina plotësuese, të cilat vizionet hapësinore abstrakte dhe strukturat hapësinore të menduara i bëjnë më të prekshme dhe për këtë arsye këto bëhen edhe më tërheqëse dhe me këtë tërheqin përfshirjen e palëve me interes.

Dizajni urban mund të përdoret si mjet për negociim drejt një sinteze të arritshme të realiteteve kundërtëne. Dizajni mund të ndihmojë në krijimin e marrëveshjeve ndërmjet palëve të interesuara kryesore.

Sidoqoftë, dizajnët urbane nuk janë 'dizajnuar' si plane të skicave, por janë më shumë si hapa të ndërmjetëm, media të cilat eksplorojnë potencialin urban dhe të vendeve tjera, mu siç bëjnë vizionet në një nivel më abstrakt.

Dizajnët urbane nuk paraqiten thjeshtë vetëm me gjurmët shkëlqyese të artistit të cilat i njohim nga zhvilluesit e pasurisë së patundshme, por janë edhe vizatime të thjeshta e skicime, të imazheve të ('foto-shopit') të cilat kanë mjaft detaje për të krijuar

atmosfera dhe janë ftuese, tërheqëse dhe të synuara drejt nxitjes së debatit publik.

Negocimi përmes dizajnit (shih Katrorin) duhet të nxisë dialogun ndërmjet ekspertëve urban, hartuesve të politikave dhe grupeve të veçanta të interesit.

"Arti i dizajnit urban rrënjësisht qëndron në ruajtjen e dialogut produktiv të arritur përmes një procesi të ndryshimit të vazhdueshëm të vizioneve dhe projekteve duke mos sakrifikuar cilësitë dhe karakteristikat e tyre esenciale dhe po ashtu duke forcuar cilësitë e tyre, koherencën dhe lindshmërinë, thuhet në publikimin e Trialogut Urban (*Urban Dialogues*).

Tutje shton: "Ndonëse procesi i negociimit hap pas hapi, padyshim është më i komplikuari, baza e marrëveshjes përfundimisht shprehet përmes planit të referues — një vizatimi. Ky plan nuk është as përzierje e interesave individuale, e as një kompromis jo interesant ngjyre gri, por është një transferim angazhues e preciz i zhvillimit kolektiv dhe koherent të vizionit me parime strukturore dhe strategjike.

"Këto vizione të zhvilluara janë bartur në një plan referues me 'konsensus' prandaj edhe ekziston legjitimiteti. Në programin e AL21, ishte rekomanduar një ratifikim formal nga aktorë të ndryshëm dhe një shpallje e duhur e ekzistencës së vet (...). Plani i referues pastaj bëhet një bazë mbi të cilën zhvillohen intervenimet konkrete dhe ekzekutimi i vërtetë i planeve dhe i projekteve urbane strategjike. Natyrisht, në praktikë ky proces nuk është linear, por siç u tha në procesin përsëritës, ai vazhdimisht lëviz ndërmjet shkallëve të ndryshme, shqetësimeve dhe prioritetëve.

"Procesi i dizajnit organizon bashkëveprimin ndërmjet vizionit, projektit dhe koproduksionit, ndërsa menaxhimi i procesit të dizajnit stimulon tutje interaksionin ndërmjet koproduksionit dhe planit referues."

Kështu, *Planifikimi hapësinor strategjik me pjesëmarrje*, i kombinuar me *negocim të projektimit dhe krijimi i hapësirës*, janë komponentët kryesor të planifikimit të cilat përkufizojnë nevojën, rëndësinë dhe kualitetin e 'vizionimit të komunitetit' si një mjet kyç në planifikimin përfshirës, që nga hapat e parë dhe gjatë gjithë procesit të planifikimit.

KATRORI 5.

KRIJIMI I VENDEVE NË KOSOVË

Hapësira publike paraqet sfidë kryesore në Kosovë që përcillet me vështirësi të veçanta, pjesërisht për shkak të:

- Konsideratës së kufizuar për hapësirën publike në përgjithësi;
- Hapësirat e trashëguara nga epoka socialiste të cilat kanë nevojë për intervenim dhe ripërshtatje;
- Rritjes së trafikut dhe nevojave për parkingje;
- Uzurpimit privat të hapësirës publike;
- Mungesës së fondeve publike;
- Mungesës së angazhimit dhe bashkërendimit të palëve me interes;
- Mungesës së strategjive të mirëmbajtjes.

Njoftimi me Planifikimin Hapësinor Komunal në vitin 2008 dhe udhëzimet e krijuara në këtë kornizë ishin pranuar mirë nga planerët lokalë dhe i kanë dhënë një kuptim asaj që mund të arrihet. Kosova duhet të ndërtojë mbi këtë përvojë pozitive, duke e vënë teorinë në praktikë dhe duke krijuar shembuj pozitiv të krijimit të hapësirës në Kosovë. I ashtuquajtur i krijimi i vendeve është një objektivi i projektimit urban. Kjo lë të kuptohet se është një proces i projektimit i cili kërkon që njerëzve të cilët jetojnë nëpër qytete t'u mundësohet diçka më shumë nga mjedisi që i rrethon. Të kenë më shumë mundësi për të lëvizur nëpër hapësirat ku jetojnë, të kenë më shumë mundësi për të takuar njerëz, më shumë mundësi për mësim, për t'u rritur, për t'u shprehur, për të shijuar bukuritë dhe për t'u gjallëruar, për t'u inspiruar dhe për t'u lidhur me njëri tjetrin dhe mjedisin që i rrethon. Krijimi i vendeve e bën këtë përmes intervenimit në piramidën e publikut për të krijuar vende të cilat u lehtësojnë njerëzve të hyjnë në bashkëveprim me njëri tjetrin dhe mjedisin dhe rrethinën e tyre në mënyrë që të përmbushin më mirë kërkesat e tyre. Me fjalë tjera, krijimi i vendeve kërkon që njerëzve t'u mundësohet që të kënaqen në 'vendet' ku ata e kalojnë kohën e tyre, në vend të 'hapësirave' në të cilat ata thjesht vetëm janë në kalim e sipër. T'i bësh njerëzit që të çmojnë hapësirat e përbashkëta; të njohin kontributin që ato e kanë për jetën e njerëzve, ata duhet të sigurojnë mandatin demokratik në mënyrë që qytetet të bëjnë dhe të paguajnë për përmirësimet konsiderohet si diçka esenciale. Përmirësimet janë esenciale. Kjo mund të duket si një kërkesë e madhe, por lidhshipi vizionar dhe programet e koordinuara për informim, edukim dhe punë publike kanë ndryshuar kulturën e qyteteve dhe kanë sjellë përfitime ekonomike në vende nga më të ndryshmet si Bogota në Kolumbi, Kopenhaga në Danimarkë, Melburni në Australi dhe Tirana në Shqipëri. Duke qenë se mjediset urbane kanë një trashëgimi komplekse dhe e kanë dimensionin fizik (d.m.th. formën e ndërtuar) dhe atë shoqëror (d.m.th. se si njerëzit sillen dhe ndjehen në mjedisin që i rrethon), krijimi i vendeve të mira urbane kërkon që procesi dhe produkti të bëhen në mënyrë të duhur. Kryerja e procesit deri më tani në mënyrë të duhur dhe duke marrë parasysh dimensionin shoqëror dhe bërja e produktit në mënyrë të duhur në mënyrë që kualitetet e krijuara në kuadër të hapësirave të jenë relevante dhe të dobishme për njerëzit të cilët do t'i përjetojnë ato. Material shtesë: "Nevoja për projektim urban në Kosovë", Jenny Donovan, Fletëpalosja e UN-Habitat Kosovë, mars 2008. (shih aneksin 2)

KAPITULLI 2

VIZIONI

Shumë komunitete ose liderët e tyre lejojnë që t'u ndodhë e ardhmja, për shembull duke angazhuar kompani (tenderuar), duke ia lënë vizionimin një planifikuesi profesionist ose ndonjë kompanie konsulente të planifikimit; ose edhe më keq, duke mos u angazhuar vetë fare. Komunitetet e suksesshme, megjithatë e dinë se mund ta formësojnë të ardhmen, së paku në kuadër të kornizës së caktuar socio-ekonomike.

“Ardhja bashkë është fillim, qëndrimi bashkë është përparim, puna bashkë është sukses.”
(Proverb)



Këto komunitete marrin shumë kohë dhe bëjnë shumë përpjekje të vështira për të krijuar një vizion të së ardhmes dhe ata dëshirojnë të jenë të angazhuar në një proces i cili do t'u ndihmojë atyre të arrijnë synimet e tyre. Një prej mënyrave më të mira për arritjen e këtyre synimeve afatgjata për vetë komunitetin është përmes projekteve të vizionimit në komunitet dhe proceseve.

Ky lloj procesi sjellë bashkë të gjitha grupet e interesit dhe sektorët e një komuniteti që bashkërisht të identifikojnë problemet, vlerësojnë kushtet e ndryshimit dhe të ndërtojnë qasje kolektive për përmirësimin e kualitetit të jetës në komunitet.

Në disa raste, vizioni i komunitetit është i lidhur me një lagje të një hapësire specifike; të tjerët e lidhin atë me një fshat, qytezë, qytet ose edhe një rajon i cili përfshin më shumë qytete, qyteza dhe fshatra; ai mund t'i referohet edhe objektivave jo hapësinore për zhvillimin e komunitetit.

Vizionimi kryesisht është një proces me të cilin komuniteti paraqitet të ardhmen e dëshiruar, dhe planifikon arritjen. Ai i sjellë njerëzit së bashku për të zhvilluar një pamje të përbashkët të asaj se si duan të duket komuniteti i tyre. Vizioni paraqet një imazh të përgjithshëm të asaj se çfarë dëshiron të jetë një komunitet dhe si dëshiron të duket në një të ardhme të caktuar. Një *deklaratë e vizionit* paraqet shprehjen formale të atij vizioni, ndërsa *dizajnimi i vizionit* është shprehje e vizualizuar e atij vizioni.

Deklarata e vizionit dhe dizajnimi i tij janë hapat e parë drejt krijimit dhe zbatimit të planeve strategjike të veprimit (shih po ashtu Manualin Planifikimi i Komunitetit & Dizajnimi).

Esenca e proceseve të vizionimit siguron kushtet për rrjetëzim dhe grupeve të ndryshme u mundëson që të qëndrojnë së bashku dhe të ndërveprojnë. Kjo shpesh çon deri te zbulimi i liderëve të rinj e të panjohur më parë ose i kampionëve të projekteve.

Prandaj vizionimi i komunitetit, për aq sa ka të bëj me kualitetin e procesit, ka të bëjë edhe me kualitetin e rezultatit.

Për shumë pjesëmarrës në një punëtori të vizionimit, është hera e parë dhe ndoshta edhe e vetme kur ata janë të përfshirë në një proces intenziv dhe bashkëpunues. Nëse punëtorja e vizionimit është e suksesshme, atëherë ndodhë që shumica e pjesëmarrësve do të mbeten të kyçur në planifikimet e mëtejme dhe proceset e zbatimit, duke kontribuar kështu në kulturën e pjesëmarrjes lokale.

Procesi i vizionimit të suksesshëm aq sa paraqet një mjet i fuqishëm për ndryshimin e kulturës së pjesëmarrjes, aq edhe mund të gjenerojë një shtytje të fuqishme për ndryshimin dhe përmirësimin e kualitetit të jetës në një territor të caktuar.

Vizioni është një mjet i dobishëm në të cilin përqendrohen shpresat dhe aspiratat, kornizat e projekteve dhe caktimi i prioriteteve. Vizioni shpjegon se si duan ta shohin veten anëtarët e komunitetit në 10, 20 ose 30 vitet e ardhme në kuptim të fushave kyçe që kanë të bëjnë me kualitetin e jetës, si p.sh. arsimi, perspektiva e punësimit, ose infrastruktura. Deklarata e vizionit duhet të reflektojë vlerat e përbashkëta të komunitetit dhe t'i udhëzojë palët me interes për pjesën e mbetur të vizionimit dhe të procesit të planifikimit. Koncepti i *vizionimit me përfshirje* i referohet 'përfshirjes' së grupit të komunitetit por edhe më shumë rezultatit të pritshëm në kuptim të një *qyteti me përfshirje* ose të komunitetit. (shih Katrorin 6).

Me origjinën e vet nga vitet 1970, vizionimi bashkëpunues dhe i komunitetit është shndërruar në një mjet gjerësisht të përhapur për planifikimin pjesëmarrës në të gjitha llojet e entiteteve territoriale dhe në të gjitha fazat e planifikimit. Tregimi i suksesshëm i qyteti Chattanooga (Qatanuga) është frymëzues. Chattanooga është një qytet i mesëm në Shtetet e Bashkuara që në mënyrë efektive ka përdorur procesin e vizionimit nga qytetarët për synime specifike afatgjata me qëllim të pasurimit të jetës së banorëve dhe të vizitorëve.

Në vitin 1969, Chattanooga njihej dhe u shpall qyteti më i ndotur në vend. Qytetarët, qeveria dhe industria u bashkuan për të adresuar dhe për t'u marrë me këtë çështje.

Në Ditën e Tokës të vitit 1990, Chattanooga u bë tregimi më i suksesshëm i ndryshimit në vend. Qyteti Chattanooga i motivuar nga kjo e arritur inicioi procesin e vizionimit nga komuniteti i gjerë dhe deri në vitin 1992 ka realizuar një numër mbresëlënës të projekteve të cilat merreshin me zbatimin e vizionit të komunitetit. Pasuan edhe shumë procese të shkëlqyera, kryesisht në Evropë (veçanërisht në shtetet nordike, Mbretëri të Bashkuar, Holandë dhe Gjermani, ashtu edhe në Azi përmes organizatave

KATRORI 6.

VIZIONIMI PËRFSHIRËS

Vendimmarrja me pjesëmarrje paraqet një prej hapave që çojnë drejt një 'Qyteti Përfshirës'. 'Qyteti Përfshirës' është një koncept i promovuar nga UN-Habitat-i përmes 'Fushatës së vet Globale për Qeverisje të Mirë Urbane'. Një 'Qytet Përfshirës' përkufizohet si "një vend ku secilit, pavarësisht pasurisë, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, ose fesë i mundësohet të merr pjesë në mënyrë produktive dhe pozitive në mundësitë të cilat qyteti i ofron." (UN-Habitat, 2000). Ideja e 'Qytetit përfshirës' po ashtu mund të ilustruhet me një numër pyetjesh si:

- A kanë qytetarët qasje të njëjtë në ujë të pastër dhe shërbime tjera themelore?
- A kanë grupet etnike mundësi të barabarta?
- Sa janë të angazhuara gratë në planifikimin e qytetit dhe në vendimmarrje?
- A u kushtohet të varfërve vëmendje e duhur?
- Deri në ç'masë janë të përfshira dhe të angazhuara grupet e tjera të cenushme të shoqërisë si personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, dhe të rinjtë?

Kjo shpie drejt pyetjeve tjera më themelore si:

- Kush çfarë kontrollon në qytet dhe në shoqëri?
- Kush dhe në çfarë ka qasje?
- Kush për çfarë është përgjegjës?
- Kush sa fiton?
- Kush çfarë bën?

Koncepti 'Qyteti Përfshirës' pra ka të bëjë me pushtetin dhe ndarjen e pushtetit, që mund të arrihet vetëm me planifikim me pjesëmarrje të mirëfilltë dhe me vendimmarrje. Një prej kriterëve themelore të arritjes për një 'Qytet Përfshirës' më shumë është marrja me 'Vizionim Përfshirës'. 'Vizionimi Përfshirës' ecën në dy këmbë: njëra ka të bëjë me përfshirjen e të gjitha palëve me interes dhe grupeve të cenushme në procesin e vizionimit; ndërsa këmba tjetër sigurohet që vizioni (dhe plani i nxjerrë strategjik i veprimit dhe projektet) i kontribuon më shumë 'Qytetit Përfshirës'. 'Vizionimi me ndjeshmëri gjinore' mund të shihet si një komponentë specifike e 'Vizionimit Përfshirës', i synuar që të sigurojë qasje të barabartë në mundësitë e ofruara nga qyteti në të gjitha aspektet e shoqërisë për të gjithë burrat, gratë, djemtë dhe vajzat. Kjo qasje, shpesh emërtohet si 'Integrimi gjinor' kërkon arritjen e synimeve specifike dhe të objektivave për përfshirjen e çështjeve gjinore. Për më shumë, shih Fletëpalosjen Gjinore në (http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/genderleaflet_eng.pdf)

si Forumi Pacifik i Azisë, shih Landry's *Creative City*). Landry ka bërë klasifikimin e shembujve të mirë të *Vizionimit Urban* aktual në tre lloje të qyteteve: a) qytetet e suksesshme të cilat dëshirojnë që të qëndrojnë përpara në lojën urbane, b) qytetet e goditura nga kriza, kryesisht në të kaluarën dhe c) krijuesit e mundësive,

Llojet e vizioneve urbane	Prijëse	Të rikthyera	Oportuniste
Klasifikimi i qyteteve të suksesshme "të udhëhequra drejt vizionit" sipas Charles Laundry ('Qyteti kreativ', 2008)	Qytetet e suksesshme që dëshirojnë të prijnë në lojën urbane shpesh duke përdorur ngjarje sic janë Lojërat Olimpike të cilat nxisin ndryshime visionare.	Qytetet që u bënë ballë krizave, dhe që dikurë ishin të famshme.	Krijuesit e mundësive, siç janë qytetet në zhvillim si porta mes lindjes dhe perëndimit, duke shfrytëzuar teknologji të reja për ta nxitur zhvillimin e qytetit.
Qytetet dhe komunat si pjesë e përvojës së vizionimit janë kategorizuar në mënyrë indikative	Barcelona, Frankfurt, Londra, New York, Shanghai, ...	Baltimore, Pittsburgh, Detroit, St Petersburg, Budapest, Glasgow, Berlin, Bilbao, ...	Vienna, Helsinki, Dubai, ...
	Në Kosovë Prizreni, Peja, Gjakova mund të shihen si qytete prijëse.	Në Kosovë Mitrovica dhe Gjilani mund të quhen si qytete që u bënë ballë krizave në përpjekje për të u rikthyer.	Në Kosovë Ferizaj, Hani i Elezit, Graçanica, Mamusha dhe Juniku mund të shihen si krijues të mundësive.

Fig. 4

si qytetet që u paraqitën ndërmjet lindjes dhe perëndimit (shih fig. 4).

Qytetet dhe komunitetet të cilat përshpejtuan kualitetin e jetës së tyre përmes vizionimit të suksesshëm, planifikimit dhe vepërimit mund të na mësojnë më shumë për *faktorët e suksesit dhe parimet udhëzuese*.

Pa angazhimin aktiv të qytetarëve në procesin e vizionimit, komuniteti do të përfundojë me vizionin e dikujt tjetër për komunitetin e tyre. Shumë komuna kanë kaluar nëpër këtë praktikë, me vizionin, si pjesë e 'Planit Zhvillimor Komunal', që krejtësisht i ishte besuar burimit të jashtëm – një planeri profesional ose kompanive konsulente për planifikim.

Pronësia lokale e vizionit është përbërësi i parë i suksesit, dhe mund të arrihet vetëm përmes një procesi të vizionimit përfshirës. Çdo komunitet ka kualitete unikalë të cilat do të duhej të ndihmojnë në përcaktimin dhe formësimin e vizionit të komunitetit.

Planet e dhe proceset e planifikimit të gatshme nuk mund të shfrytëzojnë këtë varietet unikal. Pronësia lokale nuk i përjashton profesionistët e jashtëm të planifikimit ose palët tjera me interes, sepse ata duhet të jenë pjesë e procesit i cili udhëhiqet nga komuniteti. Për më tepër, profesionistët e jashtëm të planifikimit dhe palët me interes do të jenë të dobishëm për lidhjen e vizionit lokal në të dyja mënyrat: vertikale dhe horizontale: vertikalisht për të siguruar ndër-marrëdhënie me nivelet tjera qeveritare (kombëtare, rajonale, lokale); dhe horizontalisht për të siguruar

lidhshmërinë me komunitetet fqinje dhe sigurimin e perspektivës për një kornizë rajonale.

Është esenciale që *rezultatet e procesit të vizionimit të mos parapërcaktohen*. Vizionimi është një përvojë e mësimi për komunitetin dhe është i rëndësishëm, ndoshta edhe qenësor për banorët dhe palët sepse ata kyçen në procesin e vizionimit pa pasur paragjykimet dhe kur rezultati i procesit nuk mund të parashihet. Për vizionimin 'startues' në fazën e hershme të procesit të planifikimit, rregulla e artë është që pjesëmarrësit të jenë 'duarzbrazët' (të mos vijnë me plane të vjetra, vizione të mëhershme, çfarëdo lloj raportesh; po ashtu pa laptop ose telefona të mençur për shfletim të internetit).

Ekzistojnë vetëm disa parime udhëzuese, ndërsa ka edhe shumë të tjera dhe Aneksi 3 përmban një përzgjedhje nga një listë e cila është e paraqitur në *Udhëzuesin për Komunitetin e Planifikimit* dhe në faqen e internetit. Në mesin e tyre, disa meritojnë kujdes dhe hulumtim të mëtejshëm, meqë janë me shumë relevancë për qasjen e komunitetit të vizionimit në këtë mekanizëm.

Me Pranimin e agjendave të ndryshme të vizionimit, pjesëmarrësit në vizionim mund të angazhohen nëpër mënyra të ndryshme e edhe në vizione të ndryshme për një fushë ose temë të njëjtë. Duke eksploruar forma të ndryshme të kreativitetit, mund të dalin zgjidhje të ndryshme, mirëpo të gjitha idetë nuk mund t'i përshtaten një deklaratë të vetme për vizionin ose dizajnimin.

Në fazën fillestare të procesit të vizionimit, pjesëmarrësit duhet të inkurajohen që të zhvillojnë vizione të ndryshme ose të

shumëfishta, në mënyrë që të zgjerojnë perspektivat. Vetëm më vonë gjatë procesit të planifikimit do të ketë nevojë për shkrimin e elementeve të ndryshme në një vizion koherent i cili do të ketë gjasat më të mira për t'u zbatuar. Kjo mund të jetë e afërt me parimin, bëhu vizionar, por edhe realist.

Ngritja e kapaciteteve lokale është edhe një parim udhëzues shumë i rëndësishëm për proceset e vizionimit. Megjithatë punëtoritë e vizionimit nuk janë të dizajnuara për ngritje të kapaciteteve, ato ofrojnë mundësi të mira për të rritur në mënyrë substanciale kapacitetet e pjesëmarrësve të vet – dhe jo vetëm për banorët të cilët nuk kanë përvojë ose njohuri rreth vizionimit, e lëre më për planifikim strategjik për veprim.

Ekspertët lokal, profesionistët për planifikim lokal të cilët punojnë për nivele të ndryshme të qeverisë ose ata të cilët punojnë për kompanitë konsulente për planifikim gjithashtu mund të mësojnë shumë gjatë punës së vizionimit. Shumë shpesh ata vijnë në punëtori të vizionimit me paragjykimin se kjo është vetëm humbje kohe dhe se nuk ia vlen të bashkëpunosh me jo ekspertë – thjeshtë me njerëz të cilët nuk kanë njohuri për planifikimin dhe drejtimin e një komune. Mirëpo, gjatë punës, shumica zbresin nga retë dhe inkuadrohen në komunitet, *duke parë dhe duke pranuar se banorët e zakonshëm mund të jenë 'ekspertë' të shkëlqyer* të lagjes ose edhe të qytetit të tyre.

Planifikuesit konstruktivë dhe jo paragjykes më shumë dëgjojnë sesa flasin. Ata më shumë parashetrojnë *pyetje në vend se të përgjigjen vetë në to*, duke e mundur kështu procesin e vizionimit nga jo ekspertët. Roli udhëzues i fasilitatorit, si dhe roli reflektiv nga një numër i ekspertëve dhe skicuesve të jashtëm është shumë i rëndësishëm për këtë proces të të mësuarit së bashku. Ekspertët e jashtëm dhe skicuesit duhet të vlerësojnë në mënyrë kritike kontributet e vizionimit sipas parimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe për qytetin përfshirës.

Një mënyrë e mirë për përfshirjen e gjithë pjesëmarrësve të vizionimit është që të *lejohen të gjitha mënyrat e shprehjeve* për të ilustruar idetë dhe kontributet e tyre për vizionin. Shumica e jo-planerëve janë të ndrojtur kur përdoret zhargon i planifikimit.

Njerëzit mund të marrin pjesë në mënyrë shumë më efektive nëse informacioni paraqitet në mënyrë vizuale në vend mënyrës verbale dhe nëse ka mundësi që ata të paraqesin idetë e tyre në mënyrë jo-verbale. Talenti i fshehur artistik mund të del në sipërfaqe dhe të sjellë kualitet më të madh për vizualizimin e vizioneve.

Punëtoritë për vizionimin fillestar mbani jashtë vendbanimit. Përparësitë kryesore nga kjo formulë e tërheqjes është se i gjithë

grupi i komunitetit i përkushtohet shumë detyrës dhe gjeneron një mjedis të veçantë për një dinamikë pozitive të grupit, duke çliruar ide të freskëta dhe propozime kreative, veçanërisht kur punëtorët e vizionimit zgjatë më shumë ditë.

Shpenzoni para! Pjesëmarrja efektive dhe proceset e vizionimit me sa duket kërkojnë shpenzime, kohë, energji dhe buxhet. Megjithatë, ka shumë metoda për të përshtatur buxhetet dhe mjaft mund të arrihet duke përdorur vetëm kohën dhe energjinë e njerëzve. Mirëpo, buxheti i pamjaftueshëm çon kah shkurtimet dhe rezultatet e dobëta.

Është shumë e rëndësishme që të sigurohet një buxhet i mjaftueshëm për një pjesëmarrje publike në përgjithësi dhe për aktivitete specifike si vizionimi përfshirës dhe në veçanti punëtoritë e vizionimit. Meqë është më e lehtë të alokohet buxheti publik për planifikim sesa për pjesëmarrje, një rregull e pashkruar është që të alokohet një përqindje e buxhetit për qëllime të pjesëmarrjes në planifikim. Kjo përqindje nuk duhet të jetë më e vogël se 5 përqind, mirëpo pjesëmarrja në një planifikim të suksesshëm ka treguar shifra shumë më të larta, deri në 20 përqind (shih Aneksin 4 *Spoor Noord* në Antwerp, Belgjikë si një rast më i mirë i praktikës së vizionimit përfshirës, planifikimit dhe buxhetimit).


Tani është koha e duhur! Për pyetjen se kur është koha e duhur për të mbajtur punëtorinë e vizionimit, pason përgjegjia. Koha më e përshtatshme për të angazhuar njerëzit është natyrisht në fillim të çdo procesi të planifikimit; sa më herët, aq më mirë, edhe përpara fazës së mbledhjes të të dhënave.

Regjistri, dokumenti dhe vazhdo. Është e qartë, por kjo duhet të bëhet! Rexhistrimi dhe dokumentimi është parakusht për një vazhdim të suksesshëm. Vazhdimi i vizionimit fillestar bëhet në kuadër të kornizës së planit strategjik të veprimit. Gjatë rrjedhës së këtij cikli të planifikimit, edhe vizioni po ashtu do t'i nënshtrohet ndryshimeve ciklike. Cikli i vizionimit shpjegohet tutje në Katror. Një kulturë lokale e vizionimit në rritje do të ecë krah për krah më një kulturë lokale të përmirësuar të pjesëmarrjes. Profesionistët e planifikimit dhe kompanitë konsulente kanë për të luajtur rolin e tyre në këtë drejtim, mirëpo komuniteti lokal dhe përfaqësimi i tij, qeveria lokale, duhet të qëndrojnë në pozitën e drejtuesit.

Punoni në lokacion! Kurdo që është e mundur, zhvilloni aktivitete të planifikimit në mjedisin për të cilin është duke u bërë planifikimi. Kjo e bën shumë më të lehtë mbulimin e zbrazëtirës prej konceptit kah realiteti. Megjithatë, rrethanat lokale të caktuara diktojnë që puna të bëhet në ndonjë lokacion tjetër.

KATRORI 7.

CIKLI I VIZIONIMIT



Vizionimi do të jetë më i suksesshëm nëse nuk bëhet si aktivitet i pavarur, nëse përmirësohet dhe nëse shumëfishohet dhe përsëritet. Diagrami i mëposhtëm ilustron ciklin e vizionimit me disa të arritura të regjistruara. Hapi fillestar dhe më i rëndësishëm është **krijimi i një vizioni preliminar për hapësirën e planifikimit ose temën**, i cili kryhet nga grupi përfaqësues i komunitetit gjatë punëtorisë së vizionimit. Gjatë kësaj punëtorie, duhet të bëhet regjistrimi i nevojshëm për të ruajtur kështu të gjitha rezultatet, fotografimi dhe marrja e shënimeve gjatë diskutimeve. Ky material do të mundësojë një dokumentacion të rregullt dhe përgatitjen e raportit të punëtorisë së vizionimit. Mirëpo, hapi i parë i punëtorisë së vizionimit është **organizimi i ngjarjes publike për të marrë pjesë në proces dhe produktet e punëtorisë së vizionimit** me të gjithë banorët dhe palët tjera me interes të komunitetit. Hapi i dytë është **stërhollimi i deklaratës së vizionit dhe projektimi i vizionit**, të cilat mund të integrohen në raportin e punëtorisë mbi vizionin me kusht që ai të jetë i qartë lidhur me 'çfarë' ka ndryshuar që nga vizioni fillestar. Hapi i tretë është **konsolidimi i vizionit në një dokument formal të planifikimit**, për shembull plani komunal ose zhvillimor urban, një plan rregullator ose çfarëdo lloj plani. Ky plan do të shndërrohet në një dokument formal të planifikimit pas miratimit formal nga qeveria(-të) kompetente. Një hap tjetër dhe më i rëndësishëm është **zbatimi gradual i vizionit dhe planit të veprimit**. Pas një afati të caktuar ose kurdo që e kërkojnë rrethanat, do të ketë nevojë për **rishikim të vizionit**, e që mund të çojë te krijimi i një vizioni të ri dhe rritja e rëndësisë së vizionit paraprak. Gjatë këtij cikli të vizionimit, po ashtu do të ketë nevojë për **zhvillimin e vizioneve më të detajuara ose më specifike në pjesët e hapësirës së planifikimit** ose të elementeve specifike të temës së planifikimit. Për shembull, pas finalizimit të vizionit për tërë komunën, do të ketë nevojë për një fokus më të detajuar të zonave specifike si qendra urbane, shtrati i lumit, një hapësirë e re e gjelbëruar me parqe dhe fusha sportive, një zonë biznesi, etj. Punëtoritë shtesë për vizionim mund të organizohen për çdo fushë ose temë të fokusuar, të ndara ose të grupuara nëpër kohë dhe hapësirë. Megjithatë, teknikat dhe mjetet e ndryshme të vizionimit mund të aplikohen për lloje të ndryshme të fushave ose temave të fokusuar të vizionimit.

KAPITULLI 3

MEKANIZMI I

VIZIONIMIT

Tani parimet dhe udhëzimet janë përcaktuar, ndërsa për krijimin e projektit të vizionimit do të caktohen mënyra dhe hapa të ndryshëm. Fillimi me hapa duket më i logjikshëm, meqë mënyrat e ndryshme të vizionimit kanë shumë hapa të përbashkët. Hapat më të zakonshëm në një projekt të vizionimit janë treguar në diagramin e mposhtëm. (fig. 5)

“aty ku nuk ka vizion, njerëzit humbin”

(proverba 29:1)



VIZIONIMI NË HAPA

1	Mandati i vizionimit
2	Pala punëtore e vizionimit
3	Logjistika e vizionimit
4	Pjesëmarrësit e vizionimit
5	Punëtoritë e vizionimit
6	Aktivitetet pas vizionimit

Fig. 5

Mandati i vizionimit i referohet marrëveshjes ndërmjet autoritetit kompetent (p.sh. komuna, e përfaqësuar nga kryetari) dhe entitetit i cili do të zhvillojë punëtorinë e vizionimit.

Entiteti mund të jetë një organizatë joqeveritare lokale ose nga jashtë, një organizatë e bazuar në komunitet, një kompani konsulente lokale ose nga jashtë, ose edhe një organizatë ndërkombëtare, si UN-Habitat-i, ose një donator.

Në teori është e mundur që të zhvillohet një punëtori e vizionimit nga komuniteti pa pëlqimin e autoritetit kompetent. Mirëpo, kjo do ta vendoste këtë ngjarje jashtë procesit të planifikimit strategjik i cili është i nevojshëm për të siguruar se vizioni do të zbatohet përmes veprimeve të legjitimuara publike. Me fjalë tjera, një punëtori e mandatuar e vizionimit përfshinë përkushtimin zyrtar publik për zhvillimin e gjithë procesit të planifikimit strategjik. Prandaj kjo siguron vazhdimësinë e vizionimit fillestar, pak a shumë sipas ciklit të vizionimit të përmendur më lart.

Pala punëtore e vizionimit kryesisht do të bashkojë përfaqësuesit palës organizuese ose palët dhe qeverinë kompetente ose autoritetin publik. Pala punuese do të jetë përgjegjëse për gjithë procesin e vizionimit, duke përfshirë prezantimin publik dhe dorëzimin e projektit të vizionimit.

Logjistika e vizionimit paraqet një mori aktivitete të cilat janë vendimtare për punëtoritë e suksesshme të vizionimit. Varësisht nga mundësitë për zgjedhjen e lokacionit, kornizës kohore, numrit të pjesëmarrësve dhe llojeve të burimeve të nevojshme, do të ketë nevojë për një llogaritje të detajuar të buxhetit, si dhe rregullime të qarta për burime dhe nevojë potenciale për sponsorizim. Duke iu referuar parimit 'shpenzo para', alokimi i buxhetit duhet të jetë i balancuar mirë me parashikim të rezultateve dhe përfitimeve.

Identifikimi dhe rekrutimi i *pjesëmarrësve të vizionimit* është njëri prej faktorëve kyç për një ngjarje të suksesshme të vizionimit. Pjesëmarrja nga komuniteti është e dëshirueshme, por nëse punëtorja e vizionimit është e parapare për një numër të kufizuar të njerëzve, atëherë kërkohet një përzgjedhje e cila i përfaqëson palët me interes. Pala punëtore e vizionimit duhet të identifikojë, përzgjedhë dhe t'i informojë pjesëmarrësit. Pasi pjesëmarrësit të jenë përzgjedhur dhe informuar mbi pjesëmarrjen e tyre, duhet të mbahet një takim informues, në mënyrë që ata të përgatiten për punëtorinë e vizionimit. Kjo po ashtu u mundëson pjesëmarrësve të pranojnë ose të refuzojnë ftesën dhe të bëhen zëvendësimet me kohë.

Punëtoritë e vizionimit do të zhvillohen duke e ndjekur një program të përgatitur dhe një udhërrëfyes, që po ashtu kërkon një fleksibilitet gjatë ballafaqimit me faktorët e papritur

Aktivitetet pas vizionimit përmbajnë ngjarjet si prezantime publike, marrëdhënie me publikun dhe veprime të informimit, punëtori të pas vizionimit me qëllim të stërhollimit të vizionit dhe në fund vjen raporti nga punëtorja e vizionimit.

PYETJE TË RËNDËSISHME

Hapat e ndryshëm do të hulumtohen më tutje përmes një numri pyetjesh e përgjigjesh.

Pyetje: Si të përcaktohet fusha e planifikimit dhe periudha e planifikimit?

Përgjigje: Në shumë raste mundësia për të zgjedhur fushën e planifikimit mund të jetë mjaft e drejtpërdrejtë, në veçanti nëse vizionimi bëhet për gjithë komunën. Mirëpo edhe në raste të tilla, rekomandohet që të bëhet dallimi i së paku tre niveleve të vizionimit: 1) për gjithë komunën, 2) për një rajon funksional

më të gjerë rreth komunës dhe 3) për zona specifike të synuara brenda komunës (qendrën urbane, fshatrat, luginën, etj.). Nëse hapësira e planifikimit nuk është e përkufizuar në mënyrë të qartë, p.sh., kur vizioni ka për synim zhvillimin e integruar të luginës, një mjedisi malor, ose edhe të një hapësire metropolitane që shtrihet në më shumë se një entitet administrativ, nevojitet të bëhet një analizë paraprake me qëllim të arsyetimit të planifikimit të propozuar dhe kufirit të komunitetit, duke përfshirë kështu identifikimin e hapësirave me potencial të palëve me interes. Lidhur me periudhën e planifikimit, është mjaft e përshtatshme të dallohet periudha kohore afatgjatë (rreth 15-25 vite në të ardhmen), afatshkurtër (rreth 5-10 vite) dhe ndërmjet tyre qëndron edhe periudha afatmesme. Vizioni zakonisht mbulon periudhën afatgjatë, ndërsa intervenimet strategjike mund të ndryshojnë përgjatë këtyre tre kornizave kohore. Kushtet e planifikimit jo domosdoshmërisht duhet të parapërcaktohen para punëtorisë së vizionimit; ato mund të jenë po ashtu pjesë e diskutimeve të komunitetit.

KË TA KYÇIM?



Fig. 6

Pyetje: Si bëhet përzgjedhja e pjesëmarrësve dhe cili duhet të jetë numri i tyre?

Përgjigje: Rëndësia e identifikimit dhe përzgjedhjes së përfaqësuesit të grupit të komunitetit vështirë se mund të mbivlerësohet. Mënyra më e mirë e shkuarjes përpara është analiza e fushës së planifikimit përmes analizës së palëve me interes. Pala punëtore e vizionimit së pari duhet të identifikojë kategoritë e grupeve të komunitetit të cilat duhet të përfshihen në procesin e vizionimit. Një mostër e kategorive është paraqitur më poshtë,

me pjesë të ndërthurura të grupeve të lidhura. Për shembull një listë kontrolluese më e kompletuar për planifikim është e disponueshme në faqen e internetit. Një baraspeshim ndërmjet 'rojave të vjetra' dhe 'gjakut të ri' është po aq e rëndësishme sa edhe baraspeshimi ndërmjet profesionistëve dhe jo-profesionistëve të planifikimit, ose të njerëzve që punojnë për organizatat e institucioneve (si komuna, rajoni ose shteti) dhe banorët tjerë të fushës së planifikimit. Veç kësaj, siç vëren *American National Civic League*, "është e rëndësishme që pjesëmarrësit të veprojnë si qytetarë që kanë hise në kualitetin e jetës në gjithë komunitetin, dhe jo thjeshtë si përfaqësues të ndonjë organizate të caktuar, pjesës së qytetit ose e çështjes." (Shih *Manualin Vizionimi nga Komuniteti dhe Planifikimi Strategjik*, f. 12). Duhet të siguroheni që të shënjestroni grupet e veçanta të interesit si grupet mjedisore, mirëpo mos harroni të përfshini njerëzit të cilët nuk janë pjesë e ndonjë grupi të organizuar në komunitet, si amviset, bie fjala.

Pala punuese e vizionimit duhet ta bëjë përzgjedhjen përfundimtare të pjesëmarrësve. Një mënyrë për të siguruar kandidatë është përmes konkursit të hapur dhe përzgjedhjes përmes zotimit të shprehur, respektimit të barazisë gjinore, moshës, prapavijës arsimore e profesionale etj. Mënyra tjetër është përfshirja e një apo më tepër OJQ apo OBK dhe mundësia që ata ta propozojnë përzgjedhjen e pjesëmarrësve. Një vendim tjetër ka të bëjë me numrin e personave të përfshirë në punëtorinë e vizionimit. Shumëçka do të varet natyrisht nga burimet në dispozicion por sa më i madh të jetë grupi aq më të mëdha do të jenë mundësitë për përfaqësim të plotë. Sidoqoftë, praktika ka dëshmuar se rezultatet më të mira arrihen me grupe me rreth 40 e 60 pjesëmarrës. Në të njëjtën kohë, ka po ashtu raste të suksesshme me grupe më të mëdha siç shihet në shembullin e rastit më të mirë të *Spoor Noord* në Antwerp, Belgjikë (shih Shtojcën 4).

Pyetje: Si të përzgjidhet lokacioni i punëtorisë së vizionimit?

Përgjigje: Objekti duhet të jetë politikisht neutral, pra duhet të jetë jashtë ndërtesës së komunës dhe objektit të zyrave. Mund të jetë në hapësirën e planit por po ashtu jashtë me kusht që të organizohet transporti për pjesëmarrësit. Përparësitë dhe mangësitë e organizimit brena apo jashtë hapësirës së planit tashmë janë theksuar por ka edhe disa aspekte tjera që vlen të përmenden. Në rast të mosbesimit në mes të grupeve të ndryshme etnike në hapësirën planifikuese, është gjithmonë mirë të mbahet punëtorinë e vizionimit diku tjetër, në vend neutral, po të jetë e nevojshme edhe jashtë kufijve shtetëror. Ky për shembull ishte rasti me punëtorinë e parë disaditore të vizionimit për qytetin e ndarë të Mitrovicës, në veri të Kosovës, ku vendi më i pranueshëm për punëtorinë që mblodhi përfaqësues nga komunitetet e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës ishte një hotel në Shkup. Objekti po ashtu duhet të jetë mjaft i madh dhe fleksibil për

të mbajtur punëtorinë kreative të vizionimit, me tavolina e karrike që lehtësisht mund të zhvendosen varësisht prej nevojave të sesioneve të ndryshme (grupeve punuese, sesioneve plenare, prezantimeve teatrale). Pala punuese e vizionimit duhet të vendos për lokacionin dhe objektin përfundimtar, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe parametrat lokalë siç është buxheti apo mundësia për të siguruar fondet e nevojshme.

Pyetje: Si të përzgjidhet korniza kohore e duhur për punëtorinë?

Përgjigje: Punëtorinë e vizionimit mund të bëhen në kornizë kohore prej disa orësh deri në disa ditësh. Punëtorinë e 'përshpejtuara' të vizionimit zakonisht janë të mundura vetëm me profesionistë të planifikimit. Për grupe të përziera komunitetesh, do të nevojitet më shumë kohë që ata të përgatisin plane afatgjate për të ardhmen. Dy ditë janë minimumi kurse tri deri në katër ditë është koha optimale për këtë qëllim. Zakonisht punëtorinë planifikohet ta përfshijë edhe fundjavën, të fillojë të premten dhe të përfundojë të hënë. Gjatë fundjavës, me shumë njerëz janë të lirë dhe janë në gjendje t'i aranzhojnë detyrimet profesionale me ato shtëpiake. Pas vendimit të grupit punues të vizionimit rreth kohëzgjatjes, hapi i ardhshëm është caktimi i datave, duke pasur parasysh 'kalendarin e komuniteteve' në mënyrë që datat të mos hasin në konflikt me aktivitete shkollore, sportive, fetare apo të tjera. Në përgjithësi më së miri është po ashtu t'iu shmanget pushimeve të festave. Hapi i tretë është planifikimi i aktiviteteve përgatitore dhe pasuese si sesione informative për pjesëmarrësit, trajnuesit, fasilitatorët dhe moderatorët, prezantim publik i rezultateve të punëtorive të vizionimit dhe përgatitja e raportit final, duke përfshirë sesione të mundshme për harmonizimin e deklaratave dhe dizajneve të vizionit. Orari final duhet t'iu komunikohet jo vetëm pjesëmarrësve potencialë por edhe tërë komunitetit dhe lidhësve.

Pyetje: Si të sigurohen informata rreth pajisjeve dhe përkrahjes?

Përgjigje: Një proces efektiv fillon me informata të mira. Shumë apo pjesa dërmuese e procesit të punëtorisë ndërtohet mbi kontributin nga publiku, por një bazë solide e informatave teknike është kyçe për vizionim cilësor. Planet ekzistuese, profilet historike, studimet apo raportet, të dhënat statistikore, ligjet dhe rregullat mund të jenë të dobishme por po ashtu mund të kenë ndikim negativ në mendimin dhe vizionimin kreativ dhe 'jashtë Shtojcës', posaçërisht në fazën fillestare. Sidoqoftë, hartat e mira të bazës së hapësirës së planit janë themelore si dhe foto nga ajri, nëse ekzistojnë. Është e rëndësishme të inkurajohet përfaqësimi / reflektimi kreativ i vizioneve përmes shënuesve (markerve) me ngjyrë, letër kopjuese, spërkatësve (sprejeve) me ngjyrë dhe mjeteve tjera. *Udhëzuesi për Komunitetin/Webfaqja* ofron një listë më të gjerë kontrolluese të artikujve që mund të jenë të dobishëm për fazën përgatitore të aktiviteteve të ndryshme te

planifikimit. Një listë më specifike për punëtoritë e vizionimit do të paraqitet më poshtë në këtë publikim, në kapitullin vijues.

Pyetje: Si të përzgjidhet kryesuesi, fasilitatorët dhe animuesit?

Përgjigje: Të gjitha këto funksione dhe role duhet të zgjidhen dhe aprovohen nga pala punuese e vizionimit. Ata janë kyç për suksesin e procesit të vizionimit. Kryesuesi formal mund të jetë kryesues i palës punuese por nuk është gjithmonë e domosdoshme për punëtoritë e vizionimit. Kryesuesi shpeshherë perceptohet si lider, përderisa punëtoritë e vizionimit duhet të mbështeten më shumë në lidhshmëri të ndarë. Rolet themelore të kryesuesit – menaxhimi i kohës në vend të parë - mund të ushtrohen fare lehtë nga fasilitatori. Sidoqoftë, në raste kur ka më shumë se një fasilitator, kryesuesi mund të shërbejë si urë lidhëse në mes të fasilitatorëve dhe grupit.

Fasilitatori ka profil më të ulët dhe shpeshherë perceptohet si më pak i frikshëm se sa kryesuesi formal. Fasilitatori në fakt asnjëherë nuk merr pjesë apo ndikojë në procesin vendimmarrës. Sidoqoftë, fasilitatori ka detyrë të rëndësishme ta mbajë dinamikën e grupit pozitive. Fasilitatori gjithashtu duhet të sigurojë që të gjithë të marrin pjesë apo t'u mundësohet pjesëmarrja. Sfidat kryesore të fasilitatorit është të sigurojë që të gjithë hapat e nevojshëm në procesin e vizionimit janë ndërmarrë sipas programit dhe orarit të paraparë. Fasilitatori po ashtu duhet të ofrojë një përshkrim informues të qartë në fillim dhe në fund të punëtorisë, duke përfshirë edhe organizimin praktik pasues në procesin planifikues të mëtejshëm. Së fundi, fasilitatori duhet të sigurojë që takimet regjistrohen mirë (mbajtja e shënimeve dhe fotot). Të gjitha këto funksione dhe role kritike kërkojnë një person të trajnuar mirë të rekrutuar nga vendi apo nga jashtë. Edhe më mirë është të jenë dy fasilitatorë: një për menaxhimin e procesit dhe një për menaxhimin e përmbajtjes. Fasilitatori i menaxhimit të përmbajtjes duhet të sigurojë përmbushjen e standardeve themelore të cilësisë lidhur me hapat e ndryshëm në procesin e vizionimit, përfshirë deklaratën dhe dizajnin e vizionit. Fasilitatori i përmbajtjes nuk duhet të veprojë si planer kryesor përmes çka duhet dhe çka nuk duhet të bëhet po më shumë si gazetar kritik me koleksion të gjerë të pyetjeve reflektuese. Citati më i famshëm i Sam Goldwyn "Sa për informim, më lejoni t'ju bëj ca pyetje" përkufizon rolin e fasilitatorit të përmbajtjes. Si edhe me fasilitatorin e procesit, fasilitatorët e përmbajtjes mund të rekrutohen përbrenda apo jashtë komunitetit. Një fasilitator nga jashtë apo edhe i huaj mund të ketë pikëpamje më të pavarur dhe të freskët të situatës. Në të dy rastet, fasilitatori i përmbajtjes duhet të jetë planer urban me interes të gjerë dhe njohuri të thellë rreth zhvillimit dhe planifikimit veprues të qëndrueshëm, përfshirës, të integruar dhe strategjik. Shtojcat 5 dhe 6 elaborojnë më detajisht zotimet e planerëve evropianë dhe vizionin e

tyre për *qytetin përfshirës*, që mund të shfrytëzohet si udhëzues drejtues përgjatë procesit të vizionimit.

Së fundi, punëtorja e vizionimit po ashtu mund të ketë nevojë për animues. Një lloj i animuesit duhet ta mbajë grupin aktiv përmes 'thyerësve të akullit', në fillim të sesioneve punuese dhe 'energji-dhënësve', gjatë ditës. Këta animues të procesit duhet të posedojnë sens të mirë humorit që do të mund të shfrytëzohet në rast të rritjes së tensioneve apo emocioneve. Lloji i dytë i animuesit është prapë më shumë i lidhur me përmbajtjen. Dëgjimi aktiv dhe pyetjet reflektive janë më efektive se sa imponimi i qëndrimeve. Për më tepër rreth artit të fasilitimit, shih *Manualin për Planifikim & Projektim të Komunitetit* e posaçërisht *Punëtoritë Pjesëmarrëse – libër prej 21 seteve të ideve dhe aktiviteteve*. Aty ofrohen këshilla të dobishme për fasilitatorët, trajnuesit, mësimdhënësit dhe trajnuesit e trajnuesve; si dhe aktivitete të shumëllojshme për kultivimin e dinamikës pozitive të grupit.

Pyetje: Si të identifikohet dhe sigurohet financimi?

Përgjigje: Tashmë do të jetë e qartë që projektet e vizionimit kanë nevojë për financim thelbësor dhe burime të njëjlojta për t'i mbuluar shpenzimet administrative, logjistike, hulumtuese, informuese dhe fasilituese. Kur të merren parasysh të gjitha shpenzimet, projektet me vizionim të gjerë komunitetesh mund të kushtojnë prej disa qindra deri në disa mijëra euro. Shumëçka do të varet nga lloji i punëtorisë së vizionimit dhe mjedisit ekonomik lokal. Një punëtori vizionim në një vend në zhvillim zakonisht do të kushtojë më pak se sa në ndonjë vend të zhvilluar, kryesisht për shkak të kostos më të ulët të logjistikës dhe pagesës më të ulët të rekrutimit të njerëzve si fasilitatorë. Sa për informim: pjesëmarrësit nga komuniteti nuk duhet të paguhen për kontributet e tyre përgjatë procesit të vizionimit. Pavarësisht kostos totale të punëtorisë, financimi mbetet faktor kyç që duhet të zgjidhet para fillimit të procesit dhe rritjes së pritshmërisë nga komuniteti. Pyetja e parë është sa të holla dhe burime tjera mund të sigurohen përbrenda komunitetit për zbatimin e procesit të paraparë të vizionimit. Sfidat e dytë është si të mbulohen shpenzimet e mbetura dhe ku të gjenden sponsorët. Qëllimi i parë duhet të jetë gjetja e sponsorëve lokalë si Oda Ekonomike, bankat apo institucionet tjera financiare, organizatat shërbyese dhe fetare apo institucionet e komunitetit. Po qe se nevojitet financim shtesë, atëherë mund t'u drejtohet edhe sponsorëve rajonal, vendor apo edhe ndërkombëtar. Sidoqoftë, në vendet në zhvillim dhe/ose post konflikte, shpeshherë komuniteti ndërkombëtar mbulon pjesën më të madhe të financimit, kombinuar me mbështetjen e njëjlojtë nga partnerët lokalë. Nënkuptohet që tërë sponsorizimi duhet të jetë plotësisht i pakusht. Nëse procesi i vizionimit bëhet mirë, 'kthimi i investimit' do të jetë një

vizion me përkrahje të gjerë të komunitetit që do t'i zhvillojë të gjithë sektorët e shoqërisë përfshirë edhe interesat e sponsorëve.

Pyetje: Çfarë lloj aktiviteteesh nevojiten para dhe pas punëtorisë (fillestare) të vizionimit?

Përgjigje: Çelësi kryesor i suksesit të procesit të vizionimit të komunitetit është informimi efektiv i komunitetit. Kjo është e nevojshme, para së gjithash, për shkak se jo të gjithë pjesëtarët e komunitetit mund të jenë aktiv në procesin e vizionimit. Dhe së dyti, për shkak se gjithmonë do të ketë zbrazëtira në përfaqësimin e komunitetit në grupin e vizionimit, përkundër përpjekjeve për rekrutimin e një grupi përfaqësues interesi. Për shkaqe të ndryshme, grupe të caktuara nuk mund të marrin pjesë në punëtoritë e vizionimit dhe duhet të bëhet angazhim i posaçëm për t'iu qasur atyre grupeve dhe individëve. Kësisoj, pala punuese e vizionimit mund të shndërrohet në një komitet pasues apo informues. Kjo do të mundësojë integrim të lehtë në procesin e rregullt të planifikimit dhe të sigurojë që të gjithë hapat pasues janë ndërmarrë si duhet. Sidoqoftë, qysh nga fillimi, grupi punues i vizionimit duhet ta mbajë një takim me komunitetin lidhur me punëtorinë e vizionimit, me fokus në tërë procesin e planifikimit. Ky takim duhet të fokusohet posaçërisht në kandidatët e përzgjedhur si pjesëmarrës por do të ishte edhe më mirë të organizohet një takim publik ashtu që të gjitha grupet e komunitetit do të mund të informoheshin, duke përfshirë edhe mediat lokale. Pas punëtorisë së vizionimit, një takim publik do të duhej të organizohej brenda një periudhe të arsyeshme jo më larg se një muaj. Kjo ngjarje publike do t'i mundësojë grupit të vizionimit t'i prezantojë idetë e veta, deklaratat e vizionit dhe projektimin e vizionit. Opinioni duhet t'i ofrohet mundësia të parashtrijë pyetje dhe të debatojë rreth rezultateve, përderisa moderatorin apo fasilitatorin po ashtu duhet të theksojnë procesin e mëtejshëm dhe ta bëjnë shumë të qartë që gjatë punëtorisë së vizionimit nuk është marrë asnjë vendim formal. Mediat lokale gjithashtu duhet të jenë të përfshira në këtë ngjarje publike dhe duhet t'u ofrohet

një komunikatë shtypi me ca ilustrime nga punëtorja e vizionimit (shpeshherë pamjet janë më bindëse se fjalët). Kryetari i komunës dhe zyrtarët tjerë po ashtu duhet të marrin pjesë në këtë prezantim publik dhe t'i 'pranojnë' rezultatet e vizionimit si një kontribut në procesin formal të planifikimit. Por, as këtu e as gjatë punëtorisë së vizionimit, nuk duhet që kryetari i komunës apo ndonjë zyrtar tjetër ta dominojë punëtorinë, prezantimin apo të krijojë përshtypjen që ky është tani vizioni zyrtar. Hapi i fundit kritik për përfundimin e punëtorisë së vizionimit është përgatitja e një raporti gjithëpërfshirës. Shpeshherë do të ekzistojë nevoja për harmonizimin e disa elementeve të vizionit, apo të elaborohet më tepër rreth dëshirës për strukturën hapësinore të integruar. Kjo është e pranueshme përderisa raporti e bën të qartë se cilat ndryshime janë bërë që nga punëtorja e vizionimit dhe pse. Edhe më e rëndësishme është të sigurohet së pjesëtarët e komunitetit që ishin pjesë e punëtorisë së vizionimit të jenë të involvuar në harmonizimin e mundshëm.

Raporti mbi punën e procesit të vizionimit të komunitetit ka shumë objektiva të njëjta me prezantimin publik (p.sh. reflektimi mbi procesin, vlerësimin e kontributeve të deritashme, ndërtimi i dinamikës etj.). Në të njëjtën kohë, parqet vegël fleksibile që mund të shfrytëzohet për frymëzimin e organizatave e kompanive që ta përqafojnë vizionin e komunitetit dhe të projektojnë pjesë të planit të tyre strategjik në bazë të tij. Raporti po ashtu shërben si përkujtim për autoritetet dhe komunitetin rreth detyrave të tyre dhe ofron angazhim të mëtejshëm me bazë mbi të cilën duhet të punohet. Qëllimi është që të përdoret e jo të kemi një publikim të mirë dhe të lihet në sirtarë për të mbledhur pluhur. Por në këtë kohë digjitale, interneti gjithashtu mund të shfrytëzohet si platformë publike për t'u informuar dhe diskutuar rreth procesit të vizionimit dhe produktet e tij. Organi qeveritar përgjegjës për detyrat e planifikimit mund të hapë një faqe interneti të projektit për vizionimin dhe procesin e planifikimit përkatës, por kjo është diçka që mund të bëhet edhe nga

“Ajo që më duhet është dikush të më bëjë të bëj atë që mundem”

Ralph Waldo Emerson



grupet e interesit. Anketat përmes internetit dhe Shtojcat e vërejtjeve mund të kultivojnë një komunitet më interaktiv virtual të vizionimit dhe qasjet më inovative do të mund të aplikoheshin gradualisht për të rritur më tej pjesëmarrjen përmes mediave elektronike.

QASJA

Tani meqë janë përshkruar të gjitha elementet e procesit të vizionimit, mund fillohet me hulumtimin e mënyrave të vizionimit. Ato janë të shumta dhe i takon palës punëtore të vizionimit të përzgjedhë modelin më të përshtatshëm, duke përshtatur nevojat e komunitetit, shkallën pozitive si dhe krahasimin e burimeve të cilat janë të disponueshme ose të cilat mund të mobilizohen.

Kjo figurë tregon një përzgjedhje të një vargu të gjerë metodash pjesëmarrëse planifikimi me komponentë të vizionimit. Disa shembuj janë marrë nga *Pjesëmarrja Funksionon! 21 Teknika të Pjesëmarrjes së Komunitetit për Shekullin 21* nga Fondacioni i Ri Ekonomik (1997). Të tjerët janë marrë nga *Udhëzuesi për Planifikim për Komunitetin/Webfaqja* (aktualisht). Disa nga metodat kanë fushëveprim më të përgjithshëm dhe të gjerë, si *planifikimi i një ngjarjeje komuniteti*, *punëtori tryeze të rrumbullakët* dhe *punëtori terreni*; përderisa tjerat janë më specifike dhe të ngushta si *panairi i vizionit* apo *hartografia elektronike*. Në mesin e metodave, katër sosh janë më të zhvilluara dhe të strukturuar.

E ashtuquajtura *metoda e zgjedhjes* paraqet mënyrë sistematike të përfshirjes së sa më shumë pjesëtarëve të komunitetit lokal në zhvillimin e një vizioni urban dhe frymëzimin e tyre që të veprojnë përkatësisht. Chattanooga, që fitoi shpërblimin e UN-Habitat-it për Praktikën më të Mirë më 1997, ndërmori *ReVision 2000* më 1993 pasi që ushtrimi origjinal *Vision 2000* kishte arritur shumicën e qëllimeve të parashtruara më 1984. Iu desh një vit planifikimi dhe tre muaj për zbatim. I ka katër hapa: gjenerimi i ideve të komunitetit përmes një vargu takimesh të komunitetit; prezantimi i ideve në punëtoritë e planifikimit të udhëhequr nga fasilitatorët; grumbullimi i ideve në synime; dhe së fundi, seleksionimi i veprimeve në 'Panairin e Vizionit' (shih gjithashtu *Qytetin Kreativ*, Landry 2008).

E ashtuquajtura *metoda e kërkimit të ardhshëm* gjeneron veprim përmes ndërtimit të një vizioni të përbashkët në mes të një grupi divers njerëzish. Ajo angazhon një grup të madh, idealisht prej 64 pjesëtarëve të komunitetit të cilët formojnë tetë tryeza me tetë grupe interesi apo tematike. Ata marrin pjesë në një proces tejet të strukturuar dy ditësh e gjysmë duke mbuluar pesë faza: 1) shqyrtimi i të kaluarës, 2) hulumtimi i të tashmes, 3) krijimi i skenarëve ideal për të ardhmen, 4) identifikimi i vizionit të përbashkët dhe 5) përgatitja e planeve të veprimit. Një nga punëtoritë e para të kërkimit të ardhshëm u zhvillua më 1995 në Hitchin në Hertfordshire, që rezultoi në *Strategjinë e Vendbanimeve të Tëra*. Që nga ajo kohë, mbi 35 konferenca kërkimore




Fig. 7

janë zhvilluar vetëm në Mbretërinë e Bashkuar (shih www.futuresearch.net).

E ashtuquajtura metoda e planifikimit të vërtetë krijon një '3D model' të madh të hapësirës për të cilën duhet të bëhet plani. Modeli prezantohet në disa vende për t'u diskutuar. Njerëzit mund t'i paraqesin idetë e tyre përmes kartelave të sugjerimeve. Planifikimi i vërtetë përdoret anembanë botës (shih www.planningforreal.org.uk). Një metodë e ngjashme është *Modelimi Pjesëmarrës 3D* i zhvilluar nga Menaxhimi i Burimeve Natyrore në Filipine – një metodë komunikimi relativisht e re, e facilitimit, e projektuar për të mbështetur proceset bashkëpunuese kryesisht për shfrytëzim të burimeve dhe synon në facilitimin e pjesëmarrjes që nga fillimi në analizën e problemeve dhe vendimmarrje. Ajo e integron njohurinë e njerëzve dhe informatat hapësinore (linjat kufizuese) për të prodhuar modele të pavarura të lehtësimit që janë dëshmuar të jenë praktike dhe relativisht vegla të sakta për ruajtjen e të dhënave dhe për mënyrën e analizave. Në të njëjtën kohë, është edhe medium i shkëlqyeshëm komunikimi. Modelimi pjesëmarrës 3D funksionon më së miri kur përdoret së bashku me Sistemet Globale të Pozicionimit GPS dhe Sistemet e Informimit Gjeografik GIS në kontekst pjesëmarrës GIS (shih www.iapad.org/participatory_p3dm).

E ashtuquajtura metoda "charrette" gjen përdorim të gjerë për vizionim të komunitetit. Fjala "charrette" mund t'i referohet cilitdo sesioni bashkëpunues ku grupi i dizajnerëve planifikues përpilon zgjidhje për ndonjë problem të planifikimit apo projektimit. Ekzistojnë dy lloje themelore të "charrette": "charrette" të vizionimit, me kërkim spekulativ të së ardhmes së mundshme jo të lidhur me ndonjë propozim zhvillimor apo projekt; dhe "charrette" të zbatimit, të përdorura kur ka nevojë për ndonjë plan të zbatueshëm. Përderisa struktura e "charrette" ndryshon varësisht prej problemit të projektimit dhe individëve në grup, "charrette" shpesh zhvillohen në sesione të shumëfishta ku grupi ndahet në nën-grupe. Secili nën-grup pastaj prezanton punën e vet përpara grupit të plotë si material për dialog të ardhshëm. "Charrette" të tilla shërbejnë si mënyrë e gjenerimit të shpejtë të zgjidhjes projektuese duke integruar aftësitë dhe interesat e një grupi me njerëz të ndryshëm. Në planifikimin urban, "charrette" zakonisht u referohet takimeve mjaft intensive dhe mundësisht disa ditore ku përfshihen zyrtarët, profesionistët dhe banorët. Përdorimet tjera të termit "charrette" ndodhin brenda ambientit akademik apo profesional përderisa planerët urban thërresin publikun e përgjithshëm në "charrette" të tyre të planifikimit. Shumë komuna nëpër botë përgatisin plane afatgjate qytetesh përmes "charrette" të shumëfishta – si komunale ashtu edhe profesionale. Sukseset që vlen të përmenden përfshijnë qytetin e Vankuverit (shih 'Wikipedia' dhe www.charretteinstitute.org). Modele të ngjashme janë *Dizajn "fest"*, *Dizajn punëtoria*

dhe Studio e Dizajnit Urban (shih *Manualin e Planifikimit të Komunitetit*). Një karakteristikë e përbashkët e të gjitha modeleve charrette është përmbledhja e dizajnit – shpjegim me shkrim për projektuesin apo ekipin projektues ku përshkruhen qëllimet, objektivat dhe arritjet e projektit dizajnuar. Modeli "charrette" dhe teknika e përmbledhjes së dizajnit do të trajtohen më gjerësisht në kapitullin për mësimet e nxjerra dhe vizionimin e ardhshëm.

Sidoqoftë, disa teknika më pak të njohura dhe, apo, më të specializuara po ashtu mund të jenë të dobishme për 'ndërtimin' e modelit të duhur për secilin rast konkret. Konkursi i ideve për shembull është mënyrë e mirë e stimulimit të mendimit kreativ dhe zgjimit të interesit dhe dinamikës. Mund të përgatitet asisoj që t'u mundësojë të gjithëve t'i paraqesin idetë e tyre apo mund të jetë e paraparë vetëm për profesionistë. Një Punëtorë Mikroplanifikimi është procedurë gjithëpërfshirëse e planifikimit të veprimit për prodhimin e planeve zhvillimore për avancimin e vendbanimeve joformale.

Fillimisht e paraparë për përdorim në vendet në zhvillim, kjo teknikë bazohet në punëtorë të rregullta intensive që përfshijnë përgatitje, materiale e trajnime minimale (shih www.communtyplanning.net). Së fundi ekzistojnë edhe modele dhe teknika specifike për të zhvilluar vizionimin kreativ. "Vizionimi Frymëzues" për shembull është teknikë spirituale e "imagjinimit të thellë" përmes krijimit të vizioneve individuale të së ardhmes para se të ndahen me të tjerët dhe transformimit të vizioneve në strategji veprimi. Vizualizimi i udhëhequr është qasje e ngjashme që e çon grupin në udhëtim imagjinor në të ardhmen. Teknika është përdorur gjerësisht sidomos në arsim dhe në zhvillimin e vizionit të përbashkët lidhur me Agjendën Lokale 21. Numri i pjesëmarrësve ka ndryshuar prej grupeve të vogla deri në 160, me disa fasilitatorë. Histori suksesi është *Vizioni 21* i Gloucestershire, themeluar më 1994 si reagim ndaj Agjendës 21. Puna e tij inovative në konsultimin e komunitetit gjatë përpilimit të Agjendës Lokale 21 të Gloucestershire ka pranuar mirënjohje të gjerë. Që nga përgatitja e manifestos, *Vizioni 21* është fokusuar në mbështetjen dhe zbatimin e projekteve të qëndrueshmërisë në Gloucestershire, të cilët i adresojnë shqetësimet globale në nivel lokal. E tëra filloi më 1996 kur një grup prej 40 të rinjsh u ftuan ta kalojnë fundjavën së bashku për të imagjinuar një të ardhme më të qëndrueshme për komunitetin e tyre, duke përdorur formatin e 'vizualizimit të udhëhequr'. Pasi e imagjinuan të ardhmen, atyre ju kërkua t'i identifikonin tre 'balona' (dëshira) dhe tri barra apo gjëra që mund ta pengonin të ardhmen e tyre të dëshiruara. Ata pastaj kërkuan mënyra për t'i tejkaluar këto pengesa. Ata e prezantuan vizionin e tyre përpara zyrtarëve të këshillit komunal, afaristëve etj. Pas pesë vitesh, webfaqja e *Vizionit 21* shërben si mjet interaktiv për komunitetin me theks në iniciativat konkrete lokale për t'i luftuar ndryshimet klimatike (shih www.vision21.org.uk).

“Vizioni është arti i të parit të padukshmes”

Jonathan Swift pg. 23



Përdorimi i teknologjisë së lartë në vizionimin e komunitetit dhe planifikimin e veprimit është ende në fazë eksperimentale. Sidoqoftë, publiku duket se është i interesuar për të hulumtuar planifikim dhe ndërtim virtual të qytetit duke pasur parasysh suksesin e lojërave kompjuterike dhe të Internetit si ‘Simcity’, ‘CityVille’ dhe ‘FarmVille’. *Vizualizimi i komunitetit të juaj me Google Earth dhe Google SketchUp* është titulli i një artikulli të shkruar nga Kent Morisson për revistën *Main Street Now* (botimi janar/shkurt 2010).


Përderisa hulumtimi me Google, e-maili, dhe shërbimet tjera të Internetit janë të përshtatshme, kombinimi i Google Earth me Google SketchUp ofron mundësi të jashtëzakonshme për ruajtjen historike dhe planifikimin, pohon autori. Me shfrytëzimin e këtyre veglave, cilido komunitet do të mund ta krijojë dhe shfrytëzojë një ‘mjedis 3D’ me kosto të ulët ku versioni ekzistues dhe ai i propozuar mund të shihen krahas njëri tjetrit pa u ndërthur fare. Ai po ashtu i referohet rastit të Chattanooga. Një nga projektet më të reja është puna me qytetarë është transformimi i pamjeve ajrore, të rrafshëta nga Google Earth në prezantim 3D të qytetit të dëshiruar të cilin punojnë për ta përmirësuar. Për të mësuar më shumë rreth projektit dhe për ta parë progresin e tij, vizito www.chattanooga3d.com. PICT – Përfshirja e Klientëve në Planifikim përmes e-Trajnimit (e-Training)– ishte një projekt inovativ tej-kombëtar i financuar nga BE-ja që përdori teknika si SketchUp. Projekti ishte i paraparë të modernizojë ofrimin e trajnimit anembanë Evropës, Autoritetet lokale, universitetet, konsulentë privat dhe partnerët social në katër vende të Evropës, Belgjikë, Greqi, Hungari dhe Mbretëri të Bashkuar, morën pjesë në këtë projekt. Projekti synon zhvillimin e e-Trajnimit inovativ për komunitete dhe planerë profesionistë për t’u ndihmuar të ballafaqohen me kërkesat e e-qeverisjes dhe në veçanti të jetë në shërbim të procesit pjesëmarrës. Objektivat e projektit përfshijnë identifikimin e nevojave trajnuese të planerëve dhe

publikut përmes hulumtimit empirik: përfshirja aktive e komuniteteve lokale në fushat pjesëmarrëse përmes themelimit të partneriteteve lokale për të monitoruar dhe animuar aktivitetet e projektit; ofrimi i trajnimit përmes e-mediave alternative dhe krahasimit të rezultateve; bashkëpunimi me profesionistë, akademikë dhe grupe komuniteti për të inkurajuar përdorim të gjerë të produkteve të projektit dhe bartjen e tyre në fusha tjera; dhe shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në mes të partnerëve (për raste praktike shih www.e.pict.hu).

Tani që modelet e ndryshme të vizionimit të komunitetit janë elaboruar, duhet po ashtu të analizojmë detajisht disa nga pjesët perberese që zakonisht përdoren në shumicën e këtyre modeleve. Tri sosh janë thelbësore për proces të suksesshëm të vizionimit:

- **E kaluara**, apo si të barten kujtimet e çmuara të hapësirës planit të së kaluarës në burime për vizionim të së ardhmes.
- **E tashmja**, apo si të bëhet portreti hapësinor i hapësirës planit sot, përfshirë trendët aktuale dhe fuqive, dobësi, mundësi dhe kërcënimeve (analiza ‘SWOT’).
- **E ardhmja**, apo si të krijohet vizioni i komunitetit bazuar në të kaluarën dhe të tashmen.

VIZIONIMI NË HAPA



KAPITULLI 4

VIZIONIMI NË

PRAKTIKË

PËRVOJA E KOSOVËS

Pas përshkrimit të mëhershëm kryesisht teorik, ky kapitull flet për procesin e vizionimit në Kosovë¹ dhe ndan përvojat e fituara gjatë këtij procesi. Për një pasqyrë të Kosovës, shih Shtojcën 7. Që nga përfundimi i konfliktit etnik më 1999, Kosova është ballafaquar me një proces të hovshëm e të paparë ndërtimi dhe rritje të hapësirave urbane.

Kjo është pjesërisht pasojë e shkatërrimit të objekteve të banimit gjatë luftës, migrimit pas luftës në kërkim të kushteve më të mira dhe, apo, më të sigurta të jetesës dhe punësimit, si dhe e trendit global të urbanizimit. Qytetet brenda kufijve të tyre të kaluar janë në pamundësi të ofrojnë hapësirë për investime të reja që çon te zhvillimi i paplanifikuar dhe pakontrolluar urban. Vendbanimet joformale bëhen pamje e zakonshme në periferitë e qytetit; ndërtimi pa leje lulëzon; dhe qasja në shërbime, edhe pse e përmirësuar gjatë kohës, ende nuk është e kënaqshme.

Deklarata e Njëanshme e Pavarësisë nga Kosova më 2008 vendos mbi institucionet e Kosovës përgjegjësi për ndërtimin e strukturave demokratike dhe ligjore, miratimin e legjislacionit mbështetës dhe ndërtimin e kapaciteteve të shërbyesve civilë. Kjo ndërlihet po ashtu me zhvillimin hapësinor dhe miratimin gradual të standardeve evropiane dhe parimeve ndërkombëtare për urbanizim të qëndrueshëm dhe qeverisje të mirë urbane. Zgjidhja e kontesteve pronësore dhe përfshirja e vendbanimeve joformale në planet lokale zhvillimore vazhdon të mbetet faktor i rëndësishëm në krijimin e vendbanimeve të qëndrueshme urbane në Kosovë.

Historia e vizionimit në Kosovë daton nga fundi i vitit 2004 dhe fillimi i 2005, kur Programi për Qeverisje dhe Planifikim Zhvillimor i UN-Habitat-it (GDPP) në Kosovë organizoi një varg

trajnimesh speciale mbi vizionimin hapësinor dhe shfrytëzimin e koncepteve hapësinore. Theks i veçantë i Programit ishte në ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin e institucioneve qendrore e lokale si dhe shërbyesve civilë që merren me çështjet e planifikimit hapësinor e urban. Kjo u plotësua me ligjëratat speciale në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Arkitekturës, si pjesë e modulit mësimor për planifikimin hapësinor e urban. Një nga seritë trajnuese synonte në veçanti kuptimin më të drejtë dhe përdorimin praktik të vizioneve dhe koncepteve hapësinore si elemente kyçe në planifikimin strategjik të veprimit. Si rezultat i vlerësimeve pozitive nga trajnuesit e Institutit për Planifikim Hapësinor, u organizua një udhëtim nëpër Kosovë në janar 2005 për të parë interesimin rreth testimit të teorive të vizionimit në praktikë, për të intervistuar planerët hapësinor në nivel komunal dhe qendror rreth përvojave të tyre pozitive apo negative me planifikim strategjik hapësinor, me planin komunal zhvillimor apo me Planin Hapësinor të Kosovës në nivelin qendror, për të përdorur vizionet dhe konceptet hapësinore dhe për të përfshirë grupet e interesit dhe publikun. Disa nga konkluzionet e përgjithshme mbeten aktuale edhe sot:

- Profesionit i planifikimit në Kosovë është në fazë kalimtare. Shumica e planerëve janë arkitektë që mësojnë përmes përvojës. Në shumicën e vendeve tjera evropiane, profesionit i planifikimit hapësinor është më i shumëllojshëm dhe rekruton profesionistë nga disiplina të ndryshme.
- Pjesa diagnostike dhe analitike e procesit të planifikimit merr shumë kohë dhe energji duke pënguar fazat më strategjike të planifikimit.
- Për shkak të pasigurisë, të shkaktuar nga mungesa e të dhënave dhe anketave adekuate, shumë planerë të Kosovës hezitojnë ta paramendojnë të ardhmen përmes skicave apo konceptualizimeve.

¹ Për pasqyrë të Kosovës shih Shtojcën 7

- Si pasojë e kapaciteteve planifikuese vendore, i tërë procesi i planifikimit shpeshherë angazhohet përmes kompanive private nga jashtë. Kjo krijon një cikël të ‘varfërisë’ lokale të planifikimit përmes mungesës së shfrytëzimit të mundësive për ndërtimin e ekspertizës lokale.
- Sidoqoftë, shumica e komunave kanë shfaqur interes për vizionim. Si reagim ndaj këtij interesimi, u përgatit një pilot projekt i vizionimit në bashkëpunim me Institutin e Planifikimit Hapësinor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Faza e parë u kufizua në një punëtorë vendore vizionimi, dhe po e suksesshme, ajo do të pasohet me një seminar vizionimi me përfshirjen e komunitetit.

Tri komuna (Peja, Shtimja dhe Mitrovica) u selektuan për të marrë pjesë në pilot projektin përmes pjesëmarrjes në punëtorë të vogla vizionimi, së bashku me punëtorët e vizionimit të organizuara në vend duke përfshirë tërë stafin e Institutit të Planifikimit Hapësinor të Kosovës me seli në Prishtinë. Secilën herë, planerët kryesisht zhvillonin ushtrime vizionimi gjatë sesioneve të paradites e pastaj i prezantonin rezultatet e tyre përpara grupeve të interesit duke përfshirë lidhshkrimin politik p.sh. kryetarin e komunës.

Hapësira për të cilën hartohet plani në nivelin lokal ishte definuar si i tërë territori i komunës. Në rast të punëtorisë brenda Institutit, tema e korridoreve të transportit u zgjodh si fokus dhe hapësira për të cilën hartohet plani u definua si temë specifike e jo si dimension hapësinor. Në të dy rastet gupet e vizionimit u udhëzuan të përgatitnin vizione tematike të bazuara në a) portretin hapësinor me analizë SWOT dhe b) qëllimet, objektivat dhe deklaratën e vizionit. Planerët u inkurajuan të krijojnë dizajne vizioni dhe struktura të dëshiruara hapësinore.

Ushtrimi fillestar i vizionimit me tri pilot komunitat prodhoi rezultate të ndryshme por që u vlerësuan lartë nga shumica e pjesëmarrësve. Pas ballafaqimit me rezultatin e punëtorisë së parë me Institutin e Planifikimit Hapësinor, u organizua punëtorë e dytë me përfshirjen e Ministrisë së Transportit. Për këtë punëtorë u ofrua material më i detajuar përfshirë edhe udhëzimet dhe rregullat mbi përdorimin e ngjyrave dhe simboleve në harta. Kjo punëtorë rezultoi të jetë shumë e suksesshme dhe e vlerësuar lartë nga të dy ministrinë. Punëtorë e vizionimit u dëshmuar si vlerë shtese sa i përket mirëkuptimit më të mirë të ndërsjellë dhe bashkëpunimit në mes të grupeve primare të interesit. Punëtorët e vizionimit me Institutin erdhën në momentin e duhur pasi që ishin plotësisht të angazhuara në finalizimin e Planit, Hapësinor të Kosovës, plotësisht të ri, drafti i parë i konsoliduar i publikuar në dhjetor 2005. Ky plan mund të konsiderohet si plani i parë modern dhe proces i planifikimit në Kosovë, me aplikimin e standardeve të planifikimit pjesëmarrës. Sidoqoftë, struktura e

paraparë hapësinore, mjete kryesor i vizionit të zhvillimit strategjik, ishte kryesisht rezultat i një procesi të gjerë konsultimi se sa rezultat i përbashkët i një apo më shumë punëtorëve ndërdisiplinare dhe të shumë grupeve të interesit. Sidoqoftë mjaft inovativ për standardet e Kosovës është vizualizimi i qartë i strukturës së paraparë hapësinore dhe konceptet hapësinore themelore apo të arritura.

Në mes të periudhës dhjetor 2005-janar 2006, Zyra e UN-Habitat-it Kosovë i ofroi asistencë teknike Departamentit të Planifikimit Hapësinor me qëllim të hulumtimit të nevojës dhe metodës për një kornizë politikash urbane. Arsyja ishte urbanizimi i hovshëm i Kosovës, posaçërisht që nga fundi i konfliktit më 1999. Kjo shkaktoi dy trende kryesore me ndikim negativ në qëndrueshmërinë e mjedisit urban: shtrirjet dhe shpërhapjet e pakontrolluara urbane në një anë dhe dendësimi i tepërt i qendrave ekzistuese urbane në anën tjetër, posaçërisht përbrenda, dhe rreth kryeqytetit. Ndihmuar nga një konsulent i jashtëm i UN-Habitat-it, Departamenti i Planifikimit Hapësinor e shqyrtoi mundësinë dhe metodën e një fletë të bardhë si hapi i parë drejt një kornize të integruar të politikave urbane. Një delegacion i Departamentit u caktua pjesë e një Task Force dhe ndërmori udhëtime nëpër terren për të regjistruar trendet urbane në Kosovë. Task forca bënte fotografime, merrte shënime, bisedonte me zyrtarë komunal dhe shtetëror si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile dhe udhëtoi me mjete të ndryshme transporti, duke përfshirë edhe trenin (për disa pjesëmarrës ishte hera e parë që udhëtonin me tren). Një punëtorë vendore vizionimi u organizua për të hulumtuar perspektivën e një politike të avancuar urbane. Një nga rezultatet ishte koncepti i vizionit i quajtur Qyteti i Kosovës, ku shprehet vizioni i një rrjeti policentrik qyteti i kryeqytetit dhe gjashtë qyteteve regionale, të ndërlidhura mirë përmes një sistemi të modernizuar hekurudhor ndër-qytetesh me lidhje të jashtme të qyteteve fqinje. Ky vizion kundërshtonte trendin aktual hapësinor të akumulimit monocentrik në dhe rreth kryeqytetit.

Vizioni i Qytetit të Kosovës formoi bazën e raportit, duke paraqitur një përmbledhje të ‘Librit të Bardhë për Politikë Urbane’. Raporti u prezantua dhe iu dorëzua ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Si hap pasues, u përgatit një propozim për ‘Forumit e parë Urban’. Për shkak të mungesës së mjeteve dhe negociatave për status të Kosovës, fatkeqësisht Forumi Urban dhe ‘Libri i Bardhë’ nuk u realizuan. Sidoqoftë, ushtrimi u dëshmuar të jetë vlerë shtese e vizionimit pozitiv si kontribut për propozime të veprimit pozitiv që tejkalonte qasjet burokratike dhe tërësisht legjislativë të planifikimit.

Më 2006, UN-Habitat-i lansoi një program të ri, Programin e Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (PMPHK

Punëtoritë e vizionimit përfshirëse me komunitet në Kosovë
Janar 2007- Nëntor 2010

Faza e planifikimit	E hershme	E mesme	E vonshme
Urbane	Mitrovica (01.2007) Prizren (06.2007)	Ferizaj (02.2007) Gjilan (04.2007) Gjakova (06.2007)	Peja (08.2007)
Rurale	Han i Elezit (04.2008) Mamusha(06.2008) Graçanica (11.2010)	Junik (09.2007)	

Fig. 8

–shih Shtojcën 1). Gjatë Programit 1 të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (2005-2008), inkurajuar nga rezultatet pozitive dhe vlerësimet e ushtrimeve fillestare të vizionimit, u organizua një projekt më i madh prej nëntë punëtorive ‘reale’ të vizionimit të komunitetit në bashkëpunim me autoritetet komunale dhe partnerët. Në kohën e këtij publikimi ², është organizuar edhe një punëtori nën Programin e Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal 2 (2008-2011) që përbënte kornizë kohore prej gjithsej 50 ditë vizionimi dhe më shumë se 400 pjesëmarrës.

Matrica e mësipërme paraqet të gjitha komunat ku janë organizuar punëtori vizionimi disa-ditore përfshirëse të komunitetit. Shtatë nga dhjetë u organizuan më 2007, në mes të janarit dhe shtatorit; dy u organizuan më 2008 (prill dhe qershor), përderisa e fundit me komitetin e komunës së re të Graçanicës u organizua në nëntor 2010. Gjashtë punëtori vizionimi u organizuan më qytete regjionale, përderisa katër prej dhjetë punëtorive të vizionimit u zhvilluan me komunitete më rurale. Përkundër faktit se komunat e qyteteve regjionale kanë zona të gjera rurale, fokusi më shumë qëndroi te qendrat urbane dhe rrethinën e tyre. Gjysma e punëtorive të vizionimit u zhvilluan gjatë fazës së hershme të planifikimit komunal që natyrisht ofron mundësitë më të mira për përcjelljen e rezultateve nëpër tërë procesin e planifikimit strategjik. Kategorizimi i fazave planifikuese duhet të kuptohet në kombinim me përfshirjen eventuale të konsulencës së jashtme planifikuese. Komunat që proceduan planet zhvillimore komunale vete (duke shfrytëzuar resurset e veta njerëzore) janë të theksuara me “**bold**”. Planifikimi hapësinor komunal promovon fuqishëm hartimin e planeve nga vete komunat (duke shfrytëzuar resurset e veta njerëzore) sa më shumë të jetë e mundshme, pra angazhimi i jashtëm duhet të kufizohet në detyra specifike teknike që nuk mund të trajtohen nga kapacitetet aktuale të stafit

komunal apo asistentit teknik (p.sh. UN-Habitat-i). Punëtoritë e vizionimit të komunitetit po ashtu janë konsideruar vegël e rëndësishme për fuqizimin e lidërshiptit dhe stafit komunal për të marrë përsipër pronësinë e procesit të planifikimit strategjik. Komunat të cilat tërë procesin planifikues e kanë kryer duke angazhuar kompanitë planifikuese jo vetëm që kanë humbur mundësinë e krijimit të një ndjenjë të fortë pronësie të procesit por edhe e kanë lëshuar rastin për ndërtimin e kapaciteteve planifikuese të nevojshme për t’i kuptuar dhe zbatuar planet.



² Publikimi është shkruar në fillim të vitit 2011, dhe që nga ajo kohë janë zhvilluar edhe dy punëtori tjera të vizionimit.

Punëtoritë e vizionimit janë zhvilluar gjatë fazave të ndryshme të planifikimit siç vërehet në diagram. Sidoqoftë, sekuenca e punëtorive nuk u përputh me fazat e mëvonshme të planifikimit.

Në rastin e Mitrovicës, punëtorja e parë e vizionimit të komunitetit, procesi planifikues për Planin Komunal dhe të Zhvillimit Urban ishte vetëm një fazë e nisjes dhe në atë kohë nuk u përfshi ndonjë kompani planifikuese. Kurse, Prizreni ishte në një fazë paksa më të ndryshme të planifikimit, me plan urban të përgatitur dhe të miratuar nga Kuvendi Komunal, para shpalljes së Ligjit për Planifikim Hapësinor. Megjithatë, Plani Komunal Zhvillimor për tërë komunën ende nuk ekzistonte dhe në fakt punëtorja e vizionimit ofroi kontribut kyç për kushtet e përgjithshme të tenderimit për angazhimin e jashtëm për hartim të planit. Në rastin e Mamushës, vizionimi i komunitetit nuk mund të vinte në fazë më të hershme. Mamusha, më parë fshat i komunës së Prizrenit, është një nga komunat e reja të themeluara sipas aktit të decentralizimit, me shumicë popullatë turke. E njëjta vlen edhe për të gjitha komunat tjera rurale të shënuara me të hirtë. Hani i Elezit dhe Juniku ishin pjesë e fazës së parë të decentralizimit. Në anën tjetër, Graçanica, si dhe një komunë tjetër partnere, Parteshi, u themeluan në bazë të planit të Ahtisarit duke ju mundësuar popullatës shumicë serbe të Kosovës organe të veta administrative. Arsyeja pse Juniku është kategorizuar në fazën e mesme të planifikimit është sepse përgatitjet për procesin e planit zhvillimor urban tashmë kishin filluar. Plani është proceduar pas punëtorisë së vizionimit dhe është hartuar plotësisht nga vete stafi komunal, me asistencën teknike të PMPHK-it.

Situata me komunat tjera është plotësisht e ndryshme. Derisa filloi asistencë teknike me Gjakovën, Ferizajn dhe Gjilanin, këto komuna i kishin angazhuar nga kompanitë private për përgatitjen e planeve hapësinore dhe si dukej të gjitha e kishin angazhuar një kompani të njëjtë. Vizionet e komunitetit që dolën nga punëtoritë e vizionimit dallonin thelbësisht nga ato të hartuara më herët nga kompania dhe kjo çoi deri te një proces negociues i vështirë, por interesant për të gjetur kompromis. Duke përfshirë përfaqësues të kompanisë në punëtoritë e vizionimit, si vëzhgues dhe duke pasqyruar rezultatet në raport me vizionin e dhënë nga kompania po ashtu e pasuroi këtë proces.

Produkti përfundimtar në këto tri raste, sidoqoftë, është më pak në përputhje me vizionin e komunitetit se sa në rastet e kur është bere herët gjatë fazës planifikimit dhe planifikimit nga vete zyrtaret komunal. Po ashtu dëshmoi se përfshirja e komunitetit në këto tri raste ishte më shumë e natyrës kontestuese se sa në rastet tjera. Sidomos në rastin e Ferizajt, punëtorja vizionuese inkurajoi dhe shtyri shoqërinë civile të rrit vetëdijësimin publik dhe të zhvillojë shkathësi kontrolluese lidhur me çështjet e

planifikimit urban. Mangësia ishte se punëtorja e vizionimit ka mundur të prodhojë pritje tejet të larta. Sidoqoftë, ndryshimi i qasjeve dhe 'shprehive të këqija' nuk mund të ndodh brenda natës por kërkon shumë 'këmbëngulje' dhe 'durim'. Rasti i fundit i Pejës ishte po ashtu i ndryshëm nga të gjithë të mëparshmit. Kjo komunë i kishte finalizuar planet e veta hapësinore shumë më herët se fillimi i punëtorive të vizionimit më 2007. Prandaj, punëtorja e vizionimit në Pejë nuk u fokusua në tërë territorin e komunës por më shumë në zonën strategjike të identifikuar në planin komunal zhvillimor si zonë e regjenerimit. Ushtrimi vizionues inkuadroi të gjitha grupet relevante të interesit në vend të shumicës së 'banorëve'. Në këtë aspekt, punëtorja e vizionimit në Pejë ishte plotësisht ndryshe dhe kësaj përbente eksperiment interesant, përkundër faktit se ende nuk janë realizuar të gjitha rezultatet e pranuar publikisht. Si projektet demonstruese të PMPHK1 si dhe ato më të avancuara të investimit kapital të PMPHK2 u zhvilluan përbrenda kornizës së vizionimit. Sidoqoftë, vetëm disa nga këto komuna me të vërtetë përfituan nga rasti i krijuar nga punëtoritë e vizionimit për ta shtyrë procesin planifikues drejt veprimeve konkrete strategjike. Kjo është padyshim pjesërisht për shkak të mungesës së buxhetit për investime publike por ka të bëjë edhe me shumë faktorë tjerë si statusi i paqartë apo edhe i kontestuar i tokës dhe ndërtesave publike, mungesa e mekanizmave për menaxhim të tokës dhe në përgjithësi mungesa e kapaciteteve për t'i menaxhuar projektet strategjike planifikuese.

Duke u kthyer për herë të fundit te matrica, faktori etnik nuk përmendet në mënyrë eksplicite por pavarësisht kësaj është i rëndësishëm, sidomos në rastin e Kosovës së pas konfliktit. Proceset njëmend përfshirëse natyrisht gjithmonë inkuadrojnë të gjitha komunitetet etnike, edhe pse në praktikë kjo nuk është gjithmonë gjë e lehtë për t'u arritur. Punëtorja e parë e vizionimit për Mitrovicën – qytetin e ndarë prej lumit Ibër në pjesën jugore me shumicë shqiptare të Kosovës dhe pjesën veriore me shumicë serbe të Kosovës dhe grupe tjera minoritetesh si boshnjakë dhe romë të shpërndarë në të dy pjesët – ishte një nga sfidat më të vështira pasi që synonte takimin e të gjitha komuniteteve të qytetit të ndarë. Si funksionoi para, gjatë dhe pas punëtorisë së vizionimit do të shqyrtohet më vonë në këtë kapitull. Në rastet e tjera të vizionimit, minoritetet si romët-ashkallitë-egjiptasit (RAE) dhe boshnjakët po ashtu u përfaqësuan por asnjëherë nuk lobuan për ndonjë trajtim të veçantë për komunitetet e tyre. Mamusha dhe Graçanica ishin rastet më të spikatura ku komunitetet pakicë të Kosovës morën udhëheqjen e procesit të vizionimit; komuniteti turk në rastin e Mamushës dhe ai serb i Kosovës në rastin e Graçanicës. Mitrovica mbeti rasti i vetëm me përbërje 50-50 prej dy komuniteteve më të mëdha shumicë dhe pakicë të Kosovës.

Në punëtorinë e Mitrovicës po ashtu ishte interesante të shihet se a do të përfitonte procesi prej ushtrimit të mëhershëm të vizionimit me planerët komunal. Rezultoi se ky ishte rasti dhe ishte mjaft inkurajuese të shihen se si planerët e trajnuar shqiptarë të Kosovës ndanin kapacitetet e tyre, të fituara, me kolegët e tyre serbë në një mënyrë tejet kolegjiale. Për ta arritur këtë qëllim, të gjithë arkitektët planerë nga të dy anët e qytetit u vendosën në një grup punues, të quajtur grupi i planerëve. Kjo metodë u përsërit vetëm edhe në punëtorinë e Gjilanit për shkak të kulturës planifikuese. Në të gjitha rastet tjera, planerët dhe pjesëtarët tjerë të komunitetit me qëllim përziheshin që ishte dukshëm qasje më e përshtatshme për vizionim të integruar dhe përfshirës të komunitetit.

Përgatitja për punëtorinë e parë të vizionimit të komunitetit mori pak a shumë gjashtë muaj, përderisa punëtoritë e tjera kërkuan shumë më pak përgatitje pasi që kaluan përafërsisht nëpër metodologji dhe program të njëjtë.

Pasi që punëtorja për qytetin etnikisht të ndarë të Mitrovicës duhej të zhvillohej në vend neutral, që nuk mund të gjendej brenda ‘kufijve’ komunal e as brenda Kosovës, punëtorja u zhvillua në Shkup, Maqedoni, me kornizën e njëjtë kohore prej pesë ditësh përfshirë dy ditë udhëtimi.

Përparësia më e madhe e kësaj qasjeje ishte dinamika e njerëzve që udhëtonin së bashku, bisedonin me njëri-tjetrin, punonin së bashku, argëtoheshin së bashku, pa kaluar në rutinat ditore. Këto dinamika të grupit zakonisht gjenerojnë ide më kreative se sa në ndonjë situatë tjetër. Përderisa disa njerëz nuk marrin pjesë gjithmonë, tjerët nuk mund të ndalen së menduari dhe punuari.

Kjo qasje kërkon angazhim më të madh logjistik dhe buxhet më të madh për t’i mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit. Së fundi, nuk ka mundësi për përfshirjen e vizitave në terren dhe

diskutimeve në vend të ngjarjes, që rrit rrezikun e përfundimit me një vizion joreal. Për këtë arsye, gjithmonë rekomandohet që kjo punëtori fillestare e vizionimit të pasohet me një takim më të vogël vizionimi për të arritur një vizion më të integruar dhe rezistues si kontribut për komunën apo çfarëdo plani tjetër hapësinor formal. Prezantimi publik i rezultateve të vizionimit shpejt pas punëtorisë mund ta krijojë përshtypjen se punëtorja e vizionimit është thjeshtë një ngjarje argëtuese për ca njerëz.

Pasi që shumica e pjesëmarrësve nuk ishin të informuar rreth planifikimit, programi i punëtorisë u përgatit duke përfshirë trajnim bazik për hapat themelor të planifikimit strategjik dhe përfshirës, fuqinë e vizionimit, si dhe trajnim më teknik për mënyrën e për zgjedhjes së temave kyçe, se si të zhvillohet analiza adekuate, si të shkruhen deklaratat e vizionit dhe në fund, si të projektohet struktura e dëshiruar hapësinore. Sikurse formati i programit ashtu edhe sesionet trajnuese janë shpjeguar dhe ilustruar në Shtojca të ndara – ku ofrohen veglat themelore për organizimin e punëtorive të vizionimit (shih Shtojcën 8 për ‘Formatin e Punëtorisë’ dhe Shtojcën 9 për ‘Sesionet Trajnuese’).

ARRITJA E REZULTATEVE


Kritike për arritjen e rezultateve është kuptimi i përbashkët i të arriturave në të kaluarën, tashmen dhe të ardhmen. Metodrat e shfrytëzuara për arritjen e këtyre qëllimeve themelore shpjegohen në Shtojcën 9, që paraqesin edhe një vegël esenciale për punëtori të suksesshme të vizionimit.

Siç u bë e qartë në kapitujt e mëparshëm, moderimi dhe fasilitimi i mirë është vendimtar për suksesin e cilëndo punëtori vizionimi. Modeli i zgjedhur funksionoi me:

- Moderator neutral me njohuri të gjuhëve zyrtare.

“Failing to plan is planning to fail”

Winston Churchill



- Një apo më shumë moderatorë të komunitetit drejtonin dinamikën e grupit në drejtim pozitiv – në rastin e punëtorisë së Mitrovicës moderatorë komuniteti nga secili grup etnik u caktuan nga pala punuese e vizionimit.
- Fasilitatori/trajnesi i përmbajtjes ofroi trajnim themelor mbi planifikimin dhe udhëzime për secilin sesion punues.
- Fasilitatorë shtesë të përmbajtjes për t'i mbështetur dhe asistuar grupet e ndryshme punuese në arritjen e rezultateve të mirëfillta.

Një zhvillim pozitiv për gjatë dhjetë punëtorive të vizionimit ishte angazhimi dhe kapaciteti i rritur i partnerit bashkë-organizativ vendor, OJQ-së Trashëgimia Kulturore pa Kufij (shih Shtojcën 1). Duke ju përmbajtur dhe promovuar qasjes përfshirëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ajo u bë një nga OJQ-të më të shkathta dhe më me përvojë në trajtimin e këtyre aspekteve në kontekstin e planifikimit hapësinor. Trashëgimia Kulturore pa Kufij ishte fuqimisht e përfshirë në konservimin dhe planifikimin zhvillimor në disa prej komunave. Mbështetja e Trashëgimisë Kulturore pa Kufij ishte unike në sigurimin e stafit, disa prej të cilëve vepronin si fasilitatorë të përmbajtjes apo animues. Rasti më i suksesshëm i sinergjisë dhe bashkëpunimit në mes të Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal/UN-Habitat dhe Trashëgimisë Kulturore pa Kufij është padyshim punëtorja e vizionimit dhe i tërë procesi i planifikimit në komunën e Junikut, një prej rasteve më të mira të prezantuar në Konferencën për Vizionimin si Mjet i Planifikimit Pjesëmarrës. Por edhe në katër komunat tjera bashkëpunimi në mes UN-Habitat-it, Trashëgimisë Kulturore pa Kufij dhe komunitetit lokal ishte një aktivitet i suksesshëm, sidomos kur trashëgimia kulturore e natyrore u identifikuan si çështje kyçe për zhvillimin e ardhshëm.

Për më tepër, *Friedrich-Ebert-Stiftung* (FES, shih Shtojcën 1) ofroi përkrahje për punëtoritë e vizionimit, por kryesisht përkrahje morale dhe financiare.

Përfshirja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor po ashtu meriton kujdes. Instituti i Planifikimit Hapësinor (IPH) u ftua të merr pjesë në të gjitha punëtoritë e vizionimit. Së pari, kjo kishte për qëllim të ofronte ‘mësim përmes përvojës’, duke kapitalizuar nga punëtoritë e mëparshme të vizionimit përbrenda IPH-së dhe me Ministrinë e Transportit në zhvillimin e korridoreve në Kosovë (shih më lart). Së dyti, IPH-ja luajti rol të dobishëm në Planin Hapësinor të Kosovës si kornizë referencë dhe burim i frymëzimit jo vetëm në aspektin përmbajtësor por edhe në shfrytëzimin e koncepteve hapësinore dhe dizajnëve hapësinore. Pas punëtorisë së vizionimit, Departamenti i Plani-

fikimit Hapësinor gradualisht u inkuadrua më shumë për të siguruar integrim të lehtë të vizionit të komunitetit në formatin e paraparë ligjor të Planit Komunal Zhvillimor.

Punëtorja e parë e vizionimit të komunitetit u parapri nga një ‘trajnim për vizionim’ të organizuar bashkërisht për stafin e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal-UN-Habitat-it dhe përfaqësuesit e IPH-së në shtator 2006. Trajnimi padyshim u ndihmoi pjesëmarrësve ta kuptojnë më mirë metodologjinë e fokusuar në ndërtimin gradual të vizionit në proces të strukturuar, por disi nuk arriti të trajtojë komunitetet, që natyrisht është thelbësore për vizionimin e komunitetit. Prapëseprapë, trajnimi i inkurajojë pjesëmarrësit t'i frymëzojnë dhe mobilizojnë udhëheqësit përkatës komunal dhe komunitetet për ta pranuar ftesën e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal për zhvillimin e punëtorive për vizionim të komunitetit. Para punëtorive të vizionimit, UN-Habitat-i organizoi një lloj sesionesh me organizatat lokale të shoqërisë civile, kryesisht nga perspektiva e planifikimit gjinor që rezultoi në ‘grupe të komunitetit’ joformalisht të organizuara dhe strukturuar, të njohura si ‘Këshillat Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile’ (KJOSHC). Këta KJOSHC shpeshherë *de facto* funksiononin si ‘palë punuese’ lokale për të bashkë-organizuar punëtoritë të vizionimit, si dhe për të përzgjedhur pjesëmarrësit. KJOSHC po ashtu ishte shumë i dobishëm në sigurimin e procesit pasues pas punëtorisë së vizionimit, prej prezantimit publik deri të përgatitja e një dizajni dhe deklarate të integruar të vizionit. Punëtoritë e vizionimit zhvilluan dhe fuqizuan KJOSHC-në, dhe në disa raste edhe morri formën e një ‘kundërshtari të pushtetit’ duke kundërshtuar vendimet planifikuese të komunës kur ato nuk ishin në vijë me vizionin e komunitetit të zhvilluar gjatë punëtorisë. Rastet e tilla të mos-respektimit ishin më të shpeshta në ato komuna ku i tërë procesi i planifikimit ishte tenderuar, hartuar nga kompanitë planifikuese dhe , apo kur procesi i planifikimit ishte duke u zhvilluar për një kohë të gjatë.

Rasti i Ferizajt është më i spikaturit, ku KJOSHC shfuqizoi një vendim komunal rreth sheshit qendror, i cili ishte në kundërshtim me vizionin e komunitetit. Vizioni i komunitetit dhe KJOSHC-së luajti rol më bashkëpunues në këto komuna ku procesi i planifikimit sapo kishte filluar dhe/ose ku komuna ishte në rol udhëheqës të procesit të planifikimit (planifikimi i brendshëm). Sidoqoftë, në të gjitha rastet, punëtoritë e vizionimit zhvilluan dhe fuqizuan shoqërinë civile lokale. Pothuajse të gjithë numrat e buletinit të Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal raportuan apo trajtuan punëtoritë e vizionimit, duke ju dhënë zë përfaqësuesve të shoqërisë civile për

përvojat e tyre dhe pritjet e ardhshme pas pjesëmarrjes në punëtorinë e vizionimit (shih Shtojcën 11). Për më tepër, dy fletushka të veçanta u botuan për të promovuar dhe shpjeguar vizionimin e komunitetit.

Gradualisht, webfaqja e UN-Habitat-it Kosovë ofroi gjithnjë e më shumë informata dhe është shndërruar në një lloj biblioteke virtuale (shih www.unhabitat-kosovo.org). Mediat lokale (shtypi, radio dhe TV) po ashtu rregullisht raportuan mbi punëtoritë e vizionimit dhe prezantimet publike si pjesë e proceseve të planifikimit komunal. E tërë kjo kontribuoi jo vetëm në rritjen

e njohjes dhe vlerësimit të vizionimit të komunitetit si vegël për pjesëmarrje në planifikim – por edhe rriti ‘komunitetin e vizionimit’ të grupeve të interesit të berberë nga planifikues me përvojë në vizionim. Kjo kulmoi me konferencën me pjesëmarrje të mirë të mbajtur më 9 nëntor 2010 në Prishtinë.

Megjithatë, para se të vlerësohen praktikat e mëhershme të vizionimit dhe qëllimit të eksplorimit të mundësive të ardhshme për vizionim, vlen të theksohen disa nga aktivitetet e pas-vizionimit, si edhe veprime tjera, ku vizionimi është bazuar në praktikë.

Bashkë krijojmë qytete më të mira

FLETUSHKË

Programi i Mbeshtetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (PMPHK)

Nr. 01/07 ■ Shkurt 2007

Vizionimi i qytetit tuaj

Vizionimi është aktivitet që përfshin qytetarët dhe pjesëmarrësit për të formuar një vizion të përbashkët për të ardhmen e bashkisë së tyre (komunë, qytet, qytezë apo fshati). Qëllimi i vizionimit është të nxirren deklaratat të shkruara dhe vizuale të qëllimeve afatgjate dhe synimeve strategjike të bashkisë në planifikimin urban dhe hapësinor.

Me këtë broshurë dëshirojmë të promovojmë konceptin e Vizionimit si element thelbësor në proceset e planifikimit përfshirës hapësinor lokal, që zbatohet në gjitha komunat e Kosovës.

Cilat janë karakteristikat e një vizioni të fuqishëm?

- Shikon synimet afatmesme dhe afatgjata (5-20 vjet) dhe motivon veprimet e menjëhershme
- Eshhtë i qëndrueshëm në aspektin mjedisor, social dhe ekonomik, dhe është i integruar në aspektin hapësinor
- Eshhtë rezultat i diskutimit mes gjitha palëve të përfshira, pra komunitetit dhe pjesëmarrësve
- Eshhtë vizionar, por real
- Eshhtë i lehtë të shpjegohet dhe kuptohet edhe nga jo-profesionistët
- Eshhtë i thurur brenda procesit të vendimmarrjes publike në planifikim
- Eshhtë i mbështetur me një përkushtim të fuqishëm në implementimin e atij Vizioni.

Pse Vizionimi?

- Për të inspiruar, përqendruar vëmendjen dhe mobilizuar gjithë banorët, pjesëmarrësit, politikanët dhe zyrtarët në krijimin e së ardhmes së dëshiruar për zonën (komunale).
- Për të mobilizuar investitorët për të investuar në zhvillimet e dëshiruara për të ardhmen

Njerëzit e moshave, gjinive, historive dhe kulturave të ndryshme shpesh kanë perspektiva të ndryshme. Duke siguruar që spektri i plotë i një komuniteti është përfshirë në ushtrimin e Vizionit, ofrojmë një vizion të fuqishëm dhe përfshirës. Aktorët/ pjesëmarrësit nuk duhet të frikësohen nga "konsulentët" dhe "profesionistët" me përvojë, por të sigurojnë që procesi i planifikimit të Vizionit dhe Komunitetit është "pronë" e banorëve të vendit dhe palëve me interes.

Aktorët në Vizionim

- Pjesëmarrësit e zonës
- Shoqëria civile, sidomos rinia, fëmijët dhe pakicat
- Planerët hapësinorë (dizajnerë dhe jo-dizajnerë)
- Moderatorë/ndërmjetës
- Vendim-marrësit

- Për të zbatuar Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor, si element thelbësor i Planit Zhvillimor Komunal në komunën tuaj
- Për të ndërtuar pajtimin dhe ndjenjën e pronësisë lokale mbi Planin Zhvillimor Urban dhe atë Komunal.



Teknika e Vizionimit në PLANIFIKIMIN PJESËMARRËS



Vizionimi është një aktivitet i cili i bashkon qytetarët dhe palët me interes për ta krijuar një vizion të përbashkët për të ardhmen e komunitetit të tyre (komunë, qytet, qytezë apo fshat). Qëllimi i vizionimit është hartimi i deklaratave me shkrim dhe vizuale lidhur me qëllimet afatgjate të komunitetit dhe objektiveve strategjike për planifikimin e qëndrueshëm urban dhe hapësinor. Me anë të kësaj fletushke, ne dëshirojmë që ta promovojmë konceptin e vizionimit si një element i rëndësishëm në proceset lokale përfshirëse për planifikimin hapësinor, që mund të aplikohet në të gjitha komunat në Kosovë.

Pse vizionimi?

- Për të frymëzuar, përqendruar vëmendjen dhe mobilizuar të gjithë qytetarët, komunitet, palët me interes, politikanët dhe zyrtarët në krijimin e ardhmërisë së dëshiruar për atë zonë (komunale);
- Për të mobilizuar investuesit që të investojnë në zhvillimet e dëshiruara për të ardhmen;
- Për t'ju përmbluar Ligjit për Planifikimin Hapësinor gjatë krijimit të vizionit si një element themelor i Planit Zhvillimor Komunal në komunën tuaj;
- Për të ndërtuar koncenzusin dhe pronësinë vendore ndaj Planëve Zhvillimore Komunale dhe Urbane

KATRORI 8.

KONFERENCA E VIZIONIMIT E KOSOVËS



Konferenca mbi Vizionimin si Mjet i Planifikimit Pjesëmarrës ishte tema kryesore e konferencës më 9 nëntor 2010, të organizuar nga Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal të UN-Habitat-it dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Konferenca u mbështet nga komunat dhe OJQ-të, **Friedrich-Ebert-Stiftung** dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Në katër vitet e kaluara, punëtoritë e vizionimit u organizuan në 10 komuna, si aktivitete përfshirëse me pjesëmarrje aktive të zyrtarëve të qeverisë lokale dhe organizatave të shoqërisë civile. Grumbulloi rreth 150 profesionistë të planifikimit prej tërë Kosovës për të diskutuar dhe ndarë përvojat e tyre në planifikimin pjesëmarrës e strategjik në Kosovë dhe jashtë saj. Konferenca filloi me fjalën hyrëse të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i cili e foli për ndikimin e dukshëm të punës së bërë deri më tani. Në fjalën e saj hyrëse, shefja e UN-Habitat-it Kosovë theksoi rolin e UN-Habitat-it dhe bashkëpunimin e tij me komunat. Prezantimi i parë i konferencës u bë nga dy zyrtarë të Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal të cilët e përshkruan procesin e plotë të vizionimit dhe disa nga mësimet e nxjerra. Aty pati edhe prezantime nga ekspertë prej Suedisë, Shqipërisë dhe Turqisë, të pasuara ne shembuj nga tri komunat e Kosovës. Përfaqësuesit e Departamentit dhe Institutit të

Planifikimit Hapësinor të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Universitetit të Prishtinës dhe shoqërisë civile po ashtu dhanë prezantimet e tyre. Debati përfundues dëshmoi qartë se kuptimi i, dhe pjesëmarrja në procesin e planifikimit është ende relativisht e dobët në Kosovë, pjesërisht për shkak të periudhës së tranzicionit nëpër të cilën Kosova ende po kalon. Për më tepër, shih: www.unhabitat-kosovo.org

KAPITULLI 5

REZULTATET E

VIZIONIMIT

Nuk mjafton vetëm të shikohen me ngulm shkallët, duhet të ngjitemi në to,” Vaclav Havel

Sidoqoftë, para vlerësimit të ushtrimeve të kaluara të vizionimit dhe shqyrtimit të mundësive të ardhshme të vizionimit, vlen të theksohen disa nga aktivitetet post-vizionuese si dhe veprimet tjera ku vizionimi është aplikuar në praktikë.

Duke ju referuar ‘Ciklit të Vizionimit’ të paraqitur më parë, krijimi i vizionit paraqet fazën e parë. Ka ardhur koha të shohim nëse dhe çfarë lloj aktivitetesh pasuese ka shkaktuar vizionimi i parë i komunitetit në Kosovë. Larg nga synimi për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të plotë, vlen të theksohen tiparet relevante për fazat e ciklit të vizionimit.

Hapi i parë pas krijimit të vizionit të komunitetit ishte ndarja e vizionit. Pasi që vizionimi bëhet vetëm me një grup të vogël të pjesëtarëve të komunitetit, është qenësore të ndahet ky vizion me tërë komunitetin apo së paku me një numër më përfaqësues të banorëve dhe grupeve të interesit në hapësirën për të cilën hartohet plani.

Natyrisht ka shumë mënyra për ta bërë këtë. Fillon gjatë punëtorive të vizionimit, pjesëmarrësit duke ju shkruar e-mail, sms apo telefonuar familjes dhe miqve për çka janë duke bërë. Kjo bartje e fjalëve do të shumëfishohet edhe pas përfundimit të punëtorisë.

Veçmas është më rëndësi në rastin e vendimmarrësve dhe opinionisteve që ishin pjesë e sesioneve të punëtorisë apo prezantimit final. Shkrimi i ndonjë artikulli për buletin e UN-Habitat-it/ Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal apo për gazetat lokale, revistat dhe faqet e internetit (webfaqet), do të kontribuonin në informim të mëtejshëm (shih gjithashtu Shtojcën 11).

RAPORTET E PUNËTORISË

Sidoqoftë, esenciale për aktivitete pasuese efektive është përgatitja e raportit të punëtorisë, duke pasqyruar procesin dhe arrijtet e punëtorisë së vizionimit, ilustruar me shumë foto (shih për shembull raportet nga punëtorja e vizionimit në komunat partnere të PMPHK-it). Mënyra më efektive e ndarjes së rezultateve të punëtorisë së vizionimit, siç dëshmohet nga përvoja, është organizimi i prezantimit publik të rezultateve të punëtorisë së vizionimit, mundësisht duke përfshirë prezantimin e raportit të punëtorisë. Kjo duhet të bëhet brenda 4-6 javëve pas punëtorisë, kur idetë janë ende të ‘freskëta’ dhe ka mjaft kohë për ta përgatitur këtë prezantim.

Kjo ngjarje duhet të përgatitet dhe paraqitet ekskluzivisht nga përfaqësuesit e komunitetit. Në mënyrë që të paraqiten të gjitha rezultatet në prezantimin publik, komuniteti duhet natyrisht ta sigurojë materialin e rezultatit të punëtorisë (që nga harta e kujtesës në dizajnet e vizionit, përfshirë edhe tabelat SWOT dhe deklaratat e vizionit). Organizim i qartë duhet të bëhet me kë dhe kur do të shkojnë p.sh. departamenti i urbanizmit apo KJOSHC (Këshilli Joformal i Organizatave të Shoqërisë Civile). Vetëm në rastin e qytetit të ndarë të Mitrovicës, ekipi lokal i UN-Habitat-it i ka ruajtur origjinalet për të siguruar paanësinë e procesit. KJOSHC ka dëshmuar të jetë platforma më e mirë për përgatitjen e prezantimeve publike, shpeshherë të ndihmuar nga stafi i Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal dhe Trashëgimisë Kulturore pa Kufij. Përveç në rastin e Mitrovicës, të gjitha prezantimet tjera publike u zhvilluan në komunë, duke ofruar hapësirë për publik, pajisje teknike si monitorë, projektorë dhe laptop ne rastet kur ishin në dispozicion, si dhe sistem të mirëfilltë dhe së fundi pije freskuese. Shumica e vendtakimeve ishin në komunë, shkollë, teatër komunal

apo qendër kulturore. Si komunë e re, Juniku nuk mund të mbështetëj në këto vende konvencionale dhe vendosi për një lokacion më alternativ (dhe kreativ): *kullë* të restauruar private në mes të këtij fshati malor (shih më tej).

Duke ofruar edhe muzikë argëtuese, ushqim të përgatitur lokal dhe vizitë interesante në disa prej vendeve të trashëgimisë kulturore, Juniku e shndërroi prezantimin tradicional të vizionit në një ngjarje kulturore duke siguruar që të ekzistonte e drejta e njerëzve për të bërë pyetje dhe komente, edhe kritika, rreth vizionit të prezantuar të komunitetit. Në të shumtën e rasteve, mediat lokale ftoheshin për të përcjellë prezantimet publike duke siguruar informim më të gjerë edhe përtej komunitetit.

Në Ferizaj, gazetarët lokal janë ftuar në punëtorinë e vizionimit. Edhe pse ata merrnin pjesë në cilësi private si pjesëtarë të komunitetit, punëtorja e zhvilloi kuptimin e tyre dhe vlerësimin për metodën dhe rezultatet, gjë që ishte e dobishme më vonë kur ata raportuan mbi punëtorinë dhe aktivitetet pasuese. Gazetarët e involvuar jodrejtëpërdrejt në vizionim ose e nënvlerësonin ose e mbivlerësonin vizionimin e komunitetit: e nënvlerësonin duke mos i kushtuar kujdes adekuat dhe e mbivlerësonin duke krijuar pritje të larta që vizioni është gati dhe shpejt do të shndërrohet në realitet. Për këtë arsye, një strategji e qartë publike është e nevojshme për të përcjellë mesazhet e duhura dhe për të përmirësuar ato të gabuara apo tejet të thjeshtësuara. Do të ishte shumë e dobishme për shembull t'u ofrohet mediave shënime me fakte rreth vizionimit të komunitetit si pjesë e procesit të planifikimit përfshirës.

Pasi që vizionet zakonisht perceptohen si ëndrra joreale, është thelbësore të ofrohen shtytje për zbatimin e tyre gradual. PM-PHK1 ndau bashkëfinancim të kufizuar për demonstrimin e projekteve duke shfaqur planifikim pjesëmarrës dhe qasje të vizionimit. Mekanizmat bashkëfinancues duhej të siguronin që autoriteti lokal po ashtu te ndante buxhet dhe kohë për 'demo-projektin', si dhe përkushtim për zbatimin e projektit në mënyrë pjesëmarrëse duke respektuar vizionin e komunitetit.


Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal zhvilloi gjithsej gjashtë 'demo-projekte', me rezultate dhe ndikime të ndryshme, por ata hapën rrugën për projekte më të strukturuar dhe komplekse të investimit kapital të iniciuar gjatë fazës së dytë të Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (shih Shtojcën 12 dhe Shtojcën 13).

Në të shumtën e këtyre rasteve, u aplikua teknika e vizionimit të komunitetit ë së paku deri në një masë të caktuar – për dizajnimin e projektit të dëshiruar. Një konkurs ndërkombëtar për dizajn të Qendrës së Mobilitetit në Ferizaj ishte lloji i veçantë i projektit demonstrues. Dokumenti i dizajnit u bazua në re-

KATRORI 9.

VIZIONI I GRAÇANICËS BASHKON PLANIFIKUESIT ME QYTETARËT

"Komuna e Graçanicës, e pasur me thesare antike dhe të mesjetës dhe bukuri natyrore – mjedis modern me ekonomi dhe infrastrukturë të zhvilluar ku të gjithë i gëzojnë të drejtat dhe liritë e njëjta." Kjo është deklarata e vizionit e përgatitur nga grupi i qytetarëve dhe planerëve profesionistë të cilët vijuan punëtorinë 4-ditore për komunën e Graçanicës. Rezultati i punëtorisë iu prezantua një publiku më të gjerë më 3 shkurt 2011; duke ofruar mundësinë që secili qytetar i Graçanicës të paraqet ide të reja për zhvillimin e ardhshëm të kësaj komune të re. Në fjalën hapëse, kryetari i Graçanicës, i falënderoi të gjithë kontribuesit, UN-Habitat-in, Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për mbështetjen e tyre për punëtorinë e vizionimit. Udhëheqësja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë tha se punëtorja e vizionimit është faza fillestare e hartimit të Planeve Komunale dhe të Zhvillimit Urban që kontribuon në ndërtimin e kapacitetit të stafit komunal dhe shoqërisë civile, stimulon idetë për projekte të investimit kapital dhe fuqizon shoqërinë civile të luajë rol më aktiv në zhvillimin e komunës. Prezantimi multi-medial vazhdoi me prezantime të grupeve punuese për Trashëgimi Natyrore dhe Kulturore, Infrastrukturë dhe Mobilitet, Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Sociale e Banim.



Teksti dhe fotot e burimit: UN-Habitat/Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal

zultatet e punëtorisë së vizionimit të komunitetit për planin zhvillimor komunal dhe urban. Përkundër shpërblimit modest me të holla, projekti pati sukses në mobilizimin e arkitektëve, planifikuesve dhe dizajnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët dorëzuan një varg idesh të vlefshme dhe interesante. Juria i shpalli tre fitues por edhe theksoi nevojën e kombinimit të ideve interesante prej më shumë se një propozimi, si dhe nevojën e përfshirjes dhe negocimit me grupet më të rëndësishme të interesit, kompaninë e hekurudhave të Kosovës. Projekti dëshmoi qartë vlerën e dizajnit urban por lëshoi mundësinë e inicimit të një procesi bashkëpunues të 'negocimit përmes dizajnit' siç u shpjegua më herët.

Sa i përket vizionimit të komunitetit dhe projektimit të komunitetit, spin-off-i special ishte projekti përcaktues nënë Programin e parë të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal. Objektivi ishte të rritet vetëdijesimi i rolit, dobietë dhe proceset e të ashtuquajturit proces të 'krijimi i vendeve' (krijimi i vendeve publike me funksion) në Kosovë, me parime dhe udhëzime të përgjithshme të testuara në gjithsej 22 lokacione të gjashtë qyteteve regionale. Misioni 'krijimi i vendeve' ishte i suksesshëm në ngritjen e vetëdijes rreth rëndësisë së dizajnit pjesëmarrës dhe se si mund të arrihet ai. Pjesëmarrësit e punëtorisë u zgjodhën bazuar në rolet e tyre kryesore në prodhimin dhe mirëmbajtjen e aspektit publik. Kjo zhvilloi përparësitë e punëtorive duke siguruar që njerëzit që mund të bëjnë ndryshime të vërteta tani janë më të informuar pse duhet ta vlerësojnë 'krijimin e vendeve'. Shembujt e projekteve po ashtu demonstruan se procesi bashkëpunues i dizajnit nuk ishte edhe aq i vështirë për t'u organizuar dhe ndërmarrë dhe ju ofroi pjesëmarrësve shembuj praktik të udhëzimeve për 'krijimin e vendeve'.

Duke kaluar shpejtë në fazën e zbatimit përmes pilot veprimeve, ne i harruam dy hapa të mesëm të rëndësishëm të 'Ciklit të Vizionimit': shqyrtimin kritik të vizionit që çon në harmonizimin dhe konsolidimin e tij. Idealisht, prezantimi plenar dhe diskutimi i dizajneve tematike të vizionit do të duhej të ofronte hapin e parë të identifikimit të elementeve të përbashkëta dhe të ndryshme të komponentës së vizionit, si në fund të punëtorisë së vizionimit në Mitrovicë. Ky ushtrim duhej të udhëhiqej nga një fasilitator i përmbytjes, mundësisht me njohuri të avancuara të hapësirës për te cilën hartohet plani. Ekspertët e planifikimit po ashtu janë të nevojshëm për udhëheqjen e grupeve të komunitetit drejt një kalimi të lehtë në një dizajn më të integruar të vizionit, gjithashtu shpeshherë i quajtur si 'struktura e dëshiruar strategjike hapësinore' e zonës për te cilën hartohet plani. Anëtarët më aktivë të punëtorisë si dhe ekspertët lokalë për planifikim, po të jetë e mundur, zakonisht drejtojnë grupin e komunitetit që është i gatshëm të sakrifikojë më shumë kohë të lirë se sa vetëm për punëtorinë e vizionimit.

Në disa raste eksperti lokal dhe/ose ndërkombëtar i planifikimit u angazhua nga UN-Habitat-i për t'i ndihmuar grupit të ko-

munitetit të arrijë dizajnin e integruar të vizionit. Sidoqoftë, ky ekspert duhet të ec nëpër një vijë të hollë duke shtuar 'eksper-tizë planifikuese' si dhe duke respektuar frymën e ideve të komunitetit të dala nga punëtorja fillestare e vizionimit. Metoda më e suksesshme e punës është kur eksperti i planifikimit arrin një vizion më të integruar përmes një serie punëtorish shtesë të vizionimit, siç ishte rasti në Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë.

Ky proces i harmonizimit zakonisht rezultoi në *dokument të integruar të vizionit*, rezultati më thelbësor pasues i vizionimit të komunitetit. Ai garanton që vizioni i komunitetit do të mund të konsolidohet në format formal të planifikimit, siç është Plani Komunal Zhvillimor.

Dokumenti i integruar i vizionit zakonisht hapet me pasqyrim të procesit të punëtorisë së vizionimit dhe me një profil të shkurtër të hapësirës për te cilën hartohet plani, bazuar në analizën e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të zhvilluar gjatë punëtorisë së vizionimit dhe të 'pasuar' me të dhëna statistikore dhe të tjera. Një pjesë tjetër më e vështirë dhe kyçe është 'dizajni i integruar i vizionit' apo 'struktura e dëshiruar hapësinore', bazuar në analizë kritike të elementeve tematike të vizionit. Kjo strukturë e dëshiruar për tërë hapësirën për te cilën hartohet plani, shpeshherë detajohet për zona specifike si qendrat urbane apo çfarëdo zone tjetër specifike e interesit strategjik.

Deklarata e integruar e vizionit e përgatitur në punëtorinë e vizionimit gjithashtu do të nevojitet të përshtatet me dizajnet e integruara të vizionit. Hapi i ardhshëm është identifikimi dhe caktimi i prioritetëve të veprimeve strategjike me projekte specifike territoriale si dhe masat, e përgjithshme të vlefshme, për tërë hapësirën planifikuese. Caktimi i prioritetëve shpeshherë shoqërohet me faza të projekteve dhe veprimeve të dëshiruara, shpesh sipas burimeve në dispozicion të autoritetit kryesor planifikues.

Së fundi, një varg rekomandimesh janë formuluar për proces të mëtejshëm të planifikimit dhe zbatimit, përfshirë ngritjen e pritjeve rreth konsolidimit të këtij 'Dokumenti të Integruar të Vizionit' në procesin e planifikimit formal dhe arritjet e tij. Për ta bërë këtë dokument mjet të mirëfilltë reference për komunitetin, nevojitet të legjitimohet nga komuniteti. Në rastet e Kosovës, kjo ka ndodhur zakonisht përmes 'Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile'. Ky 'proces i legjitimitetit' gjithashtu do të sigurojë pronësi dhe kujdes të vërtetë lokal gjatë tërë procesit të planifikimit dhe zbatimit. 'Dokumenti i Integruar i Vizionimit' do të ofrojë pikë të fuqishme referimi për komunitetin për shqyrtim publik dhe, po të jetë e nevojshme, shfuqizim të dokumentit formal të planifikimit pas dorëzimit të tij për shqyrtim publik siç parashihet me Ligjin për Planifikim Hapësinor. Praktikën më të mira në çuarjen përpara të rezultatit të punëtorisë së vizionimit përgjatë ciklit të vizionimit është Mitrovica jugore (shih Shtojcën 14) dhe Hani i Elezit (shih Shtojcën 15). Gjithashtu shih shembullin e Junikut në Shtojcën 13.

KAPITULLI 6

MËSIMET

E NXJERRA

Tani kur i tërë procesi i vizionimit është skicuar dhe është prezantuar cikli i realizuar deri më tani në Kosovë, ka ardhur koha që të analizohen mësimet e nxjerra për t'i përmirësuar më shumë praktikrat e vizionimit. Përkundër pasqyrës së përgjithshme të mirë, ekzistojnë shumë mangësi dhe të meta të cilat duhen adresuar dhe tejkalu për ta pasuruar metodologjinë dhe për t'i fuqizuar kapacitetet në këtë fushë.

“Asgjë nuk duket të jetë aq me kohë se sa vizioni i djeshëm për të ardhmen”

Christian De Quincey



Duke e përdorur njërin nga teknikat e aplikuara gjatë punëtorive për vizionim, është bërë aplikimi i analizës së përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve ndaj praktikës së deritanishme të punëtorive për vizionim në Kosovë. Kjo analizë është paraqitur dhe diskutuar në vijim.

Përparësitë dhe dobësitë e praktikave të Kosovës shpesh e pasqyrojnë njëra tjetrën. Prandaj, kjo tabelë mund të sqarohet më së miri me anë të çifteve të përparësive dhe dobësive që kanë të bëjnë me organizimet e mëparshme për vizionimin.

- Në çiftin e parë të 'formatit të testuar (përparësi) kundrejt 'formatit shabllon (dobësi)': 'formati i Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal' është metodë e vizionimit e cila është përgatitur në bazë të një numri të madh të instrumenteve për planifikimi të testuara ndërkom-bëtarisht, që i janë përshtatur nevojave dhe kufizimeve lokale. Ky format është dëshmuar si i fuqishëm për dy arsye kryesore: a) për shkak se rezultatet e menjëhershme sa i përket ideve

dhe vizioneve të bazuara në komunitet, në përgjithësi, ishin të kënaqshme dhe në disa raste edhe përtej parashikimeve dhe b) për shkak se në shumicën e rasteve ka pasur rezultate pozitive, që do të thotë se punëtoritë e vizionimit e kanë iniciuar apo nxitur ciklin e vizionimit që e kemi përshkruar më herët. Shpesh ai ka qenë i përcjellë me efekte 'spin-off' të cilat i kanë dhënë shtytje vizionimit nga komuniteti për 'operacione teknike' si për shembull projektet investuese dhe 'krijimi i vendeve'.

Megjithatë, gjithashtu ekziston edhe ana jo e mirë e këtij formulë-formati të suksesshëm. Pasi që është aplikuar tashmë dhjetë herë në të njëjtën mënyrë, gjatë një periudhe prej afër katër viteve, ai është bërë format shabllon. Në një farë mënyre, kjo është pothuaj në kundërshtim me një nga parimet themelore të planifikimit strategjik me pjesëmarrje: ai duhet t'i përshtatet kontekstit dhe rrethanave të caktuara. Natyrisht, konteksti dhe rrethanat kanë qenë shumë të ngjashme në shumicën e këtyre 10 rasteve, por asnjëherë

tërësisht të njëjta. Po ashtu, është e vërtetë se ‘formati i Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal’ ishte përgatitur në atë mënyrë që të mund t’i pranojë përshtatjet e vogla ndaj rrethanave të caktuara, për shembull duke i kushtuar më shumë ose më pak kohë secilit komponent. Për më shumë, vazhdon të mbetet pikëpyetje se si do të zhvillohej formati, nëse për shembull Ferizaj do kishte qenë rasti i parë testues, e jo qyteti etnikisht i ndarë i Mitrovicës. Një nga mangësitë e kopjimit të formatit të Mitrovicës pa dyshim ishte lokacioni i jashtëm i mbajtjes së punëtorive për vizionimin – një herë në Shkup dhe nëntë herë në Ohër, të dyja në IRJM – jo vetëm duke i shtuar kështu shpenzimet, por po ashtu duke e krijuar përshtypjen e një ‘pushimi luksoz’. Është e vërtetë se të gjitha aktivitetet tjera për vizionim nga komuniteti pas punëtorisë për vizionim janë mbajtur në afërsi të zonës për të cilën hartoheshin planet, por për fat të keq asnjëra nga punëtoritë disa ditore për vizionim që janë përfshirë në këtë publikim.

- Për çiftin e ‘organizimit profesional’ (përparësi) kundrejt ‘pronësia lokale e kufizuar’ (dobësi), mbështetja e dhënë nga Programi i UN-Habitat-it për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal dhe e organizatave partnere të tij ishte kritike për suksesin e përgjithshëm të kësaj formule, pavarësisht përkushtimeve të mirëfillta të komunave të përfshira dhe të komuniteteve të tyre. Si një OJQ e menaxhuar në nivel vendas, Trashëgimia Kulturore pa Kufij (*Cultural Heritage without Borders*), është pothuaj e vetmja që mund ta merr përsipër organizimin e punëtorive për vizionim siç janë bërë deri më tani, edhe pse planifikimi strategjik nuk është aktiviteti kryesor i tyre. Po ashtu, Instituti për Planifikimin Hapësinor (IPH) ka qenë një partner aktiv në punëtoritë për vizionim dhe e ka një masë domethënëse të përvojës së planifikimit me pjesëmarrje falë procesit të hartimit të ‘Planit Hapësinor të Kosovës’. Mirëpo, IPH asnjëherë nuk ka ndërmarë ndonjë projekt të ngjashëm me punëtoritë 5-ditore për vizionim nga komuniteti dhe ekzistojnë dyshime nëse raporti aktual ndërmjet detyrave kryesore dhe stafit në dispozicion do t’i lejojë që të merr përsipër organizimin e punëtorive për vizionim në të ardhmen. Mundësitë e tij për të mbledhur fonde të nevojshme janë një çështje tjetër. Në anën tjetër, është e qartë se komunitetet lokale dhe autoritetet komunale nuk janë në gjendje që ta realizojnë vizionimin nga komuniteti pa përkrahjen dhe financimin nga jashtë. Kjo do të thotë se përparësia e ndihmës nga Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal mund të bëhet dobësi, madje ndoshta edhe rrezik për këtë proces nëse UN-Habitati do t’i përfundonte aktivitetet e tij në Kosovë. Kjo gjë duhet të adresohet qartë në punëtoritë e ardhshme për vizionim, kurse rekomandimet për këtë çështje do të paraqiten në tekstin e mëtejshëm.

- Çifti i ‘fasilituesve të trajnuar’ (përparësi) kundrejt ‘trajnim i kufizuar i trajnerëve’ (dobësi) vazhdon nga përshkrimi i mësipërm. Por, edhe në kuadër të pjesës së organizimit të partnerëve ekziston nevoja për të investuar në zëvendësimin dhe zgjerimin e grupit të fasilituesve. Mungesa e programit për trajnimin e trajnerëve tani mund të shënohet si një dobësi, pasi që vazhdimësia dhe inovacioni nuk është i garantuar.
- Dyshja e çifteve ‘prej zeros’/‘dinamika pozitive e grupit’ (përparësi) kundrejt ‘nuk ka raport për planifikim’/‘nuk ka vizion të integruar’ (dobësi) gjithashtu ka nevojë për sqarime të mëtejme. ‘Prej zeros’ do të thotë se shihet si përparësi fakti se komuniteti mund ta fillojë vizionimin ‘pa u penguar nga planet apo studimet ekzistuese’. Kjo ka ndihmuar shumë në uljen e pragut dhe shtimin e pjesëmarrjes së jo-ekspertëve si dhe të ‘dinamikës pozitive të grupit’ në këtë proces. Mangësia e këtij qasjeje është rreziku i krijimit të një vizioni jorealit. Megjithatë angazhimi i planerëve-ekspertë ka siguruar një vizionim të arsyeshëm nga komuniteti, shtrihet pyetja nëse ekzistimi i një ‘raporti të planifikimit’ do të prodhonte vizione edhe më të mira. Raporti i planifikimit është një grumbull i parimeve udhëzuese të cilat janë të ngulitura në trungun ekzistues të planifikimit, si lokal ashtu edhe më gjerë. Vetëm në rastin e punëtorisë për vizionimin e Qendrës Edukative dhe Sportive në Pejë ishte përgatitur një lloj raporti për planifikim që iu dorëzua pjesëmarrësve, duke sjellë rezultate më të fokusuar për vizionin. Mungesa e raportit për planifikim është, gjithashtu, arsyeja pse është vështirë të krijohet një ‘projekt i integruar për vizionin’. Formatit i zgjedhur për të punuar me grupe dhe vizione tematike natyrisht se i ka meritat e tij, pasi që ka stimuluar më shumë ide dhe kreativitet, por një raport për planifikim ka mundur të ndihmojë në zvogëlimin e konflikteve të brendshme ndërmjet vizioneve tematike. Megjithatë, kjo ‘dobësi’ është kompensuar kryesisht me anë të aktiviteteve pas vizionimit për prodhimin e vizionit të integruar, bashkë me raportin e vizionit si një hap i ndërmjetëm, dhe me dokumentin e integruar për vizionin si rezultat përfundimtar dhe kontribut në dokumentet zyrtare për planifikim).
- Në grumbullin e fundit të ‘bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve’/‘të menduarit kreativ/ide të mençura’/‘ndryshimet e qëndrimit’ (përparësi) kundrejt ‘zbatimit të kufizuar’/‘shpenzimeve të larta’ (dobësi): ‘ndryshimi i qëndrimeve’ me siguri është përparësia më e madhe e këtij procesi; drejt planifikimit në përgjithësi (ndërmarrje më shumë sociale se sa teknike); drejt planeve në veçanti (më lehtë për ta kuptuar dhe sqaruar kur hartohen nga pjesëtarët jo-ekspertë të komunitetit); dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme drejt pjesëmarrjes së publikut që shpesh rezultojnë në caktimin e një standardi të ri në komunën ku është bërë vizionimi nga komuniteti. Mangësia e

‘shpenzimeve relativisht të larta’ të formatit të përzgjedhur për vizionimin është dobësi vetëm atëherë kur autoritetet planifikuese të vendit ndajnë pak ose fare nuk ndajnë buxhet konkretisht për planifikimin me pjesëmarrje. Siç e kemi parë tek praktikata më të mira të *Spoor Noord* në Antwerpen/Belgjikë (shih Shtojca 4), në masë të madhe suksesi i tij është rezultat i një buxheti të konsiderueshëm për pjesëmarrjen publike.

Dobësia lidhur me faktin se disa nga këto vizione kreative duhen të zbatohen rëndon më pak se sa meritat për ndryshimin e qëndrimit. Fillimisht për shkak se ‘zbatimi’ i një vizioni afatgjatë thjeshtë kërkon një kohë të gjatë. Së dyti, për shkak se ‘zbatimi’ duhet të përshtatet në ciklin e vizionimit, që do të thotë se hapat vijues sikurse prodhimi i raportit të vizionit dhe i dokumentit të integruar për vizionin janë hapa tejet të rëndësishëm për projektet strategjike konkrete. Së treti, për shkak se vizioni ka shërbyer si një gjenerator dhe katalizator për demo-projektet dhe projektet për investime kapitale, të cilat mund të shihen si “spin-off”-a të suksesshëm të punëtorive për vizionim dhe ndryshimeve të qëndrimit që i ka nxitur ai.

MUNDËSITË DHE RREZIQET E JASHTME

Duke i shikuar mundësitë dhe rreziqet e jashtme për planifikimin me pjesëmarrje dhe zbatimin e projektit, çështjet në vijim janë të rëndësishme:

- Popullata e re e Kosovës në masë të madhe është ende një rezervuar i pashfrytëzuar i dinamizmit dhe kreativitetit, i cili mund të mbetet në hije vetëm nga mungesa e arsimit të duhur, siç është mungesa e arsimit të nivelit Master në planifikimin hapësinor dhe menaxhimin urban.
- Perspektiva e integrimit evropian është një mundësi tjetër e madhe, por ritmi i Kosovës mund të ngadalësohet shumë nga pamundësia institucionale për t’i përmbushur kushtet për përafrim në Bashkimin Evropian.
- Siç është theksuar tashmë, ekzistimi i gatishmërisë së bashkësisë ndërkombëtare për ta mbështetur integrimin e Kosovës në të njëjtën kohë është i rrezikuar nga tërheqja graduale e mundshme e saj, derisa rritja e përkrahjes, po ashtu, mund të çojë drejt një vartësie edhe më të madhe, duke e përfshirë aspektin e gjerë financiar të saj.
- Qendrat lokale me njohuritë për planifikimin përfshirës ekzistojnë, por me gjasë janë shumë të pakta në numër dhe shumë të vogla në shkallën e tyre për t’u përballur me sfidat që janë përpara. Njësoj si në ndonjërin prej punëtorive për vizionimin, kjo analizë e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve është thjeshtë indikator dhe nuk përbën ndonjë dëshmi shkencore. Në anën tjetër, do ishte e mirëseardhur nëse kjo analizë indikatorëve do të mund të konfirmohej, të pasurohej apo edhe të rrëzohet nga hulumtimet shkencore dhe të pavarura.

Mbase një prej lëshimeve kryesore të praktikës së deritanishme të vizionimit në Kosovë është mungesa e çfarëdo komenti apo vlerësimi të strukturuar. Megjithatë ishte vendosur qëllimisht që nga pjesëmarrësit e vizionimit të mos kërkohej ta vlerësojnë punëtorinë menjëherë, mungesa e çfarëdo vlerësimi formal e bën të vështirë arritjen deri të një ‘vlerësim me pjesëmarrje’. Konferenca për Vizionimin si Mjet i Planifikimit me Pjesëmarrje ka treguar një kënaqshmëri të përgjithshme me qasjen e vizionimit, por nuk ka ofruar analiza më shumë teknike të asaj që ka funksionuar si duhet dhe çka do të mund të funksiononte më mirë. Tani mund të jetë shumë vonë për një ‘revizion’ (auditim) të jashtëm për këtë gjeneratë të parë të vizionimit nga komuniteti, por kjo duhet të parashihet për xhiron e radhës.

Sidoqoftë, analiza treguese e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve na mundëson që t’i shqyrtojmë disa strategji të mundshme për gjeneratën e radhës të vizionimit nga komuniteti.

SWOT-Analiza për punëtoritë e kaluara të vizionimit	
PËRPARSITË <ul style="list-style-type: none"> - formati i testuar - organizatë profesionale - koordinatorët e trajnuar - dinamika pozitive e grupit - nga zeroja/fillimi - bashkëpunimi mes komuniteteve - të menduarit kreativ / idetë e zgjuara - ndryshimet e qëndrimeve 	DOBËSITË <ul style="list-style-type: none"> - formati shablon - pronësia vendore e kufizuar - trajnimi i trajnerëve i kufizuar - nuk ‘përshkrim të planifikimit’ - nuk ka vizion të integruar - zbatimi i kufizuar - kostot e larta
MUNDËSITË <ul style="list-style-type: none"> - emancipimi i shoqërisë civile - identifikimi i komunitetit të planifikimi - popullata e re - Integrimi evropian - Donatorët ndërkombëtarë dhe ndërtuesit e kapaciteteve - qendrat vendore të trajnimit 	RREZIQET <ul style="list-style-type: none"> - kufizimet buxhetore - tërheqja e komunitetit ndërkombëtar - krizat politike - mungesa e arsimit/ edukimit në planifikimit

Fig. 9

- Strategjia ofensive i kombinon përparësitë dhe mundësitë. Duke i kombinuar tri përparësitë e para me mundësitë për një komunitet që mëson për planifikimin si dhe prania e vazhdueshme e donatorëve ndërkombëtarë dhe ngritësve të kapaciteteve, mund të shqyrtohen dhe përshtaten metoda më të ‘avancuara’ të vizionimit, siç është punëtorja për planifikim (ang. *planning charrette*). Elementet kryesore të punëtorisë së propozuar për planifikim janë shtjelluar në Shtojcën 16, por në thelb ajo nënkupton ngritjen e praktikës aktuale të vizionimit në një nivel teknik pak më të lartë, derisa komuniteti vazhdon të jetë në krye. Punëtorja për planifikim mund të aplikohet në shkallë të një komune apo qyteti të tërë, por më së shumti përdoret për fusha ose tema më të fokusuara të planifikimit. Vizioni i komunitetit dhe plani për veprim për shumë vendbanimeve joformale në Kosovë mund të jetë një sfidë dhe arritje e madhe. Projekt propozimi i dytë ofensiv është krijimi i një OJQ-je për vizionim nga komuniteti, që mund të jetë pjesë e një qendre kombëtare për pjesëmarrje ose angazhim publik, kështu shembujsh ekzistojnë në pjesët tjera të botës. Kjo qendër për vizionim do të mund të jetë godina publike e OJQ-së për vizionim me ambiente dhe fasilitues për punëtorë të vizionimit, qendra për dokumentim dhe biblioteka, ndonjë qendër për ekspozita, ndonjë kafene e komunitetit, etj. Koncepti i qendrës për vizionim apo shtrëpisë për vizionim është shtjelluar më tej në Shtojcën 17.
- **Strategjitë transformuese** synojnë kryesisht përmirësimin ose larmishmërinë e formatit të testuar duke i adresuar disa nga dobësitë e theksuara. Kjo mund të ndërlidhet me punëtoritë për vizionim specifike për një fushë apo grup (siç janë punëtoritë apo sesionet e punëtorëve specifike për aspektin gjinor), krijimi i trajnimeve për fasilituesit (kryesisht vendas) të punëtorëve; prezantimin dhe sqarimin e raportit për planifikim gjatë ose përpara fillimit të punëtorisë për vizionim; organizimin e punëtorisë për vizionim ‘në vend’ të ngjarjes, do të thotë në ose afër zonës për të cilën hartohet plani në fjalë; si dhe zvogëlimin e shpenzimeve të punëtorëve për vizionim duke u mbështetur më shumë në shërbimet e komunitetit (për shembull për shërbimet hoteliere vendase). Duke i kombinuar të gjitha këto masa dhe duke e zvogëluar numrin e ditëve të përfshira, mund të organizohen shumë më shumë punëtorë në vend se ta shfrytëzojmë me përpikëri formatin e njëjtë shabllon. Po ashtu, masat transformuese mund të aplikohen në komponentët e ndryshëm të vizionimit. Për shembull, duke shpenzuar më pak kohë në analizimin e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve mund të kursethet më shumë kohë për strategjitë të cilave u nevojitet më shumë të menduar strategjik dhe do të forcohet dimensionin

strategjik i vizionit. Përveç kësaj, duke e shkurtuar kohën e shpenzuar për projektimin e punëtorëve tematike mund të ketë më shumë kohë në dispozicion për ta zhvilluar një projekt të integruar të vizionit gjatë punëtorëve për vizionim. Masat transformuese mund të aplikohen gjithashtu në aktivitetet pas vizionimit, për shembull duke stimuluar më shumë kontribut publik për propozimet e vizionit nga punëtoritë e vizionimit (p.sh. duke e i përdorur fletët ngjitëse për t’i aprovuar, refuzuar apo thjesht për t’i komentuar propozimet e vizionit). Edhe mekanizmi për hartimin e raportit për vizionim dhe të dokumentit të integruar për vizionim mund të vlerësohet dhe përmirësohet në mënyrë kritike.

Strategjitë e SWOT-it për punëtoritë e ardhshme të vizionimit	
OFANSIVE - visioning charrette - OJQ të vizionimit - qendra e vizionimit	TRANSFORMUESE - ngritja e pronësisë lokale - vizionimi ‘në vend’ - vizionimi me kosto të ulët
DEFANSIVE - mbaje dhe përmirsoje formatin ekzistues - kapitalizoni dhe dhe rishikoni vizionet ekzistuese - mbani ‘partnerët e vizionit’ në rreth	MBIJETUESE - të rrespektohet pjesëmarrja publike dhe konsultimi me qytetarët, e kërkuar sipas ligjit

Fig. 10

- Strategjitë **defensive dhe mbijetuese** duhet të konsiderohen se si ta ruajmë dhe të luftojmë për atë që e kemi nëse asgjë më shumë apo tjetër nuk është e mundur. Po ashtu, strategjia defensive mund të përfshijë një dokumentim dhe vlerësim të duhur të ‘acquis visionaire’ – asaj që është arritur deri më tani – për ç’gjë ky manual është kontributi i parë. Strategjia e mbijetesës vlen për situatat e padëshiruara ku dobësitë dhe rreziqet i lënë në hije përparësitë dhe mundësitë, për shembull nëse tërhiqet bashkësia ndërkombëtare kurse në anën tjetër kapacitetet vendase janë ende të pamjaftueshme dhe mungon ndarja e duhur buxhetore për planifikimin me pjesëmarrje. Në këtë rast, strategjia e mbijetesës është që së paku të ruhen kriteret për pjesëmarrje të parapara me anë të kuadrit ligjor aktual dhe Ligjit për Planifikim Hapësinor në veçanti.

KAPITULLI 7

PERSPEKTIVA

PËR TË ARDHMEN

Derisa vizionet përfshirëse janë shumë të nevojshme për t'i realizuar ëndrrat dhe planet, jo të gjithë i çmojnë ato për shkak se krijojnë pritshmëri që nganjëherë është e vështirë të arrihen.

Në një artikull interesant për 'Planifikimi dhe projektimi (vol. 37, 2010), Louis Albrechts thotë se: "pa një vizion të duhur, përpjekjet për transformim lehtë mund të degjenerojnë në një listë të projekteve konfuzuese, jokonsistente dhe që marrin kohë, të cilët çojnë në drejtime shumë të ndryshme dhe shpesh të mos përputhshme apo që çojnë asgjëkund fare."

Megjithatë, vazhdon ai, "vizionet ose pamjet referente nuk janë thjeshtë 'aty diku', duke pritur të zbulohen. Përkundrazi, ne duhet t'i ndërtojmë ato... Vizionimi është një proces me anë të së cilit individët – ose mundësisht grupet – i zhvillojnë vizionet e gjendjeve të ardhshme për veten e tyre, organizatave të tyre, qytetit të tyre, apo regjionit të tyre të cilat janë mjaft të qarta dhe të fuqishme për t'i nxitur dhe mbështetur veprimet e nevojshme ashtu që (disa pjesë nga) këto vizione të bëhen realitet."

Pasi që vizionimi po ashtu është 'udhëtim' dhe jo thjeshtë destinacion, z. Albrechts thotë se ky proces nuk mund të kufizohet vetëm në një aktor apo institucion të vetëm. Përkundrazi, ai duhet të ofrojë pikëpamje për të ardhmen që mund të ndahen bashkërisht: "... një ndjenjë e qartë e drejtimit, mobilizimi i energjisë, dhe ndjenja e të qenit i angazhuar në diçka të rëndësishme."

Praktika e punëtorive pjesëmarrëse për vizionimin nga komuniteti në Kosovë mund të shihet si një kontribut i rëndësishëm në këtë proces të transformimit, por udhëtimi ende është larg mbarimit – dhe ai nuk duhet të përfundojë kurrë. Ngjashëm me 'Ciklin për vizionim (shih më sipër), ne mund t'i referohemi një Cikli pjesëmarrës (shih *Instrumentet e Metodave Pjesëmarrëse të Universitetit të Kombeve të Bashkuara, manuali i praktikantëve*). Pjesëmarrja në planifikim dhe zbatim duhet të kombinohet me vlerësim pjesëmarrës. Prandaj, veprimi i rëndësishëm pas

KORNIZA 10.

LIDERSHIPI

Gjashtë cilësitë themelore të lidërshiptit urban sot janë::

- *Largpamësia*: mundësia për të imagjinuar dhe vlerësuar se si zhvillohen trendët;
- *Fokusi strategjik*: aftësia e koncentrimit në 'pasqyrën e përgjithshme' dhe perspektivat afatgjate të orientuara në të ardhmen;
- *Kuptimi i urbanizmit dhe dinamikave të qytetit në mënyrë të plotë*: këtu përfshihet të kuptuarit e cilësive dhe karakteristikave që i bëjnë qytetet të mrekullueshme;
- *Krijimi i një kulture të sinqeritetit dhe kuriozitetit*: miratimi i një karakteri që e vlerëson debatin, mendimin kritik dhe të mësuarit;
- *Zhdërvjelltësia organizative*: mundësia për të kaluar prej një kulture të kontrollimit, centralizimit, uniformitetit, fajësimit të lartë, rrezikut të ulët drejt asaj që e vlerëson reagueshmërinë dhe fleksibilitetin;
- *Fokusi i përmbushjes me vendosmëri*: motivimi, vullneti dhe mundësia për ta bërë realitet atë që është premtuar.

Burimi: Charles Landry, *The Creative City* (Qyteti kreativ), pp.32-33

PROCESI PJESËMARRËS I POLITIKAVE




Fig. 11

gjeneratës së parë të vizionimit nga komuniteti në Kosovë duhet të jetë një proces i vlerësimit pjesëmarrës dhe rekomandimeve për vizionimin e ardhshëm, angazhimi qytetar në planifikim dhe qeverisje.

Konferenca *Vizionimi si instrument për planifikimin pjesëmarrës* ishte hapi i parë në vlerësimin pjesëmarrës (Box 8). Prandaj mendësia e re për planifikimin përfshirës kërkon që monitorimi, vlerësimi dhe shqyrtimi i suksesit dhe dështimit duhet të hulumtohet më shumë. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe i ndërthurur është i nevojshëm për të siguruar që kreativiteti të jetë një element i pandarë i proceseve të planifikimit dhe projekteve.

“Vlerësimi e inkurajon të mësuarit reflektiv dhe në vazhdimësi e rigjallëron të menduarit. Ai është kapaciteti për të absorbuar dhe fituar njohuri, për të mësuar nga përvojat e kaluara dhe për të arritur një sensibilizim të plotë dhe aktiv lidhur me atë që është duke ndodhur,” thotë z. Charles Landry në librin e tij, *Qyteti kreativ*. “Për të qenë efektiv dhe efikas, të mësuarit kërkon vlerësim në bazë të menduarit analitik dhe kritik si dhe divergjent, prodhues ose konvergjent.”

Ky publikim është hapi i dytë dhe mësimet e nxjerra duhet të ndahen me publikun, duke i përfshirë edhe pjesëmarrësit e punëtorisë për vizionim, si dhe vendim-marrësit dhe opinion-bërësit përkatës, përfshirë mediat.

Vendim-marrësit, pa dyshim, janë një grup kryesor i synuar dhe palë me interes në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin pjesëmarrës. Fundja, pasuria më e rëndësishme e komunitetit janë cilësitë personale të lidershit të tij. Z. Landry thotë se “nuk ekziston ndonjë formulë e thjeshtë për t’i gjetur dhe maksimizuar pasuritë urbane. Kjo gjë kërkon të kuptuarit e sofistikuar të urbanizmit dhe mënyrës se si funksionojnë qytetet në nivel global. Ajo mbështetet në një të kuptuar më të thellë të asaj se çka mund të jetë një resurs dhe se lëndët e para të mundshme ekzistojnë gjithandej – nga më të dukshmet, siç është një skelë ujore, deri te ato më pak të dukshme, siç është ndryshimi i drejtimit në rastin e mungesës së ambicies në ndonjë qytet. Për t’i shfrytëzuar këto resurse nevojiten qasje të ndryshme, nga iniciativat klasike të rigjenerimit fizik të zonave urbane më të vjetra deri te kuptimi i asaj se të menduarit e mirë në vete mund të krijojë potenciale.”

Ai i dallon gjashtë cilësi kryesore thelbësore për lidershipin urban (shih Katrorin 11) në Kosovë dhe në vendet tjera në botë që gjithashtu janë duke bërë tranzicionin prej konflikteve.

Përveç gjashtë cilësive bazike të Landry-it, dhe duke mësuar nga gjenerata e parë e vizionimit nga komuniteti dhe planifikimi

strategjik, rekomandimet në vijim mund t’i adresohen vendim-marrësve vendas në Kosovë:

- Aplikimi dhe ‘lokalizimi’ i metodave të përgjithshme të planifikimit nga komuniteti.
- Përqafimi i vizionimit nga komuniteti si mundësi për ndryshime për ta arritur një zhvillim të qëndrueshëm.
- Përfitimi prej vizionimit nga komuniteti gjatë tërë procesit të planifikimit, duke përfshirë edhe ciklin e vizionimit;
- Shfrytëzimi i ndihmës teknike potenciale dhe në dispozicion nga bashkësia ndërkombëtare për ta fuqizuar komunitetin e planifikuesve vendas.
- Kontraktimi i jashtëm vetëm për ato gjëra që nuk mund të realizohen si duhet “ne shtëpi” nga vete stafi komunal.
- Ndarja e buxhetit dhe gjetja e mënyrave kreative për ta financuar angazhimin qytetar në planifikim, zbatim dhe vlerësim (cikli i pjesëmarrjes).

Për nivelin qendror të vendim-marrësve mund të formulohen rekomandime tjera specifike programore:

- Rritja e sensibilizimit publik dhe politik për vlerat dhe përfitimet e planifikimit përfshirës nga komuniteti.
- Inkurajimi dhe ndihma për autoritetet lokale, që ta bëjnë planifikimin nga komuniteti të funksionojë.
- Krijimi i ‘treguesit të angazhimit qytetar’ për ta vlerësuar përfshirjen e planifikimit lokal (p.sh. Planet Zhvillimore Komunale).
- Përfitimi prej vizionimit nga komuniteti për planifikimin, projektet dhe vlerësimin strategjik të nivelit qendror (siç është për autostradën re, e cila është planifikuar me dyer të mbyllura).
- Shfrytëzimi i ndihmës teknike potenciale dhe në dispozicion nga bashkësia ndërkombëtare për ta fuqizuar komunitetin e planerëve vendas.
- Investimi në të gjitha nivelet e arsimit të duhur për planifikimin strategjik.
- Ndihma në bashkë-financimin e ‘Shtëpisë së vizionit’ së re në Kosovë (shih Shtojca 16).
- Trajnimi i fasilituesve të vizionimit nga komuniteti në kuadër të Institutit ekzistues për Planifikimin Hapësinor në Kosovë.

Në një shoqëri të shëndoshë, shoqëria civile, komuniteti i biznesit dhe mediat nuk presin dhe thjeshtë nuk i përgjigjen vendim-marrësve të zgjedhur dhe institucioneve të tyre. Punëtoritë për vizionim nga komuniteti kanë treguar se shoqëria civile mund të merr pjesë në formësimin e të ardhmes për komunitetin e tyre, megjithëse në bashkëpunim me institucionet. Nga këndvështrimi i objektivave të angazhimit qytetar do të ishte edhe

më i suksesshëm nëse shoqëria civile, komuniteti i biznesit dhe mediat do të:

- Inicijonë dhe organizojnë punëtoritë për vizionim.
- Angazhohen tërësisht në mundësitë e mirëfillta për pjesëmarrje gjatë procesit formal të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit.
- Ndërmarrin veprime dhe projekte strategjike duke e zbatuar një vizion të përbashkët.
- Raportojnë dhe dokumentojnë vizionimin nga komuniteti, brenda dhe jashtë komunitetit.
- Krijojnë një platformë për dialog dhe shkëmbim të ideve për vizionimin dhe angazhimin qytetar në një shoqëri në tranzicion (si një Kafene Botërore, shih Shtojca 17).

Në fund, bashkësia ndërkombëtare, organizatat për ndihmë teknike dhe donatorët në veçanti, po ashtu, do të mund të bënin

më shumë për ta kultivuar dhe përforcuar planifikimin dhe vizionimin nga komuniteti, kryesisht duke:

- Përkrahur një shoqëri në tranzicion në orientimin e tranzicionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm.
- Kultivuar qasjen në metodat dhe teknikat më të reja për planifikimin strategjik dhe angazhimin qytetar.
- Dokumentuar praktikatat më të mira të vizionimit dhe planifikimit nga komuniteti.
- Ndihmuar në krijimin e një qendre qytetare të menaxhuar dhe plotësuar me staf vendas për pjesëmarrjen publike në Planifikim, zbatim dhe vlerësim.

Tani fjalën e keni ju! Lejoni imagjinatën tuaj të punojë dhe pasurojeni debatin për vizionimin nga komuniteti si një mjet për angazhimin qytetar.

“Shumë prej
ëndrrave
të zbrazëta
duken të pa-
mundshme,
pastaj pa
ndonjë gjasë,
e mandej të
pashmang-
shme”

Christopher Reeve



FJALORTHI

FJALORTHI

Planifikimi përfshirës mund të funksionojë vetëm nëse pjesëmarrësit në procesin e planifikimit janë në gjendje të komunikojnë. Këtu ndonjëherë duhet të bazohemi në shprehje teknike dhe zhargon. Gjatë komunikimit ndërmjet profesionistëve dhe vendim-marrësve, palëve me interes dhe opinionit në përgjithësi, cilësia e komunikimit do jetë më e madhe nëse e përdorim një grup të shprehjeve që përdoren më së shpeshti dhe të njëjtën mënyrë se si i kuptojmë domethëniet e tyre. Duke u mbështetur sa më shumë që është e mundur në përkufizimet ekzistuese dhe të besueshme, atëherë e shmangim konfuzionin e madh. Por, pasi që gjuhët dhe disiplinat janë duke u zhvilluar, edhe përkufizimet mund të zhvillohen. Ky fjalorth i sqaron kryesisht shprehjet e përdorura në këtë publikim. Burimet e ndryshme të shfrytëzuara si elemente të përkufizimeve janë renditur në pjesën 'Referencat dhe burimet'.

PLANIFIKIMI I VEPRIMEVE

Një qasje ndaj planifikimit dhe projektimit urban që përfshin organizimin e ngjarjeve të përbashkëta të strukturuar me kujdes, të cilat sjellin deri te propozimet për veprim. Po ashtu, kjo shprehje përdoret për të nënkuptuar krijimin e një plani të punës.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i orientuar kah rezultatet, me afate kohore dhe pjesëmarrës konkret i negociuar ndërmjet palëve me interes në kuadër të kornizës strategjike të miratuar.

DITAR PUNE

Libër i ngjashëm me kalendarin e tavolinës për të shënuar takimet, gjërat që duhen kryer ose përmbushur.

AGJENDA

Lista, plani, skica ose të ngjashme e gjërave që duhen bërë, çështjet për të cilat duhet vepruar ose votuar.

AGJENDA 21

Plani i veprimit të Kombeve të Bashkuara lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm në nivelin lokal, regjional, kombëtar, ndërkombëtar dhe global.

ANALIZA

Metoda e studimit të natyrës së diçkafit ose e përcaktimit të karakteristikave themelore të saj dhe raporteve të tyre.

ANALIZA HAPËSINORE

Përcaktimi i karakteristikave themelore dhe raporteve të tyre brenda një hapësire të caktuar.

ANALIZA E PALËVE ME INTERES

Mjet për identifikimin dhe përcaktimin e atyre që do të angazhohen dhe përfshihen në Procesin për Planifikimin Strat-

egjik. Kjo analizë i identifikon dhe përkufizon individët, grupet dhe organizatat interesat legjitime të cilëve duhet të përfaqësohen lidhur me çështjet e caktuara.

ZONË

Hapësirë toke e përkufizuar në vija të trasha; pjesë e përcaktuar e hapësirës territoriale.

ZONË URBANE

Hapësirë e përkufizuar në vija të trasha që ndodhet në një vendbanim, grumbullim (aglomerat), qytezë apo qytet. Kjo hapësirë përkufizohet nga organi publik kompetent për zhvillimin urban.

ZONË RURALE

Hapësirë e përkufizuar në vija të trasha që ndodhet në fshat, jashtë zonës urbane por komplementare me të.

KAPACITET

Tipari i të qenit i zoti, mundësia për të bërë diçka.

NGRITJA E KAPACITETEVE

Krijimi dhe aftësive dhe mundësive të njerëzve, grupeve ose organizatave.

QYTET

Qendra e popullatës, tregtisë, kulturës dhe qeverisjes; qytet i një madhësie dhe rëndësie të konsiderueshme për popullatën lokale, regjionale ose ndërkombëtare.

PROFILI I QYTETIT

Informata bazë lidhur me gjendjen ekzistuese në një qytet, për ta lehtësuar mirëkuptimin e përbashkët dhe më të mirë të çështjeve dhe për t'i mbështetur palët e interesuara në caktimin e prioriteteve për këto çështje.

KONSULTIMET PËR QYTETIN

Procesi pjesëmarrës që synon një mirëkuptim të përbashkët të pjesëmarrësve të çështjeve dhe prioriteteve kryesore dhe një marrëveshje për drejtimin e veprimeve që duhen ndërmarrë para hartimit të Planit për Zhvillim Strategjik.

DEKLARATA E QYTETIT

Deklarata e qytetit është dokumenti i lëshuar në fund të një organizimi të konsultimeve për qytetin; ajo e artikulon konsensusin e pjesëmarrësve lidhur me çështjet prioritare, qasjet themelore, hapat dhe veprimtaritë e ardhshme, si dhe zotimin publik për ta vazhduar mbështetjen e procesit (shih po ashtu Pakti Urban).

SHOQËRIA CIVILE

Shoqëria civile përbëhet nga tërësia e organizatave dhe institucioneve vullnetare, qytetare dhe shoqërore që e formojnë bazën e një shoqërie funksionale.

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Grupe të organizuara dhe të formuara të cilat nuk janë agjenci apo departamente të qeverisë apo të sektorit privat fitim-

prurës komercial dhe industrial. Kjo është shprehje e gjerë që përfshin organizatat joqeveritare dhe organizatat me bazë në komunitet.

KOMUNIKIMET

Shkëmbimi i mendimeve, porosive ose informatave, p.sh, me anë të folurit, shenjave, shkrimit ose sjelljes.

POLITIKA E KOMUNIKIMIT

Një drejtim definitiv i veprimeve i miratuar për hir të dhënies ose këmbimit të mendimeve, opinionëve ose informatave me anë të folurit, shkrimit ose shenjave.

BUXHETI PËR KOMUNIKIM

Plani i veprimtarive i bazuar në vlerësimin, shpesh të zbrërthyer, të hyrave të parapara për hir të komunikimit.

AFTËSITË E KOMUNIKIMIT

Komunikimi është proces i dhënies dhe marrjes së informatave, ndërsa teknikat dhe metodat e vlefshme e bërjes së kësaj mund të mësohen dhe të praktikohen me efektshmëri të lartë. Dallimi ndërmjet komunikimit të mirë dhe të keq mund të ndikojë së tepërmi në suksesin e planeve dhe projekteve.

KOMUNITETI

Zakonisht i referohet atyre që jetojnë brenda një zone gjeografike të vogël të përkufizuar në mënyrë të përgjithshme. Gjithashtu, çdo grup i individëve që kanë të njëjtin interes mund të përshkruhet po ashtu si komunitet. Nganjëherë përdoret për ta përshkruar një hapësirë fizike e jo një grup njerëzish. Këta janë një grup i banorëve lokalë që e identifikojnë veten në një apo mënyrë tjetër dhe që i lidhin gjërat e përbashkëta – vlerat, resurset dhe nevojat, si dhe hapësira.

KOMUNITETI I BIZNESIT

Grupi i individëve që menaxhojnë biznese.

ORGANIZATA ME BAZË NË KOMUNITET

Organizatë që vepron në nivel lokal për ta përfaqësuar një komunitet lokal apo grup të interesit. Ajo dallon nga organizatat joqeveritare në atë se shqetësimet kryesore të tyre nuk janë të lidhura me ndonjë shkak të caktuar dhe zona vepruese e tyre është e përkufizuar gjeografikisht.

PLANIFIKIMI NGA KOMUNITETI

Planifikimi i kryer me pjesëmarrjen aktive të shfrytëzuesve të fundit.

PËRFSHIRJA E KOMUNITETIT

Angazhimi i komunitetit si pjesëmarrës.

VIZIONIMI NGA KOMUNITETI

Mendimi lidhur me atë se si mund të jetë e ardhmja. Shprehje që përdoret për t'i përshkruar proceset e punës në grupe të cilat i ndihmojnë një komuniteti për t'i krijuar vizionet imagjinative të përbashkëta për të ardhmen e një lokacioni, zone ose organizate. Qasje shpesh herë e miratuar nga autoritetet lokale si pjesë e proceseve të tyre nga Agjenda 21.

KONCEPTI

Ideja e përgjithshme e nxjerrë apo e konkluduar nga ngjarjet apo ndodhitë e caktuara.

KONCEPTI HAPËSINOR

Ideja e përgjithshme e nxjerrë apo e konkluduar nga ngjarjet apo ndodhitë e caktuara mbi temën e hapësirës.

KONSENSUSI

Marrëveshje e arritur me anë të një procesi të mbledhjes së informatave dhe pikëpamjeve nëpërmjet diskutimit, që është i pranueshëm për të gjitha palët me interes.

KONSULENT

Ai që jep këshilla profesionale apo si ekspert ose ai që e konsulton tjetrin.

KONSULENCË

Akti apo rasti i konsultimit. Po ashtu, ndonjë biznes ose agjenci që ofron këshilla profesionale apo të ekspertëve në një fushë të caktuar.

RAPORT I KONSULENTIT

Një shqyrtim apo abstrakt i një dokumenti më të madh apo disa dokumente të konsulentit. Po ashtu, mund të jenë Termat e referencës për ndonjë tenderi për konsulencë.

KONSULTIM

Kërkimi i pikëpamjeve nga të tjerët (por jo patjetër përfshirja e tyre në vendim-marrje).

KONSULTIME PUBLIKE

Akti ose procesi i konsultimit me opinionin.

KULTURË

Tërësia e tipareve të sjelljes, arteve, besimeve, institucioneve dhe të gjitha produkteve tjera të punës dhe mendjes njerëzore që transmetohen në mënyrë shoqërore.

TRASHËGIMI KULTURORE

Diçka që kalohet nga gjeneratat parapra ke pasueset; traditë që i pasqyron tiparet e sjelljes, arteve, besimeve, institucioneve dhe të gjitha produkteve tjera të punës dhe mendjes njerëzore.

DECENTRALIZIM

Procesi i bartjes së përgjegjësisë nga agjencitë dhe institucionet qendrore te nivelet më të ulëta të menaxhimit dhe administratës.

PROJEKT DEMONSTRUES

Projekt realtivisht i mëvetshëm, investim kapital i shkallës së vogël ose ndihmë teknike, i cili zbatohet për ta "demonstruar" në praktikë se si mund të adresohet ndonjë lloj i caktuar i problemit në mënyrë pjesëmarrëse.

DIZAJN

Konceptimi apo modelimi në mendje; shpikja, për ta formuluar një plan; sajimi.

UDHËZIME PËR DIZAJNIN

Sajimi i një rregulli apo grumbulli rregullash që japin udhëzime për mënyrën se si të merremi me një projekt apo skicë të një hapësire apo zone të caktuar.

STANDARDET E DIZAJNIMIT

Sajimi i një grumbulli të moralit, etikës ose shprehive të krijuara nga autoriteti, zakoneve ose ndonjë rast individual i pranuar si standard, model ose shabllon i konsideruar si tipik.

PROJEKTIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE

Është projektimi i një hapësire ku ka të drejtë të jetë secili pa u përjashtuar për shkak të kushteve ekonomike ose sociale.

DIZAJNI URBAN

Projekti urban është procesi i formësimit të mjedisit fizik për jetesë në qytete, qyteza dhe fshatra. Ai është arti i bërjes së vendeve. Aty përfshihen projektet e ndërtesave, grupeve të ndërtesave, hapësirave dhe peizazheve, si dhe krijimi i procesit që e bën të mundur zhvillimin e suksesshëm.

PROJEKT PLANI

Plani i cili e parashtron formën preliminare të planit përfundimtar.

EFEKTIVITETI

Shkalla në të cilën janë arritur ose pritët të arrihen objektivat e intervenimeve zhvillimore duke marrë parasysh rëndësinë relative të tyre.

EFIKASITETI

Shkathhtësia e shmangies së shpenzimit kot të kohës dhe mundit. Masë për matjen se sa janë shndërruar në mënyrë ekonomike resurset/inputet (fondet, ekspertiza, koha, etj) në rezultate.

FUQIZIM

Krijimi i besimit dhe aftësive tek individët ose komunitetet që çojnë drejt mundësisë për të marrë më shumë kontroll lidhur me fatet e tyre.

FUQIZOJ

Dhënia e autoritetit një institucioni ose organizate (apo individ) për t'i caktuar politikat dhe për t'i marrë vendimet. Kjo ka të bëjë me përfshirjen dhe sjelljen brenda të njerëzve që janë jashtë procesit të vendim-marrjes.

VIZIONIMI

Shiko Vizionimin

BARAZIA

Gjendja ku jeni i barabartë. Paanësia mund ta përfshijë ose jo barazinë

PAANËSIA

Cilësia e të qenit të paanshëm dhe të "drejtë" në shpërndarjen e përfitimeve dhe shpenzimeve të zhvillimit, si dhe sigurimi i qasjes në mundësi për të gjithë

VLERËSIM

Vlerësimi sistematik dhe objektiv i një projekti, programi ose politike në vijim e sipër apo të përfunduar, ose të projektit, zbatimit dhe rezultateve të tij.

FASILITIM/ LEHTËSUES

Akti i bërjes më të lehtë të diçkaje.

FASILITUES/LEHTËSUES

Personi përgjegjës për drejtimin ose bashkërendimin e punës së një grupi, sikur ai që e drejton diskutimin në grup.

FORMAL

I ekzekutuar, kryer ose bërë në formën e duhur ose të rregullt, i karakterizuar me respektim strikte dhe të përpiktë ndaj formave. Kund. **Joformal** Pa formalitet ose ceremoni, rëndomtë.

GJINI

Gjendja shoqërore, kulturore dhe biologjike e të qenit mashkull ose femër.

BALANCË GJINORE

Aranzhim harmonik ose i kënaqshëm ose proporcion i femrave dhe meshkujve.

BARAZI GJINORE

Koncepti që të gjitha qeniet njerëzore, meshkuj dhe femra janë të lirë që t'i zhvillojnë kapacitetet personale të tyre dhe të marrin vendime pa kufizime të përcaktuara nga stereotipet, rolet gjinore të ngurta dhe paragjykimet.

PAANËSI GJINORE

Trajtimi i drejtë i femrave dhe meshkujve, sipas nevojave përkatëse të tyre.

PLANIFIKIM GJINOR

I referohet proceseve të planifikimit që kanë ndjeshmëri gjinore dhe marrin parasysh ndikimin e roleve të ndryshme gjinore, marrëdhënieve gjinore dhe nevojave gjinore të meshkujve dhe femrave.

NDJESHMËRI (A) GJINORE

(Të qenit) I prekshëm karshi qëndrimeve, ndjenjave ose rrethave të meshkujve dhe femrave.

QEVERISJE

Procesi i marrjes së vendimeve dhe monitorimit të zbatimit të tyre. Qeverisja e mirë kërkon njohjen, respektimin dhe angazhimin e të gjitha aktorëve potencial dhe palëve me interes të cilët do të preken nga vendimet që merren.

QEVERISJE URBANE

Akti, procesi ose pushteti i qeverisjes ose përcaktimit të një qyteti ose qyteze, apo që ka të bëjë me të.

QEVERISJA

Akti ose procesi i qeverisjes, veçanërisht kontrolli dhe administrimi i politikave publike në një njësi politike (qeveri).

AGJENDA HABITATIT

Në 'Samitin për Vendbanimet Njerëzore' të Kombeve të Bashkuara në 1996 është miratuar Agjenda për Vendbanimet, një Plan Global i Punës që përqendrohet në mënyrat dhe mjetet për të siguruar strehim adekuat për të gjithë duke i menaxhuar vendbanimet njerëzore të qëndrueshme në një botë gjithnjë e më shumë të urbanizuar.

BANIM

Ndërtesa ose strehë tjera ku jetojnë njerëzit.

BANIM I ARSYESHËM (JO I SHTRENJTE)

Pasuritë banesore ku përfshihen ndërtesat dhe llojet tjera të strehëve në të cilat jetojnë njerëzit e që besohet se janë brenda mundësive financiare të grupeve të caktuara shoqërore.

BANIM SOCIAL

Banimi social është shprehje e përgjithshme që i referohet banesave me qira të cilat mund të jenë në pronësi dhe të menaxhuara nga shteti, organizatat jofitimprurës, apo nga kombinimi i këtyre të dyjave, zakonisht me qëllim të ofrimit të banesave të arritshme.

ZHVILLIMI I RESURSEVE NJERËZORE

Procesi i pajisjes së njerëzve me të kuptuarit dhe aftësitë, si dhe qasjes në informata dhe njohuri për të punuar në mënyrë efektive.

ILEGAL/KUNDËRLIGJSHËM

I ndaluar me ligj apo rregulla-ore zyrtare.

VENDBANIM ILEGAL

Komuniteti ku njerëzit jetojnë në një hapësirë ose zonë e cila është e ndaluar me ligj, e ndaluar me rregullore zyrtare.

JOFORMAL

Nuk është formal ose ceremonial, rëndomtë.

VENDBANIMET JOFORMALE

Vendbanimet njerëzore të cilat nuk i plotësojnë kriteret për njohje ligjore dhe që janë ndërtuar pa i respektuar procedurat formale të pronësisë ligjore, si dhe rregulloret ndërtimore dhe të planifikimit urban; kryesisht karakterizohen me posedim të pasigurt ose joformal të tokës, qasje joadekuate në shërbimet bazike, qofshin ato sociale apo të infrastrukturës fizike dhe financave për banim.

VLERËSIMI I NDIKIMIT

Vlerësimi i efektit ose përshtypjes së një gjëje në tjetrën.

ZBATIM

Procesi i arritjes së një qëllimi; instrument ose agjent. Për ta vënë në punë praktike; kryej.

PËRFSHIRËS

Merr parasysh një pjesë të madhe ose secilin brenda një komuniteti; gjithëpërfshirës.

QYTET PËRFSHIRËS

Vendi ku secili, pa marrë parasysh pasurinë, moshën, racën, gjininë, etj, mund të merr pjesë në mënyrë produktive në mundësitë që i ofrojnë ato qytete.

PLANIFIKIMI PËRFSHIRËS

Planifikimi që përfshin të gjitha palët e interesuara në kuadër të fushëveprimit të tij.

I/E INTEGRUAR

Formim i tërësisë duke i bashkuar të gjitha pjesët.

PLANIFIKIMI I INTEGRUAR

Korniza për sistemin e planifikimit dhe të vlerësimit të zhvillimit.

INTERVENIMI

Akti ose fakti i ndërftjes së një gjëje ndërmjet tjerave.

INTERVENIMI HAPËSINOR

Akti ose fakti i ndërftjes së një gjëje ndërmjet tjerave që ndodh në hapësirë.

INVESTIM

Investimi i parave ose kapitalit për të përfituar fitime në formë të kamatave, hyrave ose rritjes së vlerave.

INVESTIM KAPITAL

Paratë e paguara për të blerë një pasuri kapitale ose pasuri fikse.

PROJEKT PËR INVESTIM KAPITALE

Ndarja e fondeve për të iniciuar, zhvilluar dhe zbatuar një projekt

MENAXHIMI I TOKËS

Procesi i menaxhimit të shfrytëzimit dhe zhvillimit (në zonat urbane dhe rurale) të resurseve tokësore në mënyrë të qëndrueshme.

SHFRYTËZIMI I TOKËS

Përdorimi për ndonjë qëllim; vënia në punë; shfrytëzimi i tokës.

PLANIFIKIMI I SHFRYTËZIMIT (PËRDORIMIT) TË TOKËS

Shprehje e përdorur për një degë të politikave publike që përfshin disiplinën të ndryshme të cilat synojnë rregullimin e shfrytëzimit të tokës në mënyrë efikase dhe etike.

LIDERSHIP/UDHËHEQJE

Aftësia e një personi (udhëheqësi) që ta krijojë një vizion për mundësitë e ardhme dhe këtë vizion ta paraqesë në atë mënyrë që të tjerët mund ta kuptojnë dhe të ndërlidhen me të. Marrja e përgjegjësisë dhe frymëzimi i besimit është gjithashtu i rëndësishëm për lideshipin.

MJETET E JETESËS

Të gjitha pasuritë dhe burimet mbi të cilat mund t'i përdorin ekonomitë familjare për ta mbështetur ekzistimin dhe zhvillimin e tyre.

MENAXHIMI

Menaxhimi përbëhet nga planifikimi, organizimi, resurset, udhëheqja ose drejtimi dhe kontrollimi i një organizate (grupi prej një apo më shumë njerëzve ose subjekteve) ose angazhimi me qëllim të arritjes së një synimi.

NDËRMJETËSIMI

Synon t'u ndihmojë palëve në kontest që ta arrijnë një marrëveshje. Ai është mjet për zgjidhjen e kontesteve. Ai shpesh shihet si një alternativë kundrejt shfrytëzimit të proceseve shpesh herë të gjata dhe të kushtueshme gjyqësore për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet. Gjatë ndërmjetësimit, një person ose agjenci neutrale i ndihmon palët e ndryshme për ta arritur një marrëveshje të negociuar.

OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË MIJËVJEÇARIT

Rezultati kryesor i Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarin të miratuar nga 147 krerë shtetesh dhe organizatash në vitin 2000, me 8 objektiva që duhen përbushur deri në vitin 2015. Më i rëndësishmi për planifikimin është Objektiv 7 për ta siguruar Qëndrueshmërinë Mjedisore, duke përfshirë caqet e caktuara për integrimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe prapësimin e humbjes së resurseve mjedisore; për ta zvogëluar humbjen e biodiversitetit; për ta përgjysmuar proporcionin e popullatës pa qasje të qëndrueshme në ujë të sigurt të pijes dhe higjienë bazike; dhe të arrihet përmirësim i konsiderueshëm në përmirësimin e jetës të së paku 100 milion banuesve nëpër lagje të varfra.

ZBUTJE/ZVOGËLIM

Zbutja, reduktimi, pakësimi ose zvogëlimi i forcës ode intensitetit; ka të bëjë me marrjen e masave që synojnë zvogëlimin e shkallës së ndonjë veprimi.

MOBILITETI/LËVIZSHMËRIA

Lëvizja e njerëzve prej një vendi në tjetrin.

PLANIFIKIMI I MOBILITETIT

Planifikimi dhe menaxhimi i lëvizjes së njerëzve prej një vendi në tjetrin.

MOBILITETI I QËNDRUESHËM

Sistemi i transportit që i ofron qasje optimale në mundësi të gjithë banorëve ose qytetarëve duke e shfrytëzuar minimumin e resurseve.

MONITORIMI

Një funksion i vazhdueshëm për t'i ofruar menaxhimit dhe palëve me interes treguesit për nivelin e progresit, arritjen e objektivave dhe progresin në shfrytëzimin e fondeve të ndara për zhvillimin në vijim e sipër.

MONITORI I PROGRESIT

Libri ose ditari ku në mënyrë sistematike shënohet dhe përcillet progresi drejt arritjes së qëllimit.

KOMUNA

Njësia administrative që i inkorporon zonat urbane dhe/ose rurale që kanë status të përbashkët dhe zakonisht e kanë qeverinë e vet lokale.

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL

Plani zhvillimor hapësinor për tërë komunën.

PLANI ZHVILLIMOR URBAN

Plani zhvillimor hapësinor për një zonë urbane.

LAGJE

Zona ose rajoni rreth ose afër ndonjë vendi ose gjëje; qark ose lokalitet; numri i personave që jetojnë afër njëri tjetrit ose në ndonjë lokalitet të caktuar.

NEGOCIATA

Procesi i arritjes së konsensusit duke shkëmbyer informata, me marrëveshje dhe kompromis.

RRJET

Sistemi i ndërlidhjeve mes njerëzve, shërbimeve ose objekteve p.sh. ndërtesat, zyrat, stacionet, etj., veçmas në një zonë të gjerë ose në tërë vendin, territorin, rajonin, etj.

RRJETI PËR TË MËSUAR

Rrjeti i kultivuar ashtu që njohuritë të fitohen me anë të studimeve sistematike në cilëndo fushë të me aplikim shkencor.

ORGANIZATË JOQEVERITARE (OJQ)

Shprehje e përdorur për një numër të madh të organizatave të cilat nuk janë themeluar as operuar nga qeveria. Zakonisht, një OJQ merret me një fushë të caktuar të veprimtarisë.

ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE (OJF)

Organizata të formuara ligjërisht, objektivi kryesor i të cilave është mbështetja ose angazhimi aktiv në aktivitete të interesit publik ose privat pa qëllime të përfitimit komercial apo monetar.

OBJEKTIV

Diçka që mëtohet të arrihet apo përbushet me anë të veprimeve ose angazhimeve të dikujt; qëllim; synim; cak.

PAKT

Marrëveshje formale, ujd.

PAKT URBAN

Marrëveshje formale, ujd lidhur me zhvillimin urban, i përcaktuar në kuadër të vizionit afatgjatë.

PJESËMARRJE

Përfshirja e njerëzve në planifikimin dhe menaxhimin e programeve dhe projekteve zhvillimore.

PLANIFIKIMI PJESËMARRËS

Planifikimi urban ose hapësinor me pjesëmarrjen e të gjitha palëve përkatëse me interes.

PARTNERITET

Nënkupton përgjegjësi të përbashkëta, rreziqe të përbashkëta dhe përfitime të përbashkëta – partnerët kanë status të barabartë, edhe pse ata mund të kenë role dhe interesa të ndryshme.

I BARABARTË/KOLEGË/(ANG. PEER)

Personi i cili është i barabartë me tjetrin në aftësi, kualifikime, moshë, përgatitje dhe status social.

VEND

Një pjesë e caktuar e hapësirës, e madhësisë së caktuar ose pacaktuar.

KRIJIMI I VENDEVE

Shprehje që e përshkruan procesin e krijimit të shesheve, parqeve, rrugëve dhe brigjeve të lumenjve. Shpesh përdoret në lidhje me ato karakteristika që një vend e bëjnë të veçantë ose të posaçëm, si dhe ato që krijojnë ndjenjën e lidhjes dhe përkatësisë njerëzore autentike.

PLANIFIKIM

Skema, programi, ose metoda e përgatitur paraprakisht për arrijtjen e një objekti.

CIKLI I PLANIFIKIMIT

Planifikimi kërkon proces që i prioritetizon idetë, e vlerëson rëndësinë e tyre dhe i dokumenton hapat e punës që duhet bërë.

EKSPERT PËR PLANIFIKIM

Personi i cili ka aftësi ose njohuri të specializuara në fushën e planifikimit.

EKIPI PLANERËVE

Grup i profesionistëve të angazhuar për ta administruar një subjekt të përbërë nga territore dhe popullata e tyre të përkuqizuara qartë.

LEJE

Dokumentacioni i nevojshëm për të lejuar diçka.

LEJE NDËRTIMI

Dokumentacioni i nevojshëm për ta ndërtuar një ndërtesë

PRAKTIKË/A

Metodë e të mësuarit, zakonisht me anë të përsëritjes për të përmirësuar; shprehje teorike për veprimet njerëzore në shoqëri; metodë e standardizuar konvencionale, tradicionale apo tjetër; zyrë ose firmë p.sh. e arkitektëve ose avokatëve.

PRAKTIKOJ

Akti i ushtrimit të një veprimi disa herë, ose angazhimi në një aktivitet disa herë, me qëllim të përmirësimit të tij.

PROCES

Rend i ndodhjes së natyrshme apo të projektuar të ndryshimeve dhe/ose procedurave në karakteristikat apo atributet e një sistemi, si në planifikim, i cili e konverton atë prej njëres gjendje në tjetrën.

PUBLIK

Që i takon qytetarëve; që ka të bëjë me ndonjë komb, shtet apo komunitet, apo që i prekë ata; e kundërta e privatit (hapësira/interesi privat), siç është pasuria publike, ndonjë rrugë apo liqe. Fjala publike gjithashtu nënkupton qytetarët e ndonjë shteti që nuk janë të lidhur me qeverinë e atij shteti.

PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT

Shërbim qeveritar apo sipërmarrje e biznesit privat e financuar dhe e operuar përmes partneritetit të qeverisë dhe një apo më shumë kompanive nga sektori privat.

SHËRBIM PUBLIK

Term që zakonisht përdoret për të nënkuptuar shërbimet që qeveria ua ofron qytetarëve të vet.

TRANSPORTI PUBLIK

Shërbimet e transportit të licencuara nga qeveria për qytetarët e vet.

SHËRBIMET KOMUNALE PUBLIKE

Shërbimet që iu ofrohen banorëve të një zone të caktuar për nevojat e tyre, si uji, sistemi i kanalizimit, transporti, komunikimi, energjia elektrike, etj.

CILËSIA

Karakteristikë, pronë apo atribut esencial apo dallues.

CILËSIA HAPËSINORE

Karakteristikë, pronë apo atribut esencial apo dallues që ka të bëjë me, që përfshinë, apo që është i një natyre të hapësirës apo të ambientit të jetesës.

RIGJENERIMI

Kthimi i rënies së zonave urbane apo rurale i cili shkaktohet nga procesi i amortizimit natyror, mungesa e investimeve private dhe publike, dhe/apo nga neglizhenca.

RREGULLIMI

Akti i njëtrajtshmërisë; rregullimit.

PLANI RREGULLUES

Parimet dhe rregulloret mbi planifikimin hapësinor të theme-luar në komunitet nga ndonjë autoritet të cilat duhet të zbatohen nga pjesëtarët e atij komuniteti. Ky është një plan i projektuar për të siguruar që ndonjë organizatë e caktuar i respekton të gjitha rregulloret dhe ligjet që i takojnë organizimit të tyre.

BURIMET/RESURSET

Burim i furnizimit, mbështetjes apo ndihmës, posaçërisht një burim që shfrytëzohet kur nevojitet.

BURIM NATYROR

Pasuri natyrore që konsiderohen të vlefshme në formën e tyre relativisht të pamodifikuar (natyrore) si dhe ato që marrin vlerë përmes përpunimit, p.sh. lëndët e para

BURIM KULTUROR

Burimet kulturore të ndonjë vendi, siç është arti dhe trashëgimia, arkeologjia, letërsia, muzika

SHQYRTIMI

Vlerësim i performancës së ndonjë intervenimi të kryer në intervale kohore të rregullta dhe të aty për atyshme

RURALE

Që i takon apo që ka karakteristika të fshatit, jetës së fshatit, apo të personave nga fshati; e kundërta e fjalës urbane: vende jashtë qytezave, qyteteve apo aglomerate të konsiderueshme; rustike, pastorale, bukolike.

SEKTOR

Pjesë e dalluar, posaçërisht e shoqërisë apo e ekonomisë së shtetit: sektori i banimit; sektori arsimor; pjesë apo zonë, si për shembull e ndonjë qyteti.

PLANIFIKIMI SEKTORIAL

Skemë, program apo metodë e paracaktuar për përmbushjen e ndonjë objektiv brenda një pjese apo zone, si për shembull e ndonjë qyteti.

VENDBANIM

Akti apo gjendja e vendbanimit apo gjendja e të qenit të vendosur, akti i stabilizimit apo i instalimit të përhershëm; grupe të shtëpive/ndërtesave; komunitet.

HAPËSINOR

Që i përket hapësirës, që ka të bëjë me hapësirën, që e përfshinë hapësirën, apo që ka natyrën e saj.

RREGULL HAPËSINOR

Strukturë e hapësirës sipas një plani apo rregulli të përcaktuara paraprakisht.

KORNIZA HAPËSINORE

Strukturë skeletore e projektuar për të mbështetur hapësirën, apo që rrethon diçka që ka të bëjë me hapësirën, që e përfshinë hapësirën apo që e ka natyrën e hapësirës.

PLANIFIKIM HAPËSINOR

Planifikimi i hapësirës fizike, i shtrirjes dhe i shfrytëzimit të tokës në planifikimin urban ose të të qytetit. Kërkon themelimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet niveleve hapësinore me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik por edhe të kohezionit territorial dhe zhvillimit ekonomik.

PALË E INTERESIT

Personi ose organizata e cila ka interes në një çështje ose fushë të caktuar. Ata mund të ndikohen prej rezultateve ose mund të kenë një rol, meqë rast atyre shpesh u referohemi si 'aktorë'.

ANALIZA E PALËVE TË INTERESIT

Arritja dhe të kuptuarit rreth asaj se kush është ndikohet nga ndonjë propozim dhe kush duhet të jetë i përfshirë në çfarëdo procesi të pjesëmarrjes.

PROFILI I PALËS ME INTERES

Një analizë që paraqet masën deri kur një person ose organizatë shfaq karakteristika të ndryshme.

PËRFSHIRJA E PALËS SË INTERESIT

Përfshirja e palës së interesit si një rrethanë e domosdoshme ose pasojë.

STRATEGJIA

Një plan, metodë, ose një numër manovrimesh për arritjen e një synimi specifik ose të rezultatit.

STRATEGJIK

Me rëndësi ose esencial për strategjinë.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Përpjekje e organizuar për marrjen e vendimeve dhe veprimeve të cilat e formësojnë dhe udhëheqin komunitetin, punën dhe arsyet e punës që kryen.

PROJEKTI STRATEGJIK

Projektet të cilat janë të një rëndësie kritike dhe që organizatës i mundësojnë që të arrijë suksesin.

DEKLARATA

Një komunikim ose deklaratë verbale ose me shkrim, duke paraqitur faktet dhe veçantitë.

DEKLARATA E MISIONIT

Është një deklaratë e shkurtë për qëllimin, synimet dhe ambiciet e organizatës.

DEKLARATA E VIZIONIT

Përvijon se çfarë dëshiron të bëhet komuniteti. Është e koncentruar në të ardhmen; është burimi i frymëzimit; siguron kritere për vendimmarrje të qartë.

STRUKTURA

Mënyra e ndërtimit, konstruktimi, ose organizimi; renditja e pjesëve, elementeve ose përbërësve.

STRUKTURA HAPËSINORE

Mënyra e ndërtimit, konstruktimi, ose organizimi; që përbëjnë një hapësirë të caktuar.

STRUKTURA HAPËSINORE EKZISTUESE

Mënyra e ndërtimit, konstruktimi, ose organizimi; që përbëjnë një hapësirë të caktuar e cila ekziston.

STRUKTURA HAPËSINORE E DËSHIRUAR

Mënyra e përzgjedhur e ndërtimit, konstruktimi, ose organizimi; që përbëjnë një hapësirë të caktuar e cila ekziston.

SUBSIDIARITETI

Një parim me të cilin deklarohet se me çështjet duhet të merret autoriteti përkatës më kompetent, nëse është e mundur në 'niveli të ulët më efektiv' të vendimmarrjes.

HULUMTIMI

Për të marrë një mendim ose vlerësim të përgjithshëm ose gjithëpërfshirës, një gjendje ose fushë e studimit.

QËNDRUESHMËRIA

Aftësia e sistemeve dhe e proceseve për të ruajtur, mbështetur ose qëndruar; sajimi dhe lejimi i evolimit të këtyre sistemeve; një numër konceptesh komplekse të cilat janë të lidhura me nevojat dhe kufizimet, tani dhe në të ardhmen, brenda një numri të fushave (të përcaktuara në 'Zhvillimin e qëndrueshëm').

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Zhvillimi i cili mbështetë aftësinë e gjeneratave të ardhshme për të përmbushur nevojat e tyre shoqërore, ekonomike, dhe mjedisore dhe njëkohësisht duke plotësuar nevojat e gjeneratave aktuale. Janë pesë aspekte të qëndrueshmërisë të cilat prekin dhe janë të lidhura me zhvillimin e vendbanimeve, qyteteve dhe qyteteve.

QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE

Ka të bëj me kapacitetin e vënies në funksion të të resurseve lokale/rajonale për qëllime produktive dhe për një përfitim afatgjatë të komunitetit duke mos dëmtuar ose varfëruar bazën e burimeve natyrore nga e cila është e varur dhe duke mos rritur ndikimin e qytetit në ekologji.

QËNDRUESHMËRIA SOCIALE

Ka të bëj me drejtësinë, përfshirjen dhe përshtatshmërisë kulturore të një intervenimi për promovim të të drejtave të barabarta për kapitalin natyror, fizik dhe ekonomik, i cili mbështetë gjallërinë e komuniteteve, me theks të veçantë për të varfrit dhe grupet e marginalizuara.

QËNDRUESHMËRIA EKOLOGJIKE

Ka të bëj me ndikimin e prodhimit urban dhe shpenzimin e integritetit dhe shëndetit të qytetit-rajonit dhe kapacitetin e mbartjes globale.

QËNDRUESHMËRIA FIZIKE

Ka të bëj me kapacitetet e një intervenimi për të avancuar jetëgjatësinë e ndërtesave dhe të infrastrukturës urbane për të gjithë banorët e qytetit, duke mos dëmtuar ose penguar mjedisin urban të rajonit.

QËNDRUESHMËRIA POLITIKE

Merret me cilësinë e sistemeve të qeverisjes duke udhëhequr marrëdhëniet dhe veprimet e aktorëve të ndryshëm brenda katër dimensioneve të mëparshme.

SWOT

Shkurtesë për përcaktimin e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve të lidhura me një organizatë ose aktivitet.

SWOT ANALIZA

Një vegël e planifikimit strategjik që përdoret për të vlerësuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e përfshira në një projekt ose ndërmarrësi afariste.

SWOT STRATEGJIA

Ndërton strategji të bazuara në SWOT analizë.

ASISTENCA TEKNIKE

Asistenca teknike mbështetë zhvillimin e burimeve produktive të një organizate ose vendi përmes ndihmës për të menaxhuar në mënyrë efektive politikat e tyre ekonomike dhe çështjet financiare.

PËRSHKRIMI I DETYRAVE (TERMAT E REFERENCËS)

Një dokument i cili paraqet qëllimin dhe fushëveprimin e vlerësimit, metodat në përdorim, standardet kundrejt të cilave duhet të vlerësohet performanca ose duhet të kryhen analizat, burimet dhe koha e ndarë, dhe kërkesat për raportim.

POSEDIMI

Veprimi, fakti, ose kushti i mbajtjes së diçkaje në posedim si tokë, pasuri e paluajtshme ose një zyrë.

SIGURIA E POSEDIMIT

Term i cili përshkruan garancinë ligjore se prona e paluajtshme ose mbajtësi i pozitës nuk mund të largohet përveç në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme.

KOHEZIONI TERRITORIAL

Një koncept i avancimit të kapacitetit të të gjitha rajoneve për shfrytëzimin sa më të mirë të pasurive të territorit të vet në mënyrë të qëndrueshme përmes politikave të përshtatshme publike, strategjive të investimit, kornizave hapësinore dhe atyre të qeverisjes.

TOKENIZMI

Politika ose praktika e përfshirjes së kufizuar ose përfaqësimi politik i anëtarëve të një grupi pakicë, zakonisht përmes krijimit të paraqitjeve false të praktikave të përfshirjes në vend të diskriminimit, të qëllimshëm ose jo.

AVANCIMI

Një proces i përmirësimit progresiv të mjedisit fizik, social dhe ekonomik të vendbanimit. Ai përfshinë adaptimin e shtrirjes ekzistuese për inkuorporimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të avancuara dhe që nuk përfshinë një rihvillim shumë të rëndësishëm.

URBAN

I, apo që ka të bëj me përcaktimin e një qyteti, qyteze ose një aglomeracioni të rëndësishëm.

ZHVILLIMI URBAN

Akti ose procesi i zhvillimit; rritjes; progresit lidhur me, ose përcaktimin e një entiteti urban.

MENAXHIMI URBAN

Akti ose mënyra e menaxhimit; trajtimi, drejtimi, ose kontrolli lidhur me, ose përcaktimin e një entiteti urban.

PLANIFIKIMI URBAN

Një akt i formulimit të programit për një drejtim të përcaktuar të veprimit, lidhur me përcaktimin e një entiteti urban.

URBANIZIM

Procesi social ku lokacionet urbane rriten dhe shoqëritë bëhen më urbane për nga karakteristikat.

URBANIZIMI I PAKONTROLLUAR

Procesi shoqëror ku qytetet rriten dhe shoqëritë bëhen më urbane duke mos qenë nën kontroll.

TASK FORCA

Një grup i përkohshëm individësh dhe burimesh të angazhuar për përmbushjen e objektivës specifike.

VIZIONI

Akti ose fuqia e pritjes se çfarë do të ndodhë ose mund të ndodhë. Një vizion është imazhi i përgjithshëm i asaj se çfarë dëshiron të bëhet komuniteti dhe si dëshiron të duket në një hapësirë të caktuar kohore.

DEKLARATA E VIZIONIT

Deklarata e vizionit është shprehje formale e vizionit. Ai përshkruan me fjalë dhe imazhe se çfarë orvatet të bëhet komuniteti. Deklarata e vizionit është pika fillestare për krijimin dhe zbatimin e planeve të veprimit.

PROJEKTI I VIZIONIT

Projekti i vizionit përshkruan shprehjen hapësinore të deklaratës së vizionit. Ai përmban strukturën e dëshiruar hapësinore për çështjet kyçe të ndara ose të nivelit të integruar.

VIZIONIMI

Vizionimi është proces përmes të cilit komuniteti paraqyturon të ardhmen e dëshiruar, dhe planifikon se si të arrihet ajo e ardhme. Ai bashkon njerëzit për të zhvilluar një imazh të përbashkët të asaj se çfarë dëshirojnë të bëhet komuniteti i tyre.

PUNËTORIA PËR VIZIONIMIN

Punëtorja për vizionimin është një takim një ditor ose shumëditor i palëve të interesit të përfshirë në procesin e planifikimit për një hapësirë specifike ose çështje hapësinore, që synon paraqitjen e një deklaratë për vizionin dhe projektimin e vizionit për hapësirën ose çështjen e planifikimit.

TË RREZIKUARA/VULNERABËL

Të hapur ndaj sulmit moral ose fizik, kritikizmit, izolimit shoqëror ose tundimit.

ZONË

Çfarëdo shtegu ose fushe e cila dallon në ndonjë aspekt nga të tjerët ose shquhet për ndonjë qëllim, nga shtigjet ose fushat e afërta.

ZONIFIKIMI

Përcakton qëllimin për të cilin mund të përdoret toka.

RREGULLORE PËR ZONIFIKIM

Ajo vendosë për llojet e aktiviteteve të cilat do të jenë të pranueshme në ngastra të caktuara (si hapësira e lirë, për banim, bujqësore, komerciale ose industriale).

SHTOJCA 1

PARTNERËT E VIZIONIMIT

UN-HABITAT NË KOSOVË

Që prej përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, UN-Habitati e ka promovuar qeverisjen e mirë, sigurinë e pronave, zhvillimin e qëndrueshëm të vendbanimeve dhe planifikimin hapësinor gjithëpërfshirës, në Kosovë dhe në rajon. Angazhimet e UN-Habitatit janë përqendruar në themelimin e institucioneve për t'u marrë me çështje pronësore dhe të planifikimit, siç është Drejtoria Pronësore dhe Banesore, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Instituti për Planifikim Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Linja tjetër e angazhimeve ka qenë e përqendruar në ngritjen e kapaciteteve për menaxhim efikas të qeverive lokale përmes programeve për ngritjen e kapaciteteve dhe asistencës së dhënë në vendin e punës, ku përfshihen: Programi për qeverinë lokale, dhe Programi për mbështetjen e komunave (2000-2001), Programi për menaxhim dhe planifikim urban (2001-2003), Programi për qeverisjen dhe planifikimin e zhvillimit (2003-2006), Programi për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal (2005-2008) dhe Programi i dytë për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal (2008-2011) dhe Programi i tretë i mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal. Programet janë realizuar duke iu falënderuar ndihmës financiare të Agjencisë suedeze për zhvillim ndërkombëtar dhe qeverisë së Holandës. Për më shumë hollësi, shihni pjesën e falënderimeve në faqen e internetit www.unhabitat-kosovo.org.

TRASHËGIMIA KULTURORE PA KUFIJ

Trashëgimia Kulturore pa Kufij është themeluar në vitin 1995, dhe është fondacion suedez privat i cili vepron në frymën e 'Konventës së Hagës' të vitit 1954 për mbrojtjen e pronës kulturore të rrezikuar nga luftërat, fatkeqësitë natyrore, neglizhenca, varfëria apo konfliktet politike apo sociale. Një pjesë e madhe e aktiviteteve të Trashëgimisë Kulturore pa Kufij financohet nga Sida (Agjencia suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar), dhe në Kosovë i tërë personeli dhe menaxhimi i këtij fondacioni është vendor. Që nga viti 2001, Trashëgimia Kulturore pa Kufij në Kosovë ka zbatuar metoda të bazuara në komunitet për ruajtjen e integruar të trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, të formuluar brenda një vizioni afatgjatë i

cili është i ngulitur mirë në historinë e vendit. "Njohja e së kaluarës krijon vizion të fuqishëm për të ardhmen." Ky citat përdoret për emërtimin e misionit të Trashëgimisë Kulturore pa Kufij në Kosovë, i cili është theksuar në një raport të Ministrisë së Danimarkës për Punë të Brendshme dhe Çështje Sociale (dhjetor 2009). Ky citat gjithashtu përputhet me qëllimet dhe metodat e punëtorëve për vizionim, dhe më së miri ilustron me "hartën e kujtimeve", si hap i parë në procesin e vizionimit. Trashëgimia Kulturore pa Kufij në mënyrë gjithëpërfshirëse ka ndihmuar në përgatitjen e shumë prej këtyre hartave të kujtimeve dhe ka publikuar të ashtuquajturën "hartën nostalgjike" të Junikut në formë të një fletushke (shihni shtojcën 13). Juniku jo vetëm që është një ndër shembujt më të mirë për sa i përket planifikimit të veprimeve me pjesëmarrje, ai gjithashtu përfaqëson një nga shembujt më të mirë të Trashëgimisë Kulturore pa Kufij për ruajtjen e integruar të trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore, me një numër gjithnjë në rritje të kullave tradicionale të restauruara, të cilat ofrojnë shërbime të fjetjes dhe mëngjesit dhe shërbime të tjera turistike. Për më shumë informata, vizitoni faqen e internetit www.chwbkosovo.org.

FRIEDRICH-EBERT-STIFTUNG

Friedrich-Ebert-Stiftung është fondacion gjerman jofitimprurës i cili është i përkushtuar për avancimin e politikave publike në frymën e vlerave themelore të demokracisë sociale përmes arsimit, hulumtimeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Misioni i tij, si në Gjermani, vendi nga i cili vije, ashtu edhe në mbi 100 shtete të tjera, është promovimi i demokracisë, drejtësisë sociale dhe reformës ekonomike përmes ngritjes së kapaciteteve, zhvillimit të politikave dhe promovimit të dialogut. Ky fondacion ka filluar të veprojë në Kosovë vetëm një vit pas luftës në Kosovë. Që nga themelimi i zyrës së fondacionit në Prishtinë në vitin 2000, fondacioni ka qenë i përkushtuar drejt ofrimit të ndihmës në fushën e strukturave demokratike dhe pajtimit etnik në Kosovë. Në bashkëpunim me partnerët vendorë, ky fondacion ka për qëllim që të kontribuojë për një shoqëri sociale të drejtë dhe shoqëri civile aktive. Për më shumë – përfshirë një raport të shkurtë rreth punëtorisë së fundit për vizionim me komunitetin e Graçanicës – vizitoni faqen e internetit www.fes-prishtina.org.

SHTOJCA 2

BËRJA E VENDEVE

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP)

Bashkë Bëjmë Qytete më të Mira


finansuar nga
Sida

Mars - 2008

Shndërrimi i hapësirave në vende

HYRJE

Planet zhvillimore komunale dhe urbane nevojiten në mënyrë urgjente për udhëheqjen e zhvillimit urban dhe rural në Kosovë. Shndërrimi i këtyre planeve strategjike në intervenime reale që përmirësojnë ambientin urban kërkon propozime të detajuara të dizajnit urban dhe të ambientit. Karta e Leipzigit për qytetet e qëndrueshme të Evropës (Ministrat e Planifikimit Hapësinor të BE-së, Maj 2007) konsideron "krijimin dhe garantimin e hapësirave të kualitetit të lartë ... të jetë e një rëndësie kryesore për forcimin e konkurrencës së qyteteve evropiane". Kjo fletushkë e trajton këtë deklaratë nga perspektiva e Kosovës – pse vlen kjo këtu njëjtë sikur edhe në çdo vend tjetër të Evropës dhe cila është domethënia e saj. Viteve të fundit kemi qenë dëshmitarë të një rritjeje të shpejtë të popullatës së qyteteve të Kosovës, më së shumti në Prishtinë, e cila ka dyfishuar madhësinë që nga fundi i konfliktit. Ndryshimi fizik është zhvilluar në mënyrë paralele me ndryshimin social pasi që me urbanizim ka ardhur deri te shkatërrimi i lidhjeve klanore dhe familjare. Infrastruktura, sic janë rrugët, hapësirat publike dhe shkollat, por poashtu edhe uji, kanalizimi dhe rrjeti elektrik, është munduar ti përgjigjet kërkesave të gjithnjë e më shumë njerëzve me pritje gjithnjë e më të mëdha. Këto kërkesa dhe pritje janë duke rritur konkurrencën për hapësirën në qytet, ku dëshira për lehtësimin e mobilitetit personal është në fillim të agjendës së shumicës së vendimmarrësve. Ndoshta një nga shprehjet më kryesore të kësaj janë rrugët e Prishtinës dhe të qyteteve tjera të Kosovës, të cilat janë të bllokuara nga komunikacioni dhe pushtojnë gati gjithë hapësirën ndërmjet mureve të ndërtesave. Kjo është një çështje kryesore kur dihet se rrugët dhe hapësirat e hapura përbëjnë zakonisht afro 20% të shumicës së qyteteve. Këto janë forumi kryesor për bashkëveprimin social, ato lidhin vendet në të cilat duhet të arrijmë për plotësimin e nevojave tona (shkolla, puna, përkujdesja shëndetësore, dyqanet etj.) dhe paraqesin perspektivën



SHTOJCA 3

PARIMET UDHËZUESE PËR PLANIFIKIM DHE VIZIONIM NGA KOMUNITETI

Në një doracak praktik dhe në faqe të internetit, Nick Wates i ka paraqitur 47 parime të përgjithshme për një gamë të gjerë të metodave dhe instrumenteve të planifikimit nga komuniteti, ku më relevantet e të cilave janë përzgjedhur për qasjet e vizionimit nga komuniteti. Parimet e shtypura me shkronja të theksuara janë të shqyrtuara më tej në kapitullin 2 të këtij mekanizmi për vizionim.

PRANONI AGJENDA TË NDRYSHME

Individët do të dëshirojnë të përfshihen për arsye të ndryshme. Kjo nuk duhet të paraqesë ndonjë problem, por shërben për t'u njoftuar me agjendat e ndryshme të individëve.

PRANONI KUFIZIMET

Asnjë aktivitet i planifikimit nga komuniteti nuk mund t'i zgjidhë të gjitha problemet e botës. Por kjo nuk është arsye për të mos vepruar. Përmirësimet praktike të kufizuara pothuajse gjithnjë do të shpijnë në rezultate, dhe aktivitetet e planifikimit nga komuniteti shpesh mund të shërbejnë si shtytëse për ndryshime më themelore.

DAKORDOHUNI PËR RREGULLA DHE KUFIJ

Të gjitha grupet kryesore të interesit duhet të gjejnë një gjuhë të përbashkët rreth qasjes së miratuar. Posaçërisht në ato komunitete ku ekziston një lloj frike, për shembull se të tjerët mund të mundohen të marrin përfitime territoriale, është tejet e rëndësishme që rregullat dhe kufijtë të kuptohen mirë dhe të miratohen. Në veçanti është me rëndësi që të gjithë ta kenë të qartë se çka mundet dhe çka nuk mundet të ndryshohet si rezultat i përfshirjes së komunitetit.

SHMANGNI ZHARGONIN

Përdorni gjuhë të thjeshtë dhe të qartë. Zhargonin u paraqet individëve pengesë për t'u angazhuar dhe zakonisht shërben si perde tymi për fshehjen e paaftësisë, injorancës apo arrogancës. Për zhargonin e nevojshëm, përdorni fjalorthin.

JINI TË SINQERTË

Jini të hapur dhe të drejtpërdrejtë rreth natyrës së aktiviteteve. Individët në përgjithësi do të marrin pjesë më me entuziazëm nëse ata e dinë që diçka mund të arrihet përmes pjesëmarrjes së tyre (p.sh. nëse ka buxhet për ndonjë projekt kapital). Por ata mund të jenë mjaft të përgatitur të marrin pjesë 'duke rrezikuar' me kusht që të jenë të njoftuar me probabilitetin. Nëse ekziston vetëm një mundësi e vogël e ndryshimit pozitiv si rezultat i pjesëmarrjes së qytetarëve, thuaj atë. Shmangni agjendat e fshehta.

JINI TRANSPARENT

Objektivat dhe rolet e individëve nëpër organizime duhet të jenë të qarta dhe transparente. Për shembull, mund të duket triviale por rëndësia e distinktivëve me emra për të shmangur atë që nëpër organizime të jenë të pranishëm vetëm pjesëmarrës të caktuar asnjëherë nuk mund të theksohet mjaft.

JINI VIZIONARË DHE REALISTË

Pa pasur pritshmëri është vështirë që të arrihet diçka. Por edhe të qenit plotësisht utopik mund të jetë zhgënjyese. Gjeneroni një bilanc mes caktimit të synimeve vizionare utopike dhe të qenit realist rreth opsioneve praktike që janë në dispozicion.

NGRITNI KAPACITETET LOKALE

Qëndrueshmëria afatgjate e komunitetit varet nga zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe social. Shfrytëzoni çdo mundësi për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve lokale.

KOMUNIKONI

Përdorni të gjitha mediat në dispozicion për t'i njoftuar qytetarët me atë që jeni duke e bërë dhe me mënyrën e përfshirjes së tyre. Gazetat e komunitetit dhe faqet e internetit janë të paçmueshme. Dhënia e informatave është element jetik për të gjitha aktivitetet me pjesëmarrje.

FLEKSIBILITETI

Jini të përgatitur t'i modifikoni proceset sipas rrethanave. Shmangni metodat dhe strategjitë jofleksibile.

AKTIVITETE VAZHDOESE

Mungesa e aktiviteteve të vazhdueshme është dështimi më i shpeshtë, ku zakonisht ndodhë për shkak të mungesës së planifikimit apo buxhetit. Sigurohuni që të ndani kohë dhe burime për dokumentimin dhe publikimin e rezultateve të dala prej iniciativave të planifikimit nga komuniteti dhe për veprime lidhur me ato rezultate.

VEPRONI ME SHPEJTËSINË E DUHUR

Nxitimi mund të shpie në probleme. Në anën tjetër, nëse nuk caktohen afate kohore, gjërat mund të dalin jashtë rrethje. Bashkëpunimi me këshilltarë të jashtëm të cilët kanë përvojë mund ta përshpejtojë procesin, por shpeshherë në llogari të zhvillimit të kapaciteteve lokale. Gjeni bilancin e duhur.

ARGËTOHUNI

Përfshirja për krijimin dhe menaxhimin e ambientit nuk duhet të jetë detyrë. Ky mund të jetë rast shumë i mirë për t'u takuar me persona të tjerë dhe për t'u argëtuar. Ambientet më interesante dhe më të qëndrueshme janë krijuar aty ku personat janë argëtuar gjatë krijimit të tyre. Planifikimi nga komuniteti kërkon humor. Përdorni skica humoristike, shaka dhe loja kurdo që është e mundur.

INTEGROHUNI NË VENDIMMARRJE

Aktiviteti i planifikimit nga komuniteti duhet të integrohet në proceset e qeverisë për vendimmarrje. Proceset pjesëmarrëse rrezikohen nëse mungojnë lidhjet e qarta me vendimmarrjen.

PËRFSHINI TË GJITHA SHITESAT E KOMUNITETIT

Individët e moshës, gjinisë, prejardhjes dhe kulturës së ndryshme pothuajse gjithnjë kanë perspektiva të ndryshme. Sigurohuni

që të përfshihet një spektër i gjerë i komunitetit. Zakonisht kjo është shumë më e rëndësishme sesa përfshirja e një numri të madh të individëve nga komuniteti.

PRONËSIA VENDORE E PROCESIT

Procesi i planifikimit nga komuniteti duhet të 'jetë pronë' e vendasve. Edhe pse konsulentët apo organizatat ndërkombëtare apo vendore mund të ofrojnë këshilla dhe të marrin përgjegjësi për aktivitete të caktuara, komuniteti vendor duhet të merr përgjegjësinë për procesin në tërësi.

TANI ËSHTË KOHA E DUHUR

Koha më e mirë për të filluar me përfshirjen e individëve është fillimi i programit. Sa më parë që ata të përfshihen, aq më të mira do të jenë rezultatet. Por nëse programet veçse kanë filluar, pjesëmarrja duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Filmoni menjëherë.

PËRGATITUNI SI DUHET

Aktivitetet më të suksesshme janë padyshim ato për të cilat është dhënë kohë dhe përpjekje e mjaftueshme për organizimet para-prake dhe angazhimin e personave të interesuar.

PROCESI PO AQ I RËNDËSISHËM SA EDHE PRODUKTI

Mënyra se si bëhen gjërat shpesh është po aq e rëndësishme sa edhe rezultati përfundimtar. Por mbani mend se synimi është zbatimi. Pjesëmarrja është e rëndësishme, por nuk do të thotë se çdo gjë përfundon me të.

MBANI SHËNIME DHE DOKUMENTE

Sigurohuni që aktivitetet e pjesëmarrjes të regjistrohen dhe të dokumentohen siç duhet në mënyrë që të shihet lehtë se kush dhe si ka qenë i përfshirë. Meqë gjërat harrohen shumë lehtë, këto shënime më vonë mund të jenë të paçmueshme.

RESPEKTONI NJOHURITË LOKALE

Të gjithë individët, qofshin të shkolluar apo të pashkolluar, të pasur apo të varfër, fëmijë, gra apo burra, kanë njohuri të mrekullueshme të ambientit të tyre dhe janë të aftë që të analizojnë dhe vlerësojnë situatën e tyre, shpeshherë edhe më mirë sesa profesionistët e trajnuar. Respektoni perceptimet, zgjedhjet dhe mundësitë lokale dhe përfshini personat lokalë në caktimin e synimeve dhe të strategjive.

GRUPET E POSAÇME TË INTERESIT

Grupet e rëndësishme që përfaqësojnë interesa të ndryshme të posaçme luajnë rol jetik në formësimin e mjedisit për shkak të ndërlidhshmërisë së tij. Vendimmarrësit duhet t'i marrin parasysh dëshmitë që e përfaqësojnë varietetin më të mirë të interesave të komuniteteve ekzistuese dhe të ardhshme, përfshirë marrjen parasysh të pikëpamjeve të grupeve specifike të interesit të cilët kanë njohuri të caktuara.

SHPENZONI PARA

Për zbatimin e proceseve efektive të pjesëmarrjes nevojitet kohë dhe energji. Ekzistojnë metoda të ndryshme për t'iu përshtatur buxheteve të ndryshme dhe shumë gjëra mund të arrihen duke përdorur vetëm kohën dhe energjinë e individëve. Por buxhetet shumë të kufizuara zakonisht shpijnë në dëm të cilësisë dhe rezultate të dobëta. Mbani mend se planifikimi nga komuniteti është aktivitet i rëndësishëm, suksesi apo dështimi i së cilit mund të ketë implikime dramatike për gjeneratat e ardhshme si dhe për burimet tuaja. Kostot e ndërtimit të diçkaje të gabuar në vendin e gabuar mund të jenë astronomike dhe bënë që kosto e planifikimit të duhur nga komuniteti të zbehet dhe të bëhet e parëndësishme. Bëhuni zemërgjerë për planifikimin e buxhetit.

SHFRYTËZONI EKSPERTËT NË MËNYRË TË DUHUR

Rezultatet më të mira arrihen kur personat lokalë punojnë për së afërmi dhe në mënyrë intensive me ekspertët nga të gjitha disiplinat e nevojshme. Krijimi dhe menaxhimi i mirë i mjedisit është shumë i ndërlidhur dhe kërkon lloje të ndryshme të ekspertizës dhe përvojës. Mos iu druani ekspertizës, pranojeni atë. Por shmangni varësinë nga profesionistët, apo rrëmbimit të tyre. Mbajeni kontrollin lokal. Shfrytëzoni ekspertët 'shpesh e nga pak' për t'iu lënë pjesëmarrësve lokalë kohë për të zhvilluar mundësitë, edhe nëse ata nganjëherë bëjnë gabime.

SHFRYTËZONI FACILITATORËT

Orkestrimi i aktiviteteve grupore është aftësi e vërtetë. Pa facilitim të mirë, mund të dominojnë ata që janë më të artikuluarit dhe

më të fuqishmit. Në veçanti nëse janë të përfshirë shumë persona, sigurohuni që personi (apo personat) që i drejtojnë organizimet të ketë aftësi të mira facilituese. Në të kundërtën, angazhoni dikë që i posedon ato aftësi.

SHFRYTËZONI TALENTIN LOKAL

Shfrytëzoni aftësitë dhe profesionalizmin lokal brenda komunitetit para se t'iu plotësoni ato me ndihmë nga jashtë. Kjo do të ndihmojë për zhvillimin e mundësive brenda komunitetit dhe për arritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë.

SHFRYTËZONI PERSONA NGA JASHTË, POR ME KUJDES

Një parim qendror i planifikimit nga komuniteti thotë se personat lokalë dinë më së miri. Por personat që vijnë nga jashtë komuniteti, nëse informohen mirë, mund të japin perspektivë të freskët e cila mund të jetë gjallëruese. Gjetja e një mesazhi të mirë mes personave lokalë dhe të jashtëm është e rëndësishme; mos lejoni që personat lokalë të ndihen të përmbatur apo të kërcënuar nga 'të huajt'.

VIZUALIZONI

Personat mund të marrin pjesë në mënyrë shumë më efektive nëse informatat paraqiten në mënyrë vizuale në vend se të paraqiten me fjalë. Një pjesë e madhe e zhvillimit të dobët dhe rreziku për një zhvillim të mirë ndodhin për shkak se personat nuk e kuptojnë se si do të duket ai zhvillim. Sa herë që mundeni, përdorni grafikone, harta, ilustrime, vizatime, fotomontazhe dhe modele. Përdorni tabela prej letre, notes ngjytëse, pulla me ngjyrë dhe shirita për ta bërë procesin të dukshëm.

PUNONI NË LOKACION

Sa herë që është e mundur, vendosni aktivitetet e planifikimit nga komuniteti në vendin që është duke u planifikuar. Kjo do t'ia lehtësonte secilit kuptimin e lidhjes mes konceptit dhe realitetit.

Burimi: <http://www.communityplanning.net/>

SHTOJCA 4


SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË 1

Në fund të vitit 2006, si rezultat i punës së gjatë dhe intensive, Këshilli i qytetit të Antverpit në Belgjikë e miratoi planin e vet strategjik të strukturës hapësinore, që tani është udhërrëfyes i shumë intervenimeve strategjike urbane. Kjo politikë hapësinore përcakton vizionin për një zhvillimit të dëshiruar të qytetit dhe është e bazuar në një analizë të bërë me kujdes të niveleve të ndryshme të qytetit, siç janë nevojat e qytetit, por edhe të pikave të forta dhe mundësive të tij. Plani strukturor e projekton qytetin e së nesërme dhe e shndërron atë në një plan veprimi dhe projekte strategjike urbane të prekshme. Një nga projektet më kryesore është *Spoor Noord* (Oborri hekurudhor i veriut). *Spoor Noord* ishte zonë hekurudhore e braktisur. Për më shumë se një shekull, kjo zonë prej 24 hektarëve ka qenë pengesë në mes të zonave përreth të cilat ishin shumë të ndërtuara. Tani kjo zonë është shndërruar në një peizazh të plotë. Ky projekt u bë simbol i një vizioni të ri urban të jetesës dhe zhvillimit të qëndrueshëm, i bazuar në një vizion të qartë, të shprehur me strukturë hapësinore siç është paraqitur në ilustrimin më poshtë. Vizioni ishte elementi thelbësor për planet urbane më të detajuara projektuese dhe teknike. Projekti gjithashtu konsiderohet si shembulli më i mirë praktik

i planifikimit dhe vizionimit pjesëmarrës dhe përfshirës. 20 për qind e buxhetit për planifikim dhe 3.5 për qind e buxhetit të përgjithshëm për investimet ishte alokuar për përfshirje kreative të palëve me interes, përfshirë grupet e komuniteteve pakicë që jetonin përreth asaj zone dhe që ishin vështirë për t'i angazhuar. Ilustrimet tregojnë llojet e ndryshme të aktiviteteve pjesëmarrëse të mbajtura gjatë procesit të planifikimit, nga fillimi deri tek zbatimimi gradual. Punëtoritë e vizionimit dhe debatet për planifikim ishin të kombinuara me organizime kulturore për mobilizimin e të gjitha grupeve të komunitetit dhe për fuqizimin e pronësisë lokale të zonës, gjë e cila doli të ishte shumë e suksesshme.

MËSIMET E NXJERRA

- Vizioni i qartë i komunitetit është gurthemel i bashkëpunimit të suksesshëm i përbërë prej shumë niveleve.
- Qeveria lokale udhëheqë bashkëpunimin e përbërë prej shumë niveleve.
- Burime të mjaftueshme të përfshirjes kreative të palëve me interes dhe të komunitetit.



SHTOJCA 5

VIZIONI I PLANERËVE EVROPIANË

Qyteti i ndërlidhur: Kartë e planerëve të qyteteve të shekullit 21.

Këshilli evropian i planerëve hapësinorë beson se në shekullin 21 Evropa me vendosmëri do të avancohet drejt synimit të integritimit. Në kuadër të kësaj kornize zhvillimore, Këshilli paraqet një vizion të përbashkët mbi të ardhmen e qyteteve evropiane (Pjesa A). Ky është vizioni i një rrjeti të qyteteve, që do të:

- Ruajnë pasurinë dhe diversitetin kulturor, që rezultojnë nga historia e tyre e gjatë, duke e lidhur të kaluarën me kohën e tashme dhe të ardhme.
- Lidhen në një mori rrjetesh domethënëse dhe funksionale.
- Mbesin konkurruese në mënyrë kreative me përpjekje për plotësueshmëri dhe bashkëpunim.
- Kontribuojnë me vendosmëri për mirëqenien e banorëve dhe shfrytëzuesve të vet.

Integrojnë elementet e punuara nga njeriu dhe ato natyrore të mjedisit. Në kuadër të Kartës, vizioni gjithashtu përfshinë edhe kornizën e zbatimit (Pjesa B), e cila është e përbërë prej:

- Një përmbledhje të shkurtë të çështjeve dhe sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen qytetet në fillim të mileniumit të tretë.
- Zotimeve që kërkohen nga ana e planerëve hapësinorë për realizimin e vizionit.

Kjo Kartë është miratuar në Athinë, në vitin 2003, 70 vite pas Kartës moderniste të Athinës (dhe është emëruar me nofkën 'Karta e Re e Athinës'). Kjo i është adresuar kryesisht planifikuesve profesionistë të cilët punojnë në mbarë Evropën dhe atyre që kanë të bëjnë me procesin e planifikimit – për t'i dhënë drejtim veprimeve të tyre, për koherencë më të lartë në ndërtimin e një rrjeti kuptimplotë të qyteteve në Evropë të ndërlidhur përgjatë kohës, në të gjitha nivelet dhe sektorët. Planifikimi hapësinor është thelbësor për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Në veçanti ai ka të bëjë me menaxhimin e matur të hapësirës, që është burim esencial natyror, i kufizuar për nga sasia, dhe me kërkesa gjithnjë në rritje për të. Kjo gjithashtu kërkon punë ekipore ndër-disiplinore ku përfshihen aftësi të ndryshme në nivele të ndryshme gjatë proceseve afatgjate. Atribut i posaçëm i profesionit të planifikimit është mundësia e tij për marrjen parasysh të një game të çështjeve dhe shndërrimi i tyre në terme hapësinore. Këshilli Evropian për planifikuesit hapësinorë është i vetëdijshëm për varietetin dhe universalitetin e profesionit të planifikimit në Evropë meqë ka marrë parasysh diversitetin e pasur të qyteteve dhe rajoneve të saj.

ZOTIMET

Kjo pjesë e Kartës paraqet zotimet e planifikuesve profesionistë që punojnë në Evropë. Ajo përshkruan një grup vlerash që duhet të respektohen nga planifikuesit për këshillimin e politikanëve dhe të qytetarëve drejt arritjes së vizionit dhe zbatimit të parimeve për zhvillimin e qytetit që janë paraparë në Kartë. Planifikimi hapësinor është në esencë punë ekipore ndër-disiplinore ku profesionistë dhe aktorë të ndryshëm përfshihen nëpër procese të ndërlikuara. Këto zotime kanë për qëllim identifikimin e specifikës së disiplinës të planifikimit që i dallon planifikuesit nga palët e tjera të përfshira dhe, në të njëjtën kohë, qartësimin e anëve potenciale të forta të profesionit, duke e ritheksuar vetëbesimin, kohezionin dhe solidaritetin mes planifikuesve. Roli i planifikuesve evoluon sipas zhvillimit të shoqërisë, ligjeve dhe politikave mbi planifikimin. Këto dallojnë për nga kornizat e ndryshme politike dhe sociale në çdo shtet ku planifikuesit veprojnë si vizionarë, teknokratë, menaxherë, këshilltarë, mentorë, apo instruktorë. Krahasuar me disiplina të tjera, ndryshimi dallues është se planifikuesit hapësinorë duhet të përqendrohen kryesisht në interesat e shoqërisë si tërësi, interesat e vendbanimit apo të rajonit si entitet dhe në të ardhmen afatgjatë. Është e qartë se planifikimi nuk ka të bëjë vetëm me përgatitjen e planit. Ai gjithashtu është pjesë e procesit politik që ka për qëllim balancimin e të gjitha interesave relevante – publike dhe private – për t'i zgjidhur kërkesat kontradiktore për programet hapësinore dhe zhvillimore. Kjo vë në pah rëndësinë e rolit të planifikuesit si ndërmjetësues. Tani, si dhe në të ardhmen, aftësitë e planifikuesve për ndërmjetësim dhe negociim do të bëhen shumë e më shumë të rëndësishme.

Kështu që roli i planifikuesve do të bëhet më kërkuar sesa kurrë më parë. Ai do të kërkojë aftësi të shtuara për projekttime, sintetizim, menaxhim dhe aftësi administrative, për të mbështetur dhe udhëzuar procesin e planifikimit publik nëpër të gjitha fazat: Ai gjithashtu do të kërkojë qasje shkencore, arritjen e konsensusit social ku merren parasysh dallimet individuale, si dhe vendimet politike, që shpijnë në zbatim, menaxhim, monitorim dhe shqyrtim të planeve dhe programeve. Këto role të ndërlikuara dhe sfiduese kërkojnë zotime të posaçme nga planifikuesit hapësinorë të angazhuar si këshilltarë politikë, projektues, menaxherë urbanë dhe shkencëtarë në shekullin 21.

Shtojca në të gjelbër paraqet një përzgjedhje të zotimeve dhe detyrave të ndryshme të planifikuesve.

Për një vlerësim kritik territorial të Kosovës vis-à-vis Kartës evropiane të planifikuesve, shihni *The Transitional City. Post-conflict Kosovo and The New Charter of Athens/Qyteti në tranzicion. Kosova pas konfliktit dhe Karta e re e Athinës*, F. D'hondt, *Built Environment*, 2011

SHTOJCA 6

PLANIFIKUESI ËSHTË...

PLANIFIKUESI SI SHKENCËTAR ËSHTË I ZOTUAR QË:

T'i analizojë karakteristikat dhe trendet ekzistuese, duke pas parasysh kontekstin më të gjerë gjeografik dhe duke u përqendruar në nevojat afatgjate për t'iu dhënë informata të plota, të qarta dhe të sakta vendimmarrësve, palëve të interesit dhe qytetarëve. Të ketë njohuri të duhura rreth filozofisë, teorisë, hulumtimeve dhe praktikave bashkëkohore të planifikimit, që përfshinë zhvillim të vazhdueshëm profesional.

PLANIFIKUESI SI PROJEKTUES DHE SI VIZONAR ËSHTË I ZOTUAR QË:

Të mendojë në të gjitha dimensionet, duke i balancuar strategjitë vendore dhe rajonale në kuadër të trendëve globale. T'i shtrijë mundësitë për të gjithë, duke pranuar përgjegjësi të posaçme për nevojat e grupeve dhe personave që janë në situata të pafavorshme. Të bëjë përpjekje për mbrojtjen e integritetit të mjedisit natyror dhe shkëlqesinë e projektimit urban dhe përpjekje për ruajtjen e trashëgimisë së mjedisit ku janë bërë ndërtime për gjeneratat e ardhshme. Të elaborojë zgjidhje alternative potenciale të problemeve dhe sidave specifike, të bëjë matje të kapaciteteve dhe të ndikimeve, zgjerim të identiteteve lokale dhe të jap kontribut në programet e tyre zbatuese dhe në studimet e fizibilitetit. T'i zhvillojë dhe elaborojë vizionet e zhvillimit hapësinor duke treguar mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të qyteteve apo rajoneve. T'i bindë të gjitha palët e përfshira që të kenë një vizion të përbashkët dhe afatgjatë për qytetin apo rajonin e tyre, përtej interesave dhe objektivave të tyre individuale.

PLANIFIKUESI SI KËSHILLTAR POLITIK DHE NDËRMJETËSUES ËSHTË I ZOTUAR QË:

T'i respektojë parimet e solidaritetit, subsidiaritetit dhe barazisë për vendimmarrje, për zgjidhje të planifikuara dhe për zbatimin e tyre. T'i mbështesë autoritetet qytetare përmes njoftimit të tyre lidhur me propozimet, objektivat, caqet, ndikimet, problemet, dhe përmes ofrimit të planeve dhe zgjidhjeve që kanë për qëllim ngritjen e mirëqenies së qytetarëve. Të sugjerojë dhe të

elaborojë instrumente legislative operacionale për të siguruar efikasitet dhe drejtësi sociale në politikat hapësinore. Të facilitojë pjesëmarrje dhe përfshirje të vërtet të qytetarëve në takime mes autoriteteve lokale, vendimmarrësve, palëve me interes ekonomik dhe qytetarëve individualë për bashkërendimin e zhvillimeve dhe sigurimin e vazhdimësisë dhe kohezionit hapësinor. Të bashkëpunojë me të gjitha palët e përfshira dhe t'i bashkërendojë ato për të gjetur konsensus apo për t'iu zgjidhur konfliktet me vendime të qarta të përgatitura për autoritetet e duhura. Të përpiqet për zhvillimin e një niveli të lartë të komunikimit për të siguruar njohuri dhe mirëkuptim në mesin e përdoruesve të ardhshëm.

PLANIFIKUESI SI MENAXHER URBAN ËSHTË I ZOTUAR QË:

Të miratojë qasje strategjike menaxheriale për proceset e zhvillimit hapësinor në vend se vetëm të bëjë plane për t'iu shërbyer kërkesave administrative burokratike. Të arrijë efikasitet dhe efektshmëri të propozimeve të miratuara, duke pasur parasysh fizibilitetin ekonomik dhe mjedisor dhe aspektet sociale të qëndrueshmërisë. T'i merr parasysh parimet e planifikimit dhe qëllimet dhe objektivat e dokumentit Perspektiva evropiane për zhvillim hapësinor dhe të dokumenteve të tjera të politikës së Bashkimit Evropian (BE) – për t'iu përshtatur propozimet lokale dhe rajonale me strategjitë dhe politikat evropiane. Të koordinojë nivelet e ndryshme territoriale dhe sektorët e ndryshme për të siguruar bashkëpunim, përfshirje dhe mbështetje të të gjitha organeve administrative dhe autoriteteve territoriale. Të nxisë partneritete mes sektorëve publike dhe private për të shtuar investimet, për të krijuar vende pune dhe për të arritur kohezion social. Të përfitojë pozitivisht nga fondet evropiane përmes nxitjes së pjesëmarrjes së autoriteteve lokale dhe rajonale në kuadër të programeve dhe projekteve hapësinore të bashkëfinancuara nga BE-ja. T'i monitorojë planet për rregullimin e rezultateve të paparashikueshme, dhe të sigurojë lidhje të vazhdueshme të dhënies së mendimeve mes politikës së planifikimit dhe zbatimit. Burimi: www.ceu-ectp.eu

SHTOJCA 7

PASQYRË E SHKURTË PËR KOSOVËN

Sipërfaqja: 10,908 km²

Popullsia: 1,733.872 (rezultati preliminar nga regjistrimi i popullsisë i bërë në vitin 2011, komunat në veri të lumit Ibër nuk janë të përfshira)

Kryeqyteti: Prishtina

Gjuhët: Shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe rome

Religjionet: Islam, ortodoks, katolik

Valuta: Euro

Anëtarësimi ndërkombëtar: Anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (që nga qershori i vitit 2009)

PORTRETI HAPËSINOR

Kosova është pellg gjeografik në lartësi prej rreth 500 metrash, e rrethuar me bjeshkë dhe e ndarë në dy nënrajone, me një vargmal qendror veri-jug, me madhësi dhe popullsi përafërsisht të barabartë. Kosova ka një diasporë të madhe, kryesisht në Evropën perëndimore, e cila luan një rol të rëndësishëm, posaçërisht përmes dërgesave monetare dhe financimit të strukturave paralele, të krijuara gjatë viteve të 90-ta. Rritja demografike vlerësohet të jetë rreth njëzetë në njëmijë, dhe numri mesatar i anëtarëve të familjes është rreth 6 persona, sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të popullsisë të mbajtur në vitin 2011. Popullsia e Kosovës është më e reja në Evropë, ku rreth gjysma janë nën moshën 20 vjeçare. Rreth 60 për qind e vendeve të punës para konfliktit kanë qenë të lidhura me aktivitetet bujqësore (përfshirë pylltarinë dhe agrobiznesin). Papunësia ishte e lartë për shkak të ndikimeve afatgjate të një krize rajonale. Ky nivel i papunësisë ishte në mënyrë shpërpushjeje të lartë në mesin e shqiptarëve. Pavarësisht subvencioneve të konsiderueshme zhvillimore, nga të gjitha republikat jugosllave Kosova ishte krahu më e varfër e Jugosllavisë. Përveç kësaj, gjatë viteve të 90-ta, politikat e varfra ekonomike, sanksionet ndërkombëtare, qasja e dobët në tregtinë dhe financimet e jashtme dhe konflikti etnik i shkaktuan dëme të mëdha ekonomisë. Kosova thuhet të jetë ekonomia më e varfër në Evropë, ku të ardhurat për kokë banori vlerësohen të jenë 1,565 euro (2004). Më shumë se 35 për qind e popullsisë jetojnë nën kufirin e varfërisë (1.42 euro në ditë për një të rritur), ndërsa më shumë se 15 për qind jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme (0.93 euro në ditë). Pjesa më e madhe e zhvillimit ekonomik që nga viti 1999 është arritur në fushën e tregtisë, në sektorët e shitjes me pakicë dhe atë të ndërtimit. Sek-



tori privat që ka filluar të veprojë që nga viti 1999 është kryesisht i shkallës së ulët. Sektori industrial mbetet i dobët, dhe furnizimi me energji elektrike është ende i paqëndrueshëm, gjë që paraqet pengesë të madhe. Papunësia është mjaft e madhe, me rreth 40-50 për qind të fuqisë punëtore të papunë.

Banorët e Kosovës janë të shpërndarë në më shumë se 1,450 vendbanime, në gjithsej 37 komuna. Shumica (53 për qind) apo 63 për qind e popullsisë së përgjithshme jeton nën lartësinë prej 700 metra, ndërsa pjesa tjetër jeton në vendbanime që gjenden në një lartësi prej më shumë se 700 metra, me mungesë të infrastrukturës dhe shërbimeve sociale. Në mungesë të këtyre shërbimeve themelore, një pjesë e popullsisë së këtyre vendbanimeve kanë lëvizur nëpër zona më të zhvilluara, në kërkim të kushteve më të mira për banim. Niveli i pabarabartë të zhvillimit në Kosovë ka rezultuar në migrim të popullsisë nga vendet rurale në ato urbane dhe nga vendet urbane në vende urbane më të zhvilluara. Lëvizja e vazhdueshme e popullsisë i ka ngarkuar vendet urbane, të cilat si pasojë janë duke u zhvilluar pa ndonjë kontroll të ndërtimit dhe zhvillimit hapësinor. Zonat rurale më pjellore, të vendosura në toka të ulëta, lugina dhe në afërsi të lumenjve dhe

liqeneve vazhdimisht janë duke u zënë me shtëpi dhe oborre, fabrika, rrugë, miniera, shkolla, spitale dhe ndërtesa të tjera, të gjitha të paplanifikuara dhe shpeshherë ndërtime të paligjshme.

Qyteti më i madh është Prishtina, që është edhe kryeqyteti, i cili ka rreth 200.000 banorë. Gjashtë qytete të tjera kanë një popullsi prej 70,000 deri në 180.000 banorë, me Prizrenin në jug, Gjakovën në jugperëndim, Pejën në perëndim, Mitrovicën në veri dhe Gjilanin dhe Ferizajn në juglindje.

PROBLEMET HAPËSINORE

- ngarkesat në komunikacion
- mungesa e transportit publik
- ndërtimet e paligjshme
- vendbanimet joformale
- zhvillim gjatësor (rreth korridoreve të rrugëve)
- degradimi mjedisor
- mungesa e hapësirave të gjelbëruara

PASURITË HAPËSINORE

- diversiteti i peizazheve
- trashëgimia kulturore/natyrore
- trashëgimia industriale
- rrjete dhe stacione hekurudhore të vjetruara
- distanca të shkurta për ecje/ ngasje të biçikletës
- potencial për investime private

PROBLEMET JOHAPËSINORE

- mungesa e shërbimeve arsimore dhe të tjera sociale
- papunësia e lartë
- varfëria në rritje
- kriminaliteti në rritje
- shkalla e lartë e migrimit
- çintegrimi social dhe etnik
- institucione të dobëta
- shoqëria civile e dobët

VLERAT JOHAPËSINORE

- popullsia e re
- skenë urbane e gjallëruar
- forcë punëtore potenciale
- lidhje familjare të forta
- kryqëzim i kulturave të Ballkanit
- shoqëri e përbërë prej feve dhe kulturave të ndryshme
- traditë për tregti

Source: *Re-Creating Kosovo Cities/Rikrijimi i qyteteve të Kosovës*, F. D'hondt, botim i Isocarp 2008
(www.isocarp.net/Data/case_studies/912.pdf)

SHTOJCA 8

FORMATI I PUNËTORIVE TË VIZIONIMIT

Ky format i programit është përdorur për dhjetë punëtorë për vizionim të mbajtura gjatë periudhës 2007 - 2011. Punëtorët e parë është mbajtur në Shkup/IRJM, ndërsa të gjitha të tjerat janë mbajtur në Ohër/IRJM. Udhëtimi zgjatë mesatarisht gjashtë orë dhe autobusët kanë siguruar transport kolektiv për të gjithë pjesëmarrësit, ku edhe u bë socializmi fillestar.

Programi tipik i punëtorisë do të dukej kështu:

- Dita e parë e punës fillon me disa informata rreth programit, metodës së punës dhe rregullat e shtëpisë, siç është ‘respektimi i njëri-tjetrit’, ‘fikja e celularëve apo vendosja e tyre në opsionin pa zë’, ‘ndalimi i pirjes së duhanit gjatë punëtorive’ (që nuk është aq e lehtë në këtë pjesë të botës), ‘laptopët nuk lejohen’ dhe ‘respektimi i afateve kohore’. Ndoshta ‘rregulli’ më i rëndësishëm është dalja nga roli zyrtar apo nga ndonjë rol tjetër përfaqësues, dhe të menduarit dhe vepruarit si pjesëtar i komunitetit me ndjenjë për komunitetin. Sesioni i parë është gjithashtu i dizajnuar që të krijojë një ‘fushë loje të barabartë’ ku asnjëri nuk mund të jetë më i mençur se tjetri, por vetëm më ndryshe.
- Gjatë sesionit të parë të punës, të gjithë pjesëmarrësit duhet të zgjedhin dhe të përshkruajnë ‘vendin e tyre më të pëlqyer që e mbajnë kujtim’, nëse është e mundur ndonjë vend me kujtime pozitive (“vend ku keni luajtur me shokët dhe shoqet, apo ku e keni takuar të dashurin apo të dashurën tuaj të parë”). Kur kjo të përfundojë, të gjithë pjesëmarrësit e tregojnë emrin, e tregojnë tregimin e tyre dhe vendosin notes në vendin e caktuar në hartën e komunës. Facilitatori i përmbajtjes bën një analizë dhe sintezim të vendeve të kujtimeve për sa i përket llojit të vendit (shumica hapësira dhe ndërtesa publike dhe monumente) dhe të pikëve të mbledhura në llojet e caktuara të vendeve. Vendet me më së shumti pikë sugjerohen të caktohen vende të rëndësishme në hartën e kujtimeve, e cila duhet të vizatohet nga një grup i vogël i vullnetarëve. Kjo hartë nuk ka nevojë të përgatitet menjëherë, por ajo duhet të ‘rritet’ gjatë tërë punëtorisë së vizionimit, që kryesisht do të rezultojë në ‘vepër arti të komunitetit’ (shihni edhe shtojcën 10).
- Pas një pushimi për kafe, do të fillojë sesioni i parë i trajnimit nga facilitatori i parë i përmbajtjes. Ky sesion quhet ‘loja e planifikimit’. Pas disa diskutimeve, fillon sesioni i dytë për përzgjedhjen e temave të planifikimit që janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të komunitetit. Për më shumë informata lidhur me përmbajtjen e atyre sesioneve të rëndësishme të trajnimit, shihni shtojcën 9.
- Sesioni i dytë përmbyllet me një konsensus mbi 4 deri në 5 tema kyçe, të cilat do të merren për bazë për ndarjen e grupit të madh prej 35-45 pjesëmarrësve në grupe prej 8-9 veta. Grupet mund të formohen me zgjedhje të rastësishme apo duke i organizuar grupet punuese për të arritur bilanc më të mirë mes individëve me përgatitje dhe aftësi të ndryshme. Në disa raste, mund të jetë e dobishme që të formohet një grup i posaçëm i planifikuesve komunalë dhe i profesionistëve të planifikimit.
- Pas pushimit për drekë, fillon sesioni i tretë gjatë të cilit shpjegohet “çka dhe si” e analizës dhe strategjisë SWOT – dhe përmbyllet me udhëzime praktike për sesionet e para punuese në grupe.
- Katër apo pesë grupet punuese e kryejnë analizën SWOT – përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet – të temës së tyre specifike në një tabelë prej letre, e përcjellë me një prezantim dhe diskutim plenar. Në shumicën e rasteve grupet nuk kanë mundur t’i përkufizojnë strategjitë për përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet, pjesërisht për shkak të kufizimeve kohore, por edhe për shkak se ajo kërkonte ‘të menduar strategjik’ më të avancuar, gjë që nuk është e lehtë për t’u arritur në kësi lloj grupesh të shumëllojshme (për më shumë informata lidhur me analizën SWOT, shihni shtojcën 9).
- **Dita e parë e punës** përmbyllet me një darkë të përbashkët dhe kohë për çlodhje dhe socializim.
- **Dita e dytë e punës** zakonisht fillon me një aktivitet ‘për thyerjen e akullit’ për të aktivizuar grupin, që zakonisht përgatitet dhe udhëhiqet nga një nga animatorët lokalë. Facilitatori i procesit bën një përmbledhje të ditës së mëparshme me përfundimet e nxjerra dhe kërkon nga trajneri që të ofrojë një sesion mbi “fuqinë e vizionimit”, që përmbyllet me udhëzime për sesionin e ardhshëm të grupit punues.
- Gjatë këtij sesioni, grupet e përdorin detyrën e tyre të analizës SWOT për të formuluar synimet dhe objektivat hapësinore për temën e tyre specifike, të përmbledhur në një deklaratë (tematike) të vizionit dhe të vizualizuar me logo dhe moto.


- Të gjitha deklaratat tematike të vizionit prezantohen dhe diskutohen në seancë plenare, në mënyrë që grupet të mund të fillojnë të mendojnë ‘drejt njëri-tjetrit’.
- Nëse kjo detyrë e rëndësishme mund të kryhen gjatë sesionit të paradites, pasdita shpeshherë do të jetë e lirë për të dal në ekskursion (dhe për të mësuar diçka rreth qytetit të Ohrit, i cili është relativisht i planifikuar dhe i menaxhuar mirë). Kjo iu mundëson të tjerëve që të punojnë më tej rreth hartës së kujtimeve dhe t’i integrojnë deklaratat e ndryshme vizionare në një deklaratë të integruar, ndërsa animatorët do të mund të përgatisin hartat bazike për ditën e ardhshme.
- **Dita e tretë e punës** është dita më e rëndësishme dhe më intensive. Pas një sesioni të shkurtër të trajnimit rreth dizajnit të koncepteve dhe vizioneve hapësinore (shihni shtojcën 8), grupet punuese punojnë gjatë tërë ditës rreth vizualizimit dhe projektimit të synimeve, objektivave dhe strategjive të tyre hapësinore, të ndihmuar nga animatorët lokalë dhe facilitatorët e përmbajtjes.
- Kjo ditë e fundit e punës përmbillet me një darke të përbashkët dhe aheng, ku shpeshherë janë të pranishëm edhe disa palë të sapoardhura të interesit për t’i parë rezultatet.
- Dita e fundit e punës, salla e trajnimit shndërrohet në sallë të ekspozitës, ku shfaqen të gjitha vizionet dhe deklaratat për secilin grup tematik. Punimet e grupeve prezantohen një nga një të përcjella me diskutime plenare, ku shpeshherë janë të pranishëm kryetari i komunës dhe palët e tjera të interesit të cilët nganjëherë edhe janë animatorë. Sesioni i fundit është ‘qershia mbi tortë’, ku prezantohet harta e përbashkët e kujtimeve, deklarata e përbashkët e vizionit dhe motoja dhe logo e propozuar.
- Pas miratimit konsensual të komponentëve të përbashkët të vizionit, bëhet një fotografi e të gjithëve ku shfaqet edhe harta e kujtimeve, simbol që tregon se kjo e kaluar tani më ka një të ardhme.

	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4	Dita 5
Para dite	Paketimi dhe nisja	Njoftim Spjegimi dhe rregeullat e “shtëpisë” Sesioni 1 Rrëfime/Harta e memorjes Trajnimi 1 Loja e planifikimit Trajnimi 2 Zgjedhja e temave Udhëzime Sesioni 2 Zgjedhja e grupeve punuese në bazë të temës and grupi për hartën e memories	Thyerja e akullit Trajnimi 4 The Power of Visioning Instructions Session 5 Deklarata e Vizionit/ Motoja/ Logo/Objektivat për çështje tematike Sesioni 6 Prezantimi plenar dhe diskutimi. Formimi i grupit për deklaratën e integruar të vizionit	Thyerja e akullit Trajnimi 5 The Power of Designing Instructions Session 7 Vision Design/Desired Spatial Structure and Concepts per thematic issue Sesioni 8 prezantimi dhe diskutimi paraprak plenar	Thyerja e akullit Sesioni 10 Plenar prezantimi dh diskutimi i - i dizajnit të vizionit në bazë të temës - harta e memories - deklarata e integruar e vizionit Konkludimet dhe arranzhimet për hapat e mëtejme
Pas dite	Udhëtimi dhe shoqërimi Përgatitjet e arritjes	Trajnimi 3 SWOT Analiza dhe strategjitë Udhëzimet Sesioni 3 SWOT analiza në grupe punuese sipas temës Sesioni 4 Prezantimi plenar dhe diskutimi	Pasdite e e lirë Harta e memories dhe deklarata e vizionit të integruar Përgatitja e hartave që vizuelizojnë deklaratat dhe objektivat	Sesioni 9 Dizajnimi i vizionit/ Struktura e dëshiruar hapësinore për çështje tematike - Vazhdimi Përgatitja për prezantimin final Mikpritja e mysafirëve të jashtëm	Paketimi, dreka dhe nisja
Pas dite	Darka	Darka/ shëtitje	Darka/shëtitje	Darka dhe mbrëmje shoqërore	Kthimi në shtëpi

SHTOJCA 9

PUNËTORIA

PJESA 1 – LOJA E PLANIFIKIMIT



Gjatë sesioneve të trajnimit, bazat e planifikimit shqyrtohen në mënyrë joakademike, duke iu shmangur përdorimit të zhargonit të planifikimit që mund t'i vë në siklet pjesëmarrësit që janë plotësisht të ri në fushën e planifikimit. Porosia e parë është se planifikimi thjeshtë përkufizohet si procesi me të cilin shoqëria vendosë rreth gjërave që do të zhvillohen dhe atyre që nuk do të zhvillohen. Duke qenë se nga ato vendime preket e tërë shoqëria, porosia e dytë është se e tërë shoqëria duhet të përfshihet në këtë praktikë të planifikimit. Porosia e tretë është rreth nevojës për zhvillim të 'balancuar'. Kjo i referohet 'zhvillimit të qëndrueshëm' (shih shtojcën 2). Më vonë është shtuar një dimension kulturor për të shprehur diversitetin dhe identitetet e komuniteteve, përmes së cilit zhvillimi i qëndrueshëm formësohet në mënyrë të ndryshme sipas kulturave të vendit dhe ndenjës për vendin. Megjithatë, përvoja e trajnimit ka dëshmuar se zhvillimi 'i balancuar' shpeshherë kuptohet më mirë sesa zhvillimi 'i qëndrueshëm'. Simboli i famshëm Tajjitu 'yin dhe yang' përdoret në filozofinë kineze për të përshkruar anët e kundërta të cilat e plotësojnë njëra-tjetrën dhe të cilat ndërveprojnë me tërësinë, si pjesë e një sistemi dinamik. Gjatë sesionit të trajnimit, simboli përdoret për të ilustruar plotësueshmëritë e nevojshme mes grupeve të ndryshme sociale në komunitet, siç janë gjinitë e ndryshme, moshat e ndryshme, grupet etnike, grupet e interesit, e kështu me radhë. Ai gjithashtu mund të përdoret për të ilustruar bilancin mes natyrës dhe aktiviteteve të njeriut, mes zhvillimit urban dhe atij rural. Të dyja zonat nuk janë të ndara me vijë të drejtë por me një lakore, që simbolizon rëndësinë e kufijve natyral siç janë lumenjtë, izohipsat e terrenit apo pyjet.

Pjesa e simbolit me ngjyrë të zezë mund të interpretohet si pjesa e urbanizuar e komunës (apo e ndonjë zone tjetër të planifikimit), ndërsa pjesa me ngjyrë të bardhë përfaqëson pjesën e paurbanizuar (zonat rurale dhe natyrore). Pika e zezë në pjesën e bardhë mund të shihet si vendbanim kompakt në zonën rurale, ndërsa pika e bardhë në pjesën e zezë simbolizon nevojën për vende të hapura dhe të gjelbëruara në pjesën e urbanizuar. Duke pranuar rëndësinë e thjeshtëzimit të tepërt të realiteteve të ndërlikuara, metafora 'yin dhe yang' iu jep pjesëmarrësve referenca të lehta dhe përkujtuuese gjatë hartimit të deklaratave dhe projekteve vizionare, por edhe facilitatorëve të përmbajtjes dhe animatorëve që të 'vlerësojnë' nivelin e qëndrueshmërisë së ideve dhe vizioneve të propozuara të planifikimit. Disa nga grupet punuese e kanë përdorur simbolin Tajjitu si bazë për logo duke e shprehur kështu moton e vizionit të temës së tyre specifike. Sesioni i parë i trajnimit përmbyllet duke iu referuar udhëzimeve të dobishme për planifikim të qëndrueshëm, siç është 'Agjenda 21' lokale (shihni kapitullin 1) dhe listën kontrolluese praktike 'Try it this way/Provojeni kështu', dhe udhëzimi i Këshillit evropian të planifikuesve hapësinorë për planifikim lokal (shihni www.ceu-ectp.eu).

PËRZGJEDHJA E TEMAVE

Sesioni i dytë i trajnimit është shumë i rëndësishëm për të arritur në një qasje të menduar mirë përmes përzgjedhjes së më së shumti pesë temave kyçe të cilat merren për bazë për ndarjen e grupit të madh në disa grupe të vogla punuese. Temat tradicionale të planifikimit përfshijnë zhvillimin ekonomik (vendet e punës në zona urbane dhe rurale), transportin (lëvizshmërinë dhe

QASJA 3 SHITESORE

Ndërtesat (shtëpitë, fabrikat, zyrat, shitoret, spitalet, teatrot...)

Shfrytëzimi i tokës

Dinamikë e lartë koha e kthimit të investimeve 10-40 vjet

Infrastruktura (rrugër, hekurudhat, kanalet, rrjeti elektrik, kanalizimi...)

Rrjetet

Dinamikë e mesme koha e kthimit të investimeve 20-28 vjet

Deti, liqenet, lumenjtë, pyjet, bjeshkët, livadhet...

Natyra

Dinamikë e ulët koha e kthimit të investimeve >100 vjet

infrastrukturës), hapësirat publike dhe të gjelbëruara, banimi (individual dhe kolektiv), shërbimet sociale (shkollat, spitalet, etj.) dhe trashëgimia kulturore. Megjithatë sesioni i trajnimit paraqet një mënyrë të ndryshme të të menduarit, të quajtur ‘qasja e shtresave hapësinore’, ku zëbërthet realiteti i ndërlikuar i hapësirës dhe kohës në tri shtresa themelore me dinamika të ndryshme për sa i përket ndryshimeve që ndodhin me kalimin e kohës: e ashtu-quajtura shtresa natyrore, shtresa e rrjetit dhe shtresa e përdorimit të tokës. Kjo qasje paraqet një mënyrë ndryshe të planifikimit për secilën shtresë, përfshirë një hierarki ku rrjetet duket të jenë të integruara mirë në shtresën e fundit duke e respektuar natyrën dhe mjedisin, ndërsa shtresa më e lartë duket të jetë e lidhur mirë me ato rrjete që gjinden nën të si dhe të ketë respekt për shtresën e fundit. Ndonëse qasja e shtresave është dëshmuar të jetë mjet shtesë didaktik për planifikim të qëndrueshëm apo të balancuar, përzgjedhja përfundimtare e temave kyçe shpeshherë bëhet me një përzjerje të temave tradicionale dhe ato të shtresuara.

ANALIZA DHE STRATEGJITË SWOT

Matrica SWOT		
	Dobishëm	Dëmshtëm
Brendshëm	Anët e forta	Dobësitë
Jashtëm	Mundësitë	Rreziqet

Kjo është analizë e përparësive, dobësive, mundësive dhe e rreziqeve në rast të ndonjë përpjekjeje për të bërë biznes, apo në rastin tonë për të analizuar ndonjë zonë të planifikimit. Analiza SWOT është pjesë e portretit apo e profilit hapësinor të zonës së planifikimit. Gjatë sesionit të tretë të trajnimit bëhet një prezantim i shkurtër i kësaj teknike për të paraqitur një pasqyrë të gjendjes dhe të trendëve aktuale. Meqë pjesëmarrësit e punëtorëve të vizionimit nuk mund të mbështeten në asnjë të dhënë apo anketim, bëhet e qartë se në këtë fazë analiza SWOT vetëm mund të jetë subjektive dhe indikative, pavarësisht detyrës kolektive të komunitetit të bazuar në kontributet e vlefshme kolektive. Gjithashtu bëhet e qartë se ky ‘skenim i shpejtë’ i komunitetit dhe i asetëve të tija territoriale duhet të verifikohet gjatë procesit të mëtejshëm të planifikimit, përfshirë një rreth me mendime dhe komente pas përkufizimit të situatës së dëshiruar, që shërben si referencë për kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse SWOT. Vëmendje e posaçme i kushtohet natyrës së brendshme të përparësive dhe dobësive, duke shpjeguar se këto i referohen asetëve territoriale dhe problemeve të zonës së planifikimit të cilat komuna ka mundësi t’i shfrytëzojë apo t’i ndalojë, ndërsa mundësitë dhe rreziqet janë kushte të jashtme (dhe shpeshherë të fshehta) të cilat komuna mund t’i hulumtojë apo të mbrohet nga to. Megjithatë, shumica e grupeve punuese vazhdimisht ballafaqohen me këtë dallim të rëndësishëm, gjë që e bën më të vështirë formulimin e objektivave dhe strategjive adekuate. Sesioni i trajnimit gjithashtu paraqet një nga teknikat më të avancuara të analizës SWOT, e cila quhet ‘strategjia SWOT’. Matrica është përgatitur duke i përshtatur dhe krahasuar elementet e analizës SWOT dhe duke i shndërruar ato në strategji hapësinore. Meqë kjo detyrë kërkon hulumtime dhe të menduar shumë më

strategjik, si dhe për shkak të kohës së kufizuar, vetëm disa grupe punuese arrijnë gjer në këtë fazë. Sesioni i trajnimit gjithashtu thekson rolin themelor të projektimit të strukturës hapësinore ekzistuese, që në të vërtetë është vizualizim i indikatorëve të analizës SWOT me skicë territoriale, siç është ndonjë rrugë të rrezikshme transitore, ndonjë zonë e vërshimeve me ndërtime të paligjshme apo fabrikë e braktisur me deponi të mbeturinave toksike. Megjithatë, kjo kërkon një trajnim më të avancuar për të arritur rezultate domethënëse. Sesioni përfundon me udhëzime praktike për kryerjen e detyrave SWOT për secilin grup punues tematik.

PJESA 2 – FUQIA E VIZIONIMIT



Sesioni i katërt i trajnimit shërben për t’i përgatitur pjesëmarrësit për detyrën e rëndësishme: vizionimin e të ardhmes së dëshiruar për komunitetin e tyre. Sesioni fillon me një imazh të statujës së bronzit të bërë nga artisti belg për multimedia Jan Fabre, e quajtur ‘njeriu që i matë retë’. Ajo simbolizon dëshirën për realizimin e ëndrrave, për t’i bërë ëndrrat e matshme. Meqenëse është më lehtë të thuhet sesa të bëhet, kjo nuk duhet të na i ndalojë ëndrrat dhe përpjekjet. Statuja gjithashtu simbolizon planifikuesin apo individin që merr pjesë në planifikim, me kokë në re dhe këmbë në tokë. Imazhi gjithashtu është i lidhur me fjalën e urtë japoneze “Vizioni pa veprim është ëndërrim me sy hapur. Veprimi pa vizion është ankth.” Ajo thekson faktin se njeriu duhet të jetë vizionar, por edhe realist. Sesioni vazhdon me shpjegimin e definicionit dhe objektivave të vizionimit, aktorëve të vizionimit dhe instrumenteve të nevojshme për vizionim. Një pyetje e rëndësishme shqyrtohet më në hollësi: kush do të përfitojë dhe kush do të humb? Nga pjesëmarrësit kërkohet që t’i përgjigjen kësaj pyetjeje për secilën ide dhe propozim të tyre për vizion, për të arritur një shoqëri dhe hapësirë më gjithëpërfshirëse. Sesioni

përmyllet me një citat tjetër të njohur: “When you always do what you’ve always done, you will always get what you’ve always got” – Kur gjithnjë e bëni atë që gjithnjë e keni bërë, gjithnjë do te merrni atë që gjithnjë keni marre.” (Anthony Robbins).

Para se të fillojnë aktivitetet e grupeve punuese, jepen udhëzime për të shndërruar analizën tematike të SWOT në **deklarata të vizionit**, të cilat përmbajnë një moto dhe janë të konceptuara në fotografi ose logo:

- Formuloni 5 deri në 10 synime /objektiva për temën tënde (1 fjali/temë)
- Shpjegoni objektivat dhe përcaktoni sasinë/fazën nëse është e mundur
- Bëni një përmbledhje të të gjitha objektivave në një slogan/moto të shkurtë
- Vizualizoni moton me një logo të thjeshtë.

PROJEKTIMI I VIZIONIT

Sesioni i pestë dhe i fundit i trajnimit përbëhet prej një pakoje të udhëzimeve për t’i njoftuar pjesëmarrësit rreth vizualizimit të deklaratave vizionare me shkrim në harta. Gjatë këtij sesi do të punohet në letrën e tejkushtme të vendosur mbi fotografitë e bëra nga ajri, një për tërë komunën dhe një për qendrën urbane. Të gjitha hartat e të gjitha grupeve përgatiten me minimumin e strukturave hapësinore ekzistuese, siç janë lumenjtë dhe rrugët kryesore. Grupet punuese nuk duhet të shtojnë asnjë strukturë tjetër ekzistuese përveç nëse është e domosdoshme për qëllim të qartësisimit të vizionit. Udhëzimi është që të vizatohen vetëm ato elemente që e shprehin vizionin për shtimin apo ndryshimin e elementeve hapësinore në zonën e planifikimit. Ajo që vizatohet në harta duhet të shpjegohet qartazi në një legjendë, e cila duhet të jetë mjaft e madhe për të qenë e lexueshme nga një largësi prej 5-10m. Ky udhëzim vlen për tërë hartën, i cili edhe i shtynë pjesëmarrësit që të jenë përzgjedhës dhe strategjik për sa i përket dizajnit. Dizajni dhe legjenda duhet të jenë pak a shumë në ngjyra dhe simbole të pranueshme për funksione të ndryshme hapësinore, sipas asaj që është shfaqur në prezantimin e dhënë më poshtë. Notesët me ngjyrë duhet të përdoren për të treguar fazën e planifikimit: disa ide projektohen për një afat më të gjatë, të tjerat mendohet të jenë të arritshme në afate më të shkurta. Kreativiteti për përdorimin e të gjitha llojeve të simboleve dhe shprehjeve grafike vlerësohet shumë, me disa këshilla të dhëna në prezantimin ‘projektimi’. Të gjitha grupet mund të përdorin penë shënuese “marker” dhe spërkatës “spray” me ngjyra të ndryshme, por ata gjithashtu mund të përdorin edhe mjete të tjera si lapsa dhe ngjyra. Piktogramet ‘e vetë-dizajnuara’ gjithashtu mund të jenë shumë të dobishme, me kusht që ato të shpjegohen në legjendë. Një teknikë e rëndësishme është përdorimi i simboleve specifike të konceptuara për të shprehur marrëdhëniet, drejtimet, rritjen (e brendshme apo të jashtme), etj. Në rast se grupi gjen skenarë tjetër për ndonjë objektive, kjo mund të shprehet në një mënyrë më të konceptuar dhe abstrakte. Në fund jepen udhëzime për komentimet dhe kontributet plenare secili grup punues e bën prezantimin e dizajnit të vizionit (shihni faqen e fundit të prezantimit).

DIZAJNIMI I VIZIONIT

Vizuelizoni objektivat tuaja / qëllimet për temë
Vizatoni në hartë vetëm ato elemente që do të “ndryshojnë” zonën e planifikuar

Shpjegoni se çfarë keni vizatuar në një legjendë të qartë të lexueshëm

Shtoni fletëzat për fazën / buxhetin e veprimeve specifike dhe projekteve

MAPPING

Emëroni hartën tuaj (dhe shtoni logon + moton)

Përdorni ngjyra të përshtatshme për funksionet




Përdorni të gjitha llojet e simboleve grafike

- o Vijat për infrastrukturë
 - o Shigjetat për ndërlidhjet
 - o Pikat/rrathët për vende të veçanta ‘brushat’ për zona
 - o Piktograme specifike për funksione të veçanta
- Shtoni përpjesën dhe orientimin

NGJARAT E DIZAJNIMIT

-  Uji / Lumenjtë
-  Gjelbërimi / Natyra / Forest
-  Bujqësia
-  Kultura dhe Turizmi
-  Arsimi / Shërbimet
-  Rrugët
-  Banimi

FAZAT E PLANIFIKIMIT

-  Veprimet afatgjatë (> 20 vjet)
-  Veprimet afat-mesëm (10-20 vjet)
-  Veprimet afat-shkurtë (5-10 vjet)

KOMENTE DHE SYGJERIME

Caktoni raportuesin e grupit

Prezantoni rezultatet në më së shumti 5’

Filloni me rezultatin final; mesazhin kyç

Spjegoni atë hap pas hapi

Drejtojuni grupit

Flisni me zë të lartë dhe qartë

SHTOJCA 10

HAPAT E VIZIONIMIT

Hapi i parë për hartimin e së kaluarës është përmes tregimeve, ku pjesëmarrësit ngjisin nga një notes me kujtimet e tyre më të mira rreth ndonjë vendi specifik në hartë. Ky aktivitet e thyen akullin por edhe i tregon pikat e referimit/monumentet e një harte të kujtimeve, të ndihmuar nga facilitatori i përmbajtjes që propozon grumbullimin e vendeve të kujtimeve personale në pika referimi më kolektive të komunitetit. Hapi i radhës është formimi i një grupi të përzier i cili do të dizajnojë hartën e kujtimeve në bazë të pikave të referimit të komunitetit, më së miri përmes shkallëzimit të atyre pikave të referimit dhe përdorimit të penës “marker” dhe furçave të ngjyrës. Prezantimi i hartës finale të kujtimeve bëhet gjatë sesionit të fundit plenar, i kombinuar me një deklaratë të integruar të vizionit, ku lidhet e kaluara me të ardhmen. Harta e kujtimeve shpesh përdoret si ‘trofe’ kur bëhet fotografia grupore në fund të punëtorisë së vizionimit. Në një rast ‘harta nostalgjike’ është shtypur si afishe (poster) (shihni shtojcën 13). Hapi i parë për ‘portretizimin e të tanishmes’ është përzgjedhja e çështjeve kyçe, përmes së cilave grupi i madh do të ndahet në grupe punuese. Numri i grupeve më të vogla mund të jetë prej 4 deri në 5. Në disa raste, mund të krijohet një grup i posaçëm me profesionistë të planifikimit, dhe të jetë si një lloj grupi i referencës. Hapi i radhës është që 4 – 5 grupet punuese të kryejnë një analizë tematike SWOT. Ky është aktiviteti i parë grupor dhe ‘test i stresit’ për të parë se si funksionon dinamika grupore. Animatorët e jashtëm të planifikimit iu ndihmojnë grupeve me anë të asistencës teknike. Analiza SWOT duhet të prezantohet në 1 ose 2 tabela prej letre, dhe ato duhet të jenë të

qarta për t’u lexuar nga largësia. E njëjta vlen edhe për strategjitë SWOT, gjithnjë nëse grupi mund të arrijë deri në atë pikë. Pas përfundimit të detyrës, tabelat prej letre prezantohen gjatë sesionit plenar nga një raportues i caktuar, që do të përcillen me diskutime grupore. Një nga facilitatorët e procesit do të mbajë rendin, ndërsa facilitatorët e përmbajtjes japin vërejtje kritike për të testuar vlefshmërinë e metodës SWOT.

Hapi i parë për ‘projektimin e së ardhmes’ është formulimi dhe prezantimi i deklaratave të vizionit për secilën temë të zgjedhur, përfshirë një moto dhe një logo. Facilitatorët e përmbajtjes ndërveprojnë për të vlerësuar saktësinë dhe qëndrueshmërinë e synimeve dhe objektivave. Hapi i ardhshëm është vizualizimi i atyre deklaratave të vizionit në një hartë për tërë komunën dhe në një hartë për qendrën urbane. Animatorët e planifikimit ofrojnë asistencë teknike por nuk e kapin lapsin. Paralelisht, një grup do të jetë duke e përgatitur një deklaratë të integruar të vizionit bazuar në deklaratat tematike.

Prezantimi i dizajneve përfundimtare të vizionit tematik bëhet në ditën e fundit, ku shpeshherë janë të pranishëm palë shtesë të interesit, siç mund të jetë kryetari i komunës. Prapë, facilitatorët e përmbajtjes ndërveprojnë për hir të koherencës dhe bilancit, ndërsa facilitatori i procesit ka për detyrë që të kujdeset për kohën e nevojshme për të prezantuar dhe diskutuar deklaratën e integruar të vizionit dhe logon, që shpesh përmbillet me nënshkrimin e deklaratës nga secili grup punues dhe me prezantimin e saj bashkë me hartën e finalizuar të kujtimeve.

E kaluara	E tanishmja	E ardhmja
Tregimet	Përzgjedhja e çështjeve kyçe	Deklaratat tematike të vizionimit
Harta e kujtesës	Analiza tematike SWOT	Dizajnet tematike të vizionimit
Harta e përbashkët e kujtesës	Strategjitë tematike SWOT	Deklarata e përbashkët e vizionimit

SHTOJCA 11

SHOQËRIA CIVILE PËR VIZIONIMIN

Përshtypje nga punëtorja e vizionimit për Ferizajin

FLUTURIMI NË TË ARDHMEN E NJË QYTETI

Ne do të ishim të kënaqur nëse kemi arritë të krijojmë një parafytyrim më shumë për qytetin tonë, do të ishim të lumtur poqese ai parafytyrim nesër bëhet pjesë e identitetit të Ferizajt të ri.

Për tri ditë të qëndrimit në Ohër, mbase kemi qenë banorët e tij më të gëdhshëm. Derisa ohrianët bënin përditshmërinë e tyre të zakonshme buzë liqenit, ne, një grup ferizajasish kishim futuruar në të ardhmen e qytetit tonë duke thurur vizione për të. Duhej të ishim palikane të mirë për të përmbushur atë hapësirë imagjinare që u hap para nesh. E dinim se nuk e kishim lehtë aq më parë se na ndiqnin fjalët ndëshkuese të formës së "pse bash ju po shkoni në Ohër", apo "shih, shih doni të bëheni edhe arkitektë".

Por ne e thymen akullin, e hapëm librin e kujtimeve për qytetin, skutave të harrësish kujtoheshin parqet, bazenet e dikurshme, Ura e hekurit. Filluam t'i identifikojmë shenjat dalluese, bifurkacionin e lumit e vendosëm në qendër, pas degëzimeve të tij e ndiqnim kryqëzimin e rrugëve për të parapare edhe një terminal. Fjalët produktiv, ekologjik, mobil, modern, margaritar, i artë, i gjelbërt... mbizotëronin mendimet tona duke dashur të krijojmë identitetin e tij. Vizionet tona i përngjani mjegullës së liqenit në mëngjeset e hershme. Vinin të vullshme, emocionale dhe ndonjëherë naive.

Nga larg çfarë nuk i bënim qytetit, e zgjeruam, e pastruam, i ndërtuam lagje të reja, e bënim me liqe, me zona industriale, qendër rekreative, sportive dhe kulturore e shpallnim port malesh, urë të shumë brigjeve, e futim hekurudhën nën tokë me një fjalë i krijuam frymëmarrje të re urbane...

Nëpër harta gjithsecili prej nesh viziononte nga një pjesë të së ardhmes. Vështrimi hapësiror për qytetin duhej të përmbiljej në disa vija që nuk i bënim drejt. Si të vonuar në kohë dhe hapësirë përjetonim ndjenjën e krijimit të hartave, të qyteteve, diçka tepër futuriste. Në të vertetë ne ishim bërë pjesë e një planifikimi, pjesë e një koncepti bashkëkohor për të qenë qytetari



pjesëmarrës i ndërtimit dhe planifikimit të qytetit të tij. "Bashkë bëjmë qytete më të mira" është motoja e këtij koncepti e promovuar nga programi i UN-HABITAT-it.

Idë pas ideje, formësoheshin dëshirat tona për qytetin. Si qytet në mes dy kryeqyteteve atij i dëshironim të kishte një sharm tjetëriloj prej këtyre që e ka sot, donim që ai të ishte embleme e artë në Fushën e Kosovës. Ashtu si të dashuruarit që mundohen të vizatojnë portretin e personit të dashur, ne bëmë portretin e qytetit tonë. Kishte ditë që ishim larg tij, por me t'u kthyer na kapluan ndjenjat e një pendese se mos e kishim tepruar me vizionet tona.

Qyteti na u shfaq i ngrysur si me një qortim se ne i kishim "pre" robe të reja shumë të gjëra. Në të vertetë edhe ai neve na u duk si tepër i pluhurosor, i ngushtë dhe i zhurmshëm. Pas disa dite i bëmë publike vizionet tona, ato mbuluan qytetin si re të panjohura. Dikujt nuk i bënë përshtypje, disa të tjerë filluan të thonë "mirë paskeni bërë, ky qytet duhet të ketë identitet". Ne, modest, pak me fajin se pse e morëm

këtë përgjegjësi vazhdojmë të jemi pjesë e hartimit të planit zhvillimor komunal dhe urban, të gatshëm të përcjellim ndjenjat e qytetarëve për një qytet me bashkëkohor.

Retushimet mbase nuk janë të dëshirueshme, por rimodelimet gjithse si janë të imponueshme. U bindëm se qyteti jonë ka nevojë për një rimodelim, për një këndvështrim dhe trajtim tjetër, për një vizion tjetër.

Ne do të ishim të kënaqur nëse kemi arritur të krijojmë një parafytyrim më shumë për qytetin tonë, do të ishim të lumtur poqese ai parafytyrim nesër bëhet pjesë e identitetit të Ferizajt të ri.

Afrim Demiri

Anëtar i KJSHC (Këshilli Joformal i Shoqërisë Civile)

Burimi: MuSPP Buletini No. 3-5, Qershor/Tetor 2007, Shkurt 2008

(www.unhabitat-kosovo.org)

Mësimet e nxjerra gjatë punëtorisë së vizionimit për zonën "AST" në Pejë

Pjesëmarrësit në këtë punëtori kishin një qasje serioze ndaj çështjes së diskutuar dhe mund të themi pa hezitim se janë arritur rezultate të mira të cilat mund të përdoren në interes të komunës. A do të përdoret apo jo kjo përvojë e mirë dhe rezultatet nga punëtorja, para se gjithash varet nga institucionet kompetente komunale. Le të shohim!

Sipas mendimit tim, mësimet e nxjerra prej kësaj punëtorie përfshijnë:

- Të kuptuarit se puna në grupe jep rezultate të qëndrueshme
- Domosdoshmëria e pjesëmarrjes së spektrit të gjerë të pjesëmarrësve të angazhuar në çështjen përkatëse
- Rëndësia e të qenit tolerant në grupet punuese
- Pranimi i argumenteve si vlera e jo si akuzë ose kritikë
- Të gjithë pjesëmarrësit në punëtori ishin të barabartë
- Ne kemi mësuar si të organizojmë një punëtori
- Rëndësia e disiplinës, mirësjelljes dhe qasjes serioze të organizatorëve
- Roli i rëndësishëm i logjistikës dhe pajtimeve vizuale në një punëtori të suksesshme
- Niveli profesional i moderimit, drejtimit dhe përshtypja e mirë lidhur me bashkëpunimin me organizatorët e punëtorisë

Reshat Nurboja,
drejtor i OJQ-së Lidhja Qytetare e Kosovës në Pejë



SHTOJCA 12

VËNIA E VIZIONIMIT NË VEPRIM

NË FOKUS

VËNIA E VIZIONIT NË VEPRIM

"Vënia e ideve në veprim" ishte motoja e Forumit Urban Botëror të fundit (Vancouver, 2006). Me një varg të Punëtoreve për vizionim (stihbuletin e fundit Fokus) ne jemi mundar që ta avancojmë bashkëpunimin e vizioneve dhe ideve planifikuese të mira. Prej ndër-rave të largëta në masat e menjëher-shme për t'i përmirësuar kushtet jetësore të kosovarëve në gjatë të qytetit e rangut të dytë për nga madhësia. Këto vizione dhe ide duhet të shndërrohen në plane të mirëfillta për zhvillimin komunal dhe urban, të cilat janë duke u hartuar aktualisht (apo tashmë të miratuara si në rastin e Pejës). Për të dëshmuar se realizimi i vizioneve afatgjata mund të fillojë me veprime të vogla, në i kemi nisur "projektet demonstruese" (demo projektet). Demo projektet janë projekte të vogla të cilat e paraqesin misionin e MUSPP, i cili është "vënia e ideve në veprim". Prandaj, demo projektet duhet të jenë të orientuara kah veprimet, me rezultate të prekshme, pothuaj të "dukshme", që duhet të arrihen para përfundimit të fazës së parë të MUSPP-it në prill të vitit 2007.

Në kuadër të programit të tij 2005-2008, të financuar nga Sida, MUSPP posedon një buxhet të vogël prej 100,000 USD për t'i bashkëfinancuar demo projektet. Meqë MUSPP është aktiv në pesë komuna plus në pjesë jugore dhe veriore të Mitrovicës, ai e ka për qëllim që të ketë së paku shtatë demo projekte. Kjo do të thotë se bashkëfinancimi mesatar në dispozicion është i kufizuar në 10,000 euro për projekt, por një prej kritereve ka qenë kërkimi i bashkëfinancimit nga ana e komunës aplikuese.

Po ashtu, mund të angazhohen partnerë tjerë (publik dhe privat) për ta rritur buxhetin, ndikimin dhe bashkëpunimin e projektit. Kriteret tjerë dhe më cilësorë të përdorura për përzgjedhjen e demo projektëve kanë theksuar se projektet duhet të jenë të vogla, por strategjike (në kohë dhe hapësirë), kreativ dhe inovativ (jo thjeshtë një projekt i vjetër i "rikluar"), i zbatueshëm (i realizueshëm për disa muaj) dhe së fundi pjesëmarrës dhe fuqizues (duke e angazhuar shoqërinë civile dhe palët tjera të interesuara).

Punëtoritë për vizionim kanë ofruar mundësi të shkëlqyeshme për identifikimin e demo projekteve të mundshme në secilën komunë. Po ashtu, veprimtaritë tjera në procesin e planifikimit të Planit për zhvillimin komunal dhe urban kanë shërbyer si burim i ideve për projekte, në kuadër të procesit komunal për vizionin dhe planifikimin.

Një komisioni përzgjedhës i posaçëm, i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Sida-s, i ka përzgjedhur shtatë demo projektet e mëposhtme:

Pejë: Dizajni i rrugës afër Stadiumit të Futbollit

Ferizaj: Konkursi për dizajnin hapësinor të Qendrës Mobile

Gjilan: Rregullimi i Varrezave të Qytetit

Gjakovë: Përmirësimi i Parkut të Qytetit

Prizren: Përmirësimi i oborrit të shkollës në qendër të qytetit

Mitrovicë (jug): Rreth-rrrotullimet në qendër të qytetit

Mitrovicë (veri): Kalesat prë këmbësorë në qendër të qytetit

Në këtë Buletin, ju mund të lexoni më shumë për gjendjen lidhur me demo projektet në Pejë, Gjilan, Prizren dhe Mitrovicë (jug dhe veri). Ferizaji dhe Gjakova do të prezentohen në numrin e ardhshëm.

Pas një fillimi paksa me ngurime, tani mund ta shohim qartë interesin për dhe prej demo projekteve. Në shumicën e rasteve ka qenë e nevojshme që të "zbërthehen" propozimet, në mënyrë që të inkuorporohet një gasje e planifikimit, duke e inkuadruar projektin në një vizion dhe kontakt me të madh, duke iu kthyer rënjtë të problemit dhe identifikimit të alternativave të mundshme (më të mira) nga ajo që është propozuar, si dhe më e rëndësishmja është angazhimi i të gjitha palëve të interesu

ara dhe të qytetarëve. Po ashtu, është dëshur kohë për t'u marrë me mekanizimin e bashkëfinancimit, por tani kjo është zgjidhur dhe shpeshojmë të ecim tutje me realizimin. Në rastin e Mitrovicës, të dyja pjesët (veri dhe jug) ishin aq të etura për realizimin e projekt-propozimeve të tyre, sa që tashmë e kanë zbatuar fazën e parë të projektit pa bashkëfinancimin tonë. Ju ftojme ta shihni rreth-rrrotullimin e ri afër tregut të gjelbërt në qendër të pjesës jugore të Mitrovicës, si dhe rampat në qendër të pjesës veriore të Mitrovicës për këmbësorë dhe për persona me paafatësi që përdorin karroce invalidësh. Kjo tregon se ekziston një interesim i vërtetë për projekte të vogla të cilat e përmirësojnë cilësinë e jetës urbane.

Sfida kryesore është krijimi dhe zhvillimi i proceseve dhe kulturave të planifikimit lokal të cilat do të jenë në gjendje të punojnë në të njëjtën kohë në vizione dhe në projekte. Ekipet duhet të punojnë në dokumentet e planifikimit si Planet zhvillimore komunale dhe urbane në njërin anë, me një vizion të mirëfillt afatgjatë për ardhmërinë dhe strukturën e dëshiruar hapësinore të komunës, si dhe në të njëjtën kohë të nisin projektet strategjike afatshkurta (dhe afatgjata) për t'i paraqitur dobëti e vizioneve dhe planeve. Pasi këto të dyja mund të kryehen vetëm me maturi nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet qeverive lokale, institucioneve tjera, komunitetit të biznesit dhe së fundi shoqërisë civile, ne dëshirojmë t'ju referojmë tek Konferenca e paradokshme botërore e planifikimit e ISOCARP-it, e mbajtur në Antverp, Belgjikë, 19-23 shtator 2007, me temën "Dialogjet urbane - Mënyrat bashkëprodhuese të ndërlikueshëm të vizioneve dhe projekteve urbane strategjike". Pas realizimit të suksesshëm, MUSPP dhe partnerët e tij do të jenë në gjendje të "demonstrojnë" se si të vëmë në praktikë ky "IALOG urban ndërmjet planeve, projekteve dhe njerëzve.

Ekipi i MuSPP-it



Burimi: MuSPP Buletini Tetor 2007

"Vizioni pa veprim është thjesht një ëndërr. Veprimi pa vizion është vetëm sa për të thënë. Vizioni me veprim mund të ndryshojë botën"

Joel A. Barker

PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE

PËRMIRËSIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËRMES PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

Si organizëm i gjallë i cili duhet të rritet krahas nevojave të banorëve të tij, qyteti ose një pjesë e qytetit, kërkon mekanizma dhe mjete të cilat mundësojnë kontrollin e zhvillimit dhe zgjerimit të tij. Këta mekanizma duhet të kenë gjithmonë në konsideratë zhvillimin socio-ekonomik të vet zonës dhe cilësinë e jetës së banorëve të qytetit.

Sipas Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor të Kosovës, këta mekanizma janë Plani Zhvillimor Komunal (PZH), Plani Zhvillimor Urban (PZHU) dhe Plani Rregullues Urban (PRU), në përputhje me Planin Nacional Hapësinor (Plani Hapësinor i Kosovës). Implementimi i PZH/PZHU është hapi i fundit i procesit të planifikimit strategjik, në të cilën strategjitë e planit, politikat, prioritetet dhe vizioni vihen në veprim. Kjo, në shumicën e rasteve, realizohet përmes Projekteve Investive Kapitale (PIK), të identifikuara nga vizioni i PZH/PZHU-se. Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal - faza 2 (MuSPP2), UN-HABITAT-i në Kosovë, në bashkëfinancim me komunat, nëpër qytetet e ndryshme të Kosovës, kanë zhvilluar PIK të ndryshëm, duke adresuar çështje dhe tema të ndryshme, por gjithmonë në përputhje me PZH dhe PZHU. Lista në vijim prezanton temat e PIK të cilat janë në zhvillim e sipër:

Tema	Qyteti
Zhvillimi i Infrastrukturasë shkollore	Mitrovica, Junik
Menaxhimi i lëvizshmërisë dhe transportit	Mitrovica, Junik, Prizren, Hani i Elezit
Mbrojtja e vlerave Historike dhe të trashëgimisë	Prizren
Shndërrimi i zonës industriale në hapësirë publike	Hani i Elezit
Përmirësimi i hapësirave pranë ujërave dhe hapësirave publike.	Peja, Mitrovica
Menaxhimi dhe vlerësimi i rreziqeve dhe katastrofave natyrore	Ferizaj, Gjilan
Revitalizimi i degëve të lumenjve dhe korridoreve të gjelbra	Mitrovica

Ashtu siç paraqet lista e sipërme, PIK-ët në qytetet e Kosovës janë të zgjedhura kryesisht në hapësirat publike (sheshet, përgjatë ujërave, vijat e lëvizshmërisë, peizazhet, vijat transportuese dhe zonat e trashëgimisë) ose hapësirat e shfrytëzuara nga publiku (oborret shkollore, vlerësim i katastrofave dhe rreziqeve, shndërrimi i zonave industriale në sfera publike, korridore të gjelbra dhe brigje të lumenjve). Qëllimi kryesor i kësaj është të revitalizojë pjesë të zonës urbane të shfrytëzuara nga banorët, duke bërë rrugët dhe hapësirat publike më të gjalla dhe të përshatshme për këmbësorët. Megjithatë, tendenca e zhvillimit të PIK nuk është që vetëm të përmirësojë, revitalizojë ose mbrojë zonën e qytetit, por të angazhojë partnerët komunal në metoda të reja të planifikimit gjithpërfshirës, pjesëmarrjen aktive të komunitetit, ndërtimin e kapaciteteve të stafit komunal që të zhvillojnë

dhe menaxhojnë në mënyrë të drejtë PIK në të ardhmen. Moto e të gjitha PIK është "fillimisht mendojme në njeriun" dhe është i bazuar në parime të thjeshta:

- Përdorimin e hapësirës së jashtme publike si katalizatorë për zhvillimin e zonës së qytetit.
- Ndërtimin e lidhjes ndërmjet lagjeve, hapësirave përgjatë ujit, dhe veçoritë peisazhore
- Ndërtimin/zhvillimin e përparësive ekzistuese të zonës, si p.sh ripërdorimin e përmirësuar të strukturave të trashëgimisë dhe theksimin e kontekstit natyral gjeografik të qytetit



Figura 1: PIK-u i Hani të Elezit



Figura 2: PIK-u në Ferizaj

(elementi socio-kulturor)

- Shndërrimin e të jetuarit në qytet sa më tërheqëse, duke filluar me përmirësimin e rrugëve, dhe inkurajimin e investimeve private (zhvillimin e shfrytëzimit të tokës dhe menaxhimin)
- Gjenerimin e tregëtisë dhe aktiviteteve komerciale brenda lagjeve të llojllojshme (rritja ekonomike)
- Trotuaret më të gjera dhe më të sigurta
- Më shumë drunj me bulevardet të gjelbra të vazhdueshme
- Qasje e plotë për të gjitha moshat dhe grupe të shfrytëzimit (p.sh. Implementimin e kodit urban të Brejlit si dhe standardeve tjera për qasje)
- Shtylla (poste) më të mira të ndriçimit
- Përmirësimi i rrugëve duke përfshirë trajtim të veçantë në nyjëllore
- Përforsimin e karakterit ekzistues me përdorimin e temave të dizajnit, dhe pasurimin e hapësirave publike me art publik
- Të përfshirë në listën të PIK të hulumtuar dhe zhvilluar në qytete të ndryshme Kosovare, aktualisht tre prej tyre janë zhvilluar në projekt propozime të detajuara, kurse një prej tyre është në fazën e punëve ndërtimore. Ato janë kryesisht projekte që kanë të bëjnë me zhvillimin e punëve të përmirësimit, të cilat zhvillohen në ndërthurje me punë ndërtimore tjera në rrugë. shih fq 7

Burimi: Buletini i MuSPP Tetor 2010

"Ju duhet të mendoni për gjërat e mëdha, duke i bërë gjërat e vogla, në mënyrë që të gjitha gjërat e vogla të zhvillohen në drejtimin e duhur."

Alvin Toffler



SHTOJCA 13

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË 2

JUNIKU: FSHAT MALOR UNIK ME AMBICIE TË LARTA

Juniku, fshat malor në perëndim të Kosovës, i njohur për kullat e tij dhe bjeshkën më të lartë në Kosovë (Gjeravicë, 2656m), zyrtarisht u bë komunë në vitin 2007. Juniku menjëherë filloi procesin e planifikimit, me mbështetjen e Trashëgimisë kulturore pa kufij, përmes hartimit të Planit për mbrojtje dhe zhvillim. Pas këtij projekti, nga 17 deri më 22 tetor 2007 u mbajt një punëtori pesëditore për vizionim e cila është mbështetur nga UN-Habitati. Kjo punëtori kishte për qëllim fillimin e procesit të hartimit të Planit zhvillimor komunal. Grupi nga Juniku ishte një ndër grupet më të përkushtuara dhe më të suksesshme nga grupet e komunitetit, i cili përgatiti një deklaratë ambicioze të vizionit (shihni ilustrimin më poshtë në një fotografi grupore). Deklarata e vizionit ishte mbështetur me një hartë të kujtimeve, e cila pak më vonë u publikua si afishe. Prezantimi publik në një nga kullat - e restauruara nga Trashëgimia kulturore pa kufij e cila tani përdoret si vend unik për fjetje dhe mëngjes – gjithashtu ishte shprehje e besimit të madh në një të ardhme më të mirë për një fshat që ka vuajtur shumë gjatë konfliktit të vitit 1998-1999. Punëtorja e vizionimit rezultoi në kontribute të vlefshme për planet hapësinore komunale dhe urbane. Në gusht të vitit 2008, me mbështetje të Trashëgimisë kulturore pa kufij, Juniku vendosi që të hartoj Planin zhvillimor urban si dhe Planin Rregullues Urban për qendrën e Junikut. Më vonë, Plani zhvillimor komunal do t'i plotësonte të dyja këto plane. Trashëgimia Kulturore pa Kufij e mbështeti komunën për fuqizimin e rolit të institucioneve për integrimin e trashëgimisë kulturore në procesin e planifikimit hapësinor në Kosovë si dhe për trajtimin e trashëgimisë kulturore si mundësi zhvillimore për shoqërinë. Plani zhvillimor komunal i Junikut do të plotësonte përqendrimin në trashëgiminë kulturore me fokus në trashëgiminë natyrore të jashtëzakonshme. Plani zhvillimor komunal i Junikut është i pari në Kosovë i hartuar 'brenda vendit', nga planifikuesit komunalë me mbështetje dhe asistencë teknike të UN-Habitatit/Programit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal. Procesi ka përfshirë konsultime të shumta publike, punëtori për komunitetin dhe vizita studimore nëpër komuna të tjera. Ai gjithashtu ka shpjerë në themelimin e një OJQ-je të grave si element i zhvillimit ekonomik të barabartë gjinor. Nga të gjitha planet zhvillimore komunale, Plani zhvillimor komunal i Junikut më së miri e pasqyron frymën dhe rezultatet e punëtorisë për vizionim, dhe ndoshta përfaqëson një nga proceset planifikuese me pjesëmarrjen më të lartë në Kosovë deri më tani. Juniku ka qenë një nga rastet më të mira që janë prezantuar në 'konferencën për vizionim' të mbajtur në Prishtinë më 9 nëntor 2010, pas një prezantimi të suksesshëm të shembullit në konferencën e pesëmbëdhjetë 'REAL CORP Conference' që është mbajtur në Vjenë (Austri) më 18-20 maj 2010. Siç është rasti me shembullin më të mirë të 'Spoor Noord' (shih

Shtojcën 4), Juniku nuk do të ishte shembull i mirë pa u vënë në veprim planifikimi. Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal bashkëfinancoi dhe e ndihmoi teknikisht realizimin e një projekti të investimeve kapitale për përmirësimin e oborrit të shkollës i cili është i qasshëm për qytetarët, ndërsa Trashëgimia Kulturore pa Kufij mbanë rekord të gjatë për restaurimin dhe rikthimin e vlerës së trashëgimisë kulturore dhe të kullave në veçanti. Trashëgimia Kulturore pa Kufij dhe UN-Habitati çdo vit e bashkëorganizojnë një turne kulturor te quajtur 'Tour de Culture' – turne rekreativ dhe kulturor i biçikletave gjatë 'Javës Evropiane për Lëvizshmëri' dhe 'Ditëve Evropiane të Trashëgimisë' – ku në vitin 2008 Juniku ka qenë vend ndalesë për drekë dhe në vitin 2009 ka qenë vendi i fillimit të turnirit (shihni afishen). Kjo e vë Junikun në një perspektivë rajonale dhe i vetëdijëson të gjithë qytetarët nga e mbarë Kosova rreth potencialit turistik unik që e ka Juniku dhe vendet për rreth. Pavarësisht numrit të kufizuar të popullsisë dhe burimeve njerëzore dhe financiare gjithashtu të kufizuara, Juniku u bë palë aktive e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit rajonal në pjesën perëndimore të Kosovës (Dukagjin), p.sh. përmes pjesëmarrjes në një takim rajonal të kryetarëve të komunave të Dukagjinit të organizuar nga UN-Habitati në korrik të vitit 2008, në kullën e Drenocit, të restauruar nga Trashëgimi Kulturore pa Kufij.

Mësimet e nxjerra

- Komuniteti i përkushtuar mund të shënojë progres të madh brenda një kohe të shkurtë.
- Vizioni i qartë i komunitetit i jep drejtim dhe substancë procesit formal të planifikimit.
- Planifikimi "ne shtëpi" nga vete stafi komunal krijon ose mbanë pronësi lokale.
- Kultura e pjesëmarrjes mundëson planifikim dhe veprime më të mira.
- Përdorimi i qëndrueshëm i trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillimin e komunitetit është i mundur.




SHTOJCA 14

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË 3

MITROVICA: QYTET I NDARË ME VIZION TË PËRBASHKËT

Qyteti i Mitrovicës ka qenë i zhvilluar me miniera të arit, argjendit, plumbit dhe zinkut. Që nga ndërprerja e aktiviteteve të industrisë së minierave, qyteti është ballafaquar me probleme ekonomike, fizike, mjedisore dhe sociale. Qytetin e ndan lumi Ibër mbi të cilin gjendet ura e Mitrovicës, ikonë që e simbolizon ndarjen e Kosovës. Shumë organizata dhe autoritete janë munduar që të krijojnë projekte shumetnike për të rihvilluar qytetin, por Mitrovica është ende e ndarë në vija etnike ku serbët nga Kosova janë kryesisht të vendosur në pjesën veriore dhe shqiptarët në pjesën jugore, dhe në grupe të tjera etnike si romët dhe boshnjakët të cilët jetojnë në të dyja anët e qytetës. Ndoshta në asnjë vend tjetër në Evropë nuk ekziston një lloj i tillë i kombinimit të pasojave të industrializimit, ndotjes dhe tensioneve etnike në shkallën që e karakterizon këtë pjesë. Organizata të ndryshme kanë bërë përpjekje për të përmirësuar gjendjen e rëndë por një periudhë e pasigurisë prej më shumë se një dekadë ka rezultuar në nivele të ulëta të investimeve dhe mungesë të vizionit për të ardhmen e qytetit. Por, përkundër të gjitha këtyre, Mitrovica ka qenë ajo e cila e ka inspiruar Programin e UN-Habitatit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal për të iniciuar punëtorinë e parë të vizionimit nga komuniteti, në fillim të vitit 2007. Ajo punëtori ishte bashkëorganizuar nga organizatat e përkushtuara të shoqërisë civile që i përfaqësonin shqiptarët dhe serbët e Kosovës. Punëtorja kishte për qëllim që të inicioje planifikimin komunal dhe urban dhe të ndihmonte në zgjidhjen e çështjeve të planifikimit që i prekin të dy pjesët e qytetit dhe të dy komunitetet. Synimi i punëtorisë së vizionimit ishte zhvillimi i një vizioni ndërkomunitar për një qytet, edhe nëse dy organet e ndryshme administrative (komunat) do të duhej ta menaxhonin atë. Organizimi shërbeu për qëllimin e dyfishtë të fuqizimit të shoqërisë civile dhe të medieve lokale dhe përmirësimit të dialogut të tyre me planifikuesi profesionistë, duke e fuqizuar dialogun dhe bashkëpunimin mes veriut dhe jugut. Të dyja komunitetet dolën me një moto të përbashkët, ku u përmblodhën elementet kyçe të vizionit të tyre të përbashkët (shihni foton në fillim të faqes). Megjithatë, për shkak të kontekstit politik, u deshëm më shumë se gjashtë muaj për të përgatitur një raport të punëtorisë (shihni faqen e mëparshme) dhe për të organizuar një prezantim publik të rezultateve të vizionimit. Më 4 maj të vitit 2009, Asambleja komunale e Mitrovicës miratoi Planet zhvillimore komunale dhe urbane, të përgatitura nga konsulentët e Projektit Lin të vendosur në Kosovë dhe projektin Metron nga Zvicra. Në konferencën Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës, përfaqësuesi nga komuna e Mitrovicës demonstroi se të dyja planet i pranuan shu-



micën e propozimeve për vizion nga punëtorja për vizionim, ndërsa projektet strategjike (prej të cilave disa ishin të bashkëfinancuara nga Programi i UN-Habitatit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal) tashmë ishin duke u zbatuar me sukses (shihni një nga dy projektet e investimeve kapitale të paraqitura në katror). Megjithatë, për shkak të problemeve institucionale në veri, shumë pak është bërë për sa i përket vazhdimësisë, për shkak se ajo pjesë nuk e njeht legjitimitetin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban. Mbetet për t'u parë nëse dhe kur do të krijohet komuna e re e 'Mitrovicës së veriut' dhe nëse ajo do t'i zhvillojë planet e veta të zhvillimit komunal dhe urban, dhe nëse po kur do të zhvillojë ato. Vetëm mund të shpresohet që vizioni i përbashkët ndërkomunitar do të përdoret si kontribut dhe të merret për bazë.

Mësimet e nxjerra

- Vizionimi i komunitetit mund t'i tejkalojë ndarjet etnike.
- Institucionet e duhura (të planifikimit) duhet ta qojnë vizionimin përpara.
- Projektet strategjike janë kyçe për realizimin e planifikimit.
- Ndjenja për vendin është kyçe për zhvillimin e komunitetit.

Të martën, më 25 janar 2011, kryetari i Mitrovicës dhe Kryesuesi i Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal shkëmbyen 'Marrëveshjen e Bashkëpunimit për zbatimin e Projektit të Investimit Kapital' për Mitrovicën, i quajtur "Korridori i gjelbër i lumit Lushta". Korridoret e gjelbra përgjatë lumenjve janë konceptet më domethënëse për përmirësimin e mjedisit të jetesës, andaj janë pjesë e Planit Zhvillimor Komunal. Lumi Lushta kalon nëpër qendrën e qytetit në jug të lumit Ibër dhe lidhjet e tij me rrugën urbane dhe qendrën e qytetit janë vështirë për t'u përdorur. Qëllimi

i këtij projekti të investimit kapital është dhënia e një kontributi të madh për krijimin e korridorit të gjelbër të lumit Lushta; duke e fuqizuar funksionin e tij si korridor transporti jomotorik përmes përmirësimit të ndërlidhjes së tij me rrugën urbane dhe rrjetin e shëtitoreve. Me përmirësimin e shëtitores, ajo do të shërbejë si lidhje e rëndësishme për transportin jomotorik, që ofron qasje të sigurt dhe të shpejt në qendër për banorët e lagjeve jugore dhe për ata që jetojnë në qendër për t'u lidhur me vendin pastoral gjysmë rural rreth Lushtës në jug si dhe me fshatrat përtej. Ndërhyrja më e madhe do të bëhet në udhëkryqin Teuta/Selac në qendër të qytetit, ku lumi Lushta zhduket nën rrugën qendrore. Ndërhyrjet e tjera përfshijnë përmirësimin e lidhjeve të rrjetit të shëtitoreve të qytetit

në fundin jugor të shtratit të lumit, largimi i pengesave në shtratin e lumit, krijimin e një areali të ri publik me karakteristika të ndryshme urbane. Projekti është zhvilluar dhe përgatitur bashkërisht me komunën në bashkëpunim të afërt me banorët dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat gjithashtu i përfaqësonin personat me nevoja të veçanta dhe shërbimet komunale, gjatë konsultimeve dhe punëtorive të mbajtura. Projekti “Korridor i gjelbër i lumit Lushta” do të zbatohet me bashkëfinancim nga Komuna e Mitrovicës dhe Programi i UN-Habitatit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal, faza e dytë, të financuar nga Agjencia suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim, Sida.

SHTOJCA 15

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË 4

HANI I ELEZIT – VIZIONIMI SI NDËRMJETËSIM DHE SHTYTJE

Punëtorja e vizionimit u organizua në kohën e duhur për Hanin e Elezit, shkurt pasi ky vend mori statusin e komunës së re. Një grup dinamik i komunitetit e zhvilloi një vizion ambicioz për t'i bashkërenduar tri trendet e zhvillimit të cilat kishin potencial të ishin kontradiktore: qytezë që do të zhvillohej në mjedis natyror, tradita e vendit për industrinë e çimentos dhe mundësitë e reja si vend kufitar në korridorin mes dy kryeqyteteve, atë të Prishtinës dhe Shkupit. Është e qartë se përfshirja e nivelit qendror kërkohet për sfidën e fundit të planifikimit, por komuniteti e ofroi një vizion të shëndoshë. Për sfidën e dytë, megjithatë, punëtorja e vizionimit për herë të parë ofroi një platformë për dialog mes kryeshefit të fabrikës së çimentos, e cila është një ndotëse e madhe, dhe komunitetit, dhe që është zhvilluar më tej përmes procesit të mëtejshëm të planifikimit ('brenda vendit') dhe në projekte strategjike të prioritizuara (shihni artikullin në buletin e Programit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal 01/2011).

Mësimet e nxjerra

- Komuniteti lokal i përkushtuar mund të merr udhëheqjen e sfidave të planifikimit të cilat shtrihen përtej kompetencave lokale.
- Vizioni i qartë i komunitetit i jep drejtim dhe substancë procesit të planifikimit 'brenda vendit'.
- Kultura e pjesëmarrjes mundëson planifikim dhe veprime më të mira.
- Planifikimi mund të funksionojë vetëm kur të gjitha palët e interesit janë të përfshira.



SHTOJCA 16

“CHARRETTE” PUNËTORIA PËR PLANIFIKIM: VIZIONIMI I AVANCUAR

Fjala franceze charrette do të thotë ‘qerre’ dhe shpeshherë përdoret për të përshkruar përpjekjet përfundimtare dhe intensive të punës së studentëve të artit dhe arkitekturës për të dorëzuar projektet brenda afatit. Përdorimi i këtij termi thuhet se ka prejardhjen nga shekulli i nëntëmbëdhjetë nga ‘École des Beaux Arts’ në Paris, kur mbikëqyrësit qarkullonin një qerre, apo charrette, për t’i mbledhur vizatimet përfundimtare derisa studentët me furi i bënin hollësitë përfunduese punimeve të tyre. E ashtuquajtura charrette e planifikimit është organizim bashkëpunues i cili zgjatë katër deri në shtatë ditë, me sesione të takimeve dhe projekteve të cilat tradicionalisht zgjasnin me muaj të tërë deri në përfundim. Ky shkurtim i kohës mundëson zgjidhje kreative të problemeve përmes përsheptimit të vendim-marrjes dhe zvogëlimit të taktikave jokonstruktive të negociimit. Kjo gjithashtu i inkurajon personat që t’i lënë anash mënyrat e tyre të zakonshme të punës dhe të mendojnë përtej shtojcës. Synimi i charrette është prodhimi i një plani të zbatueshëm që përfiton nga mbështetja e të gjitha palëve të interesit përmes zbatimit të tij. Një ekip i planifikimit charrette prej disiplinave të ndryshme, i përbërë prej një vargu të gjerë të konsulentëve të planifikimit, dizajnerëve dhe stafit sponsorizues, e prodhon këtë plan bashkërisht me komunitetin dhe palët kyçe të interesit. Këto takime mbahen në një studio charrette në lokacionin e projektit apo afër tij. Gjatë charrette, ekipi së pari mbanë një takim të hapur publik për t’i diskutuar vlerat, vizionin dhe nevojat e palëve të interesit. Ekipi pastaj vazhdon me krijimin e planeve alternative, testimin dhe rafinimin e tyre me qëllim të prodhimit të një plani të preferuar. Charrette gjithashtu përfshinë organizimin e disa takimeve për mbajtjen e mendimeve ‘në rreth’ ku palët e interesit angazhohen në pika vendimtare të vendim-marrjes. Këto pika ndodhin gjatë takimeve primare me palët e interesit, takimeve publike dhe seanceve të hapura gjatë vazhdimit të charrette. Këta ‘rrathë’ të marrjes së mendimeve ekipi charrette i siguron informatat e nevojshme për të krijuar një plan të zbatueshëm. Gjithashtu është e rëndësishme që ata rrathë ua mundësojnë palëve të interesit që të bëhen bashkautor të planit në mënyrë që ata ta mbështesin dhe ta zbatojnë atë. Charrete duhet të zgjatë së paku katër ditë për projektet më të thjeshta, dhe gjashtë deri

në shtatë ditë për ndonjë projekt standard, për t’i akomoduar rrathët e nevojshëm të marrjes së mendimeve (shihni ilustrimin). Në disa raste janë organizuar procese të suksesshme të cilat kanë zgjatur edhe më pak se katër ditë të njëpasnjëshme, ku zakonisht charrette më të gjata ndahen në disa organizime treditore me rreth një muaj në mes. Marrëveshja e gjatë bazohet në dialog të informuar mirë, që mund të arrihet vetëm duke i shikuar njëkohësisht hollësitë dhe gjendjen e përgjithshme. Studimet e bëra gjithashtu shërbejnë për informim dhe ulje të mundësisë së mosvërejtjes së ndonjë të metë fatale në plan. Për të krijuar një plan të zbatueshëm, çdo pikë e vendimit duhet të jetë e pajisur mirë me informata, në veçanti nga disiplinat juridike, financiare dhe inxhinierike. Përqendrimi në zbatueshmëri të planit i sjell procesit një nivel të seriozitetit dhe rigorozitetit për secilin që është i përfshirë. Projektimi është mjet i fuqishëm për krijimin e një vizioni të përbashkët. Vizatimet tregojnë ndërlidhshmërinë e problemit dhe mund të përdoren për zgjidhjen e konfliktit përmes propozimit të zgjidhjeve që nuk janë hulumtuar më parë që përfaqësojnë rezultate të fitimit nga të dyja anët. Përmbledhja e projektimit, një pako e udhëzimeve që i jepet ekipit të projektimit, është komponentë kyçe e charrette. Ajo ofron aspektet e bazës së politikës dhe kornizës juridike, të kushtet specifike numerike, komunikon mundësitë dhe kufizimet, përmban rregulla për hartimin e synimeve, objektivave, caqeve dhe supozimeve, rregulla për projektim (ngjyrat, simbolet, etj.), metodat për angazhimin e një vargu të gjatë të palëve të interesit dhe qartësimin e ‘rregullave të lojës’.

“Charrette”/Punëtorja për planifikim e ndryshme nga punëtorja e vizionimit

Charretet shpeshherë ngatërrohet me punëtorinë për vizionim. Sipas *Institutit Nacional të Charrette*, institucion arsimor jofitim-prurës në Portland, SHBA, punëtorja apo sesioni për vizionim e përgatitë komunitetin për charrette:

- Ngjashëm si me punëtoritë për vizionim, charrette është vull kreativ i energjisë që përshepton ndonjë plan apo projekt dhe e vë atë në rrugë drejt përmbushjes së synimeve.

- Përderisa punëtoritë e vizionimit zakonisht përqendrohen në pamjen e përgjithshme (të një zone të caktuar të planifikimit), strategjia e charrette të planifikimit është përqendrimi në pamjen e përgjithshme si dhe në hollësitë e ndonjë plani apo projekti për të dalë me një marrëveshje bashkëpunuese mes palëve kryesore të interesit rreth synimeve, strategjive specifike dhe në prioritetet e projektit.
- Përderisa punëtoritë e vizionimit zakonisht përqendrohen në gjenerimin e ideve dhe të vizioneve nga pjesëtarët e komunitetit që nuk janë ekspertë të planifikimit, charrette të planifikimit zakonisht përbëhen prej ekipeve eksperte të planifikimit ku ka vend për të gjitha palët e interesit të përfshira, përfshirë këtu edhe banorët e komunitetit.
- ‘Charrette e planifikimit’ ka pak të bëjë me ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve dhe ka më shumë të bëjë me shfrytëzimin e kapaciteteve dhe të asistencës dhe performancës teknike.
- Ngjashëm me punëtoritë e vizionimit, ‘charrette për planifikim’ ka më së shumti sukses kur ajo zgjatë më shumë ditë, zakonisht së paku katër ditë, por shpesh edhe më gjatë deri në shtatë ditë, duke lënë mjaft kohë për të përfunduar tërë ciklin e planifikimit (shihni praktikën diku tjetër). Sa më i ndërlikuar të jetë problemi, aq më e gjatë do të jetë charrette.
- Përderisa punëtoritë e vizionimit mund të mbahen (shumë) larg nga lokacioni, ‘charrette të planifikimit’ zakonisht mbahen në lokacion apo afër tij. Puna në lokacion i shton njohuritë e ekipit të projektuese rreth vlerave dhe traditave lokale, dhe iu ofron palëve të interesit qasje të lehtë dhe informata. Andaj, studio e planifikimit apo e projektimit duhet të jetë e vendosur në një vend që është lehtë për t’u qasur nga të gjitha palët e interesit dhe ku projektuesit me lehtësi mund të kenë qasje në lokacionin e projektit.
- Përderisa punëtoritë e vizionimit mund të përfundojnë me shumë ide dhe vizione (tematike) të ndryshme, charrette e planifikimit duhet të përfundojë me një vizion dhe dizajn të integruar për zonën specifike apo për projektin.

- Përderisa punëtoritë e vizionimit mund të lejojnë të menduarit e lirë, të papenguar nga planet apo rregulloret ekzistuese, ‘charrette e planifikimit’ duhet të punojë brenda një kornize të caktuar të planifikimit dhe juridike (si pjesë e përmbledhjes rreth planifikimit), ndonëse ajo mund të rekomandojë ndryshime dhe amandamente për kornizën në fuqi.

Pavarësisht dallimeve substanciale, prapë se prapë ka mjaft ngjashmëri mes organizimit dhe mbajtjes së punëtorive të vizionimit dhe të charrette të planifikimit. Andaj, teksti kryesor i kësaj shtojce do të përqendrohet vetëm në karakteristikat shtesë të charrettes të planifikimit.

Burimet e nevojshme

- Facilitatorët e projektimit (norma e rekomanduar prej 1:6 në relacion me palët e interesit)
- Përmbledhje gjithëpërfshirëse e projektimit, përfshirë dokumente përkatëse të politikave
- Lista e takimeve (lista e emrave), etiketa të emrave
- Harta bazike me shkalla të ndryshme, letër paus (e tejdukshme)
- Fletore, notes, lapsa, shënues (marker), furça të ngjyrës, thumba, ngjitës plastike,...
- Fotografi nga vendi i zgjedhur
- Procesverbal zyrtar për takimet
- Mendje të hapura

Rastet e sugjeruara për charrette të planifikimit në Kosovë

- Vendbanime joformale (me kusht që të ketë financim në dispozicion për zbatim)
- Qendra e lëvizshmërisë
- Plani menaxhimit për lokacionet dhe zonat me trashëgimi kulturore dhe/apo natyrore
- Projekte të investimeve kapitale
- Plane rregulluese
- Plane të rigjenerimit për qendrën (historike) të qytetit

SHTOJCA 17

SHTËPIA E VIZIONIMIT

Projekti i dytë strategjik i *Strategjisë për vizionimin e së ardhmes* (shihni kapitullin 6) është themelimi i një shtëpie të vizionimit. Kjo qendër qytetare mund të emërohet në mënyra të ndryshme. Në Evropë dhe në vende të tjera ka shumë qendra për angazhime qytetare të cilat shërbejnë si burime të inspirimeve. Një qendër e tillë është edhe *Instituti evropian për pjesëmarrje publike* (www.participationinstitute.org), organizatë kjo gjermane relativisht e re dhe jofitimprurëse, e cila ka filluar veprimtarinë në vitin 2009, dhe organizata më e vjetër e Shteteve të Bashkuara 'Lidhja qytetare nacionale – Në ndihmë të komuniteteve që nga viti 1894' (www.ncl.org). Instituti evropian së fundmi ka botuar *Public Participation in Europe - An International Perspective – Pjesëmarrja publike në Evropë - Perspektivë ndërkombëtare*, studim ky i cili e përshkruan gjendjen aktuale të pjesëmarrjes publike në Evropë, duke u fokusuar në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe Italinë. Lidhja amerikane civile nacionale është organizatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 1894 "për të diskutuar të ardhmen e qyteteve amerikane". Lidhja "parasheh një vend ku qytetarët në mënyrë aktive janë të angazhuar në procesin e vetëqeverisjes dhe ku ata punojnë në partneritet me sektorët publikë, privatë dhe jofitimprurës të shoqërisë, dhe ku qytetarët krijojnë kulturë aktive qytetare që pasqyrojnë diversitetin e zërave të komunitetit." Ky vizion i pjesëmarrjes civile mund të lexohet në *Community Visioning and Strategic Planning Handbook – Doracakun e vizionimit të komunitetit dhe të planifikimit strategjik*, të botuar në vitin 2000 nga shtypi i Lidhjes civile nacionale. Aktiviteti i parë prej shtatë aktiviteteve kyçe të prezantuara në faqen e tyre të internetit është "dhënia e ndihmës për t'u mundësuar që të ëndërroni dhe krijoni një vizion të përbashkët dhe një plan veprimi të arritshëm". Meqë SHBA-ja është model i rëndësishëm për shumë kosovarë të rinj, kjo lidhje mund të frymëzojë themelimin e një organizate të ngjashme jofitimprurëse në Kosovë, normalisht shumë më modeste në fillim. Gjithashtu, nga kjo lidhje mund të kërkohet edhe mbështetje, më së miri së bashku me organizata të ngjashme nga Evropa, siç është për shembull Instituti Evropian. Aspiratat shumëkulturore dhe shumetnike të vendit duhet të pasqyrohen në vizionin dhe misionin e Shtëpisë së vizionit të Kosovës, si dhe në personelin dhe menaxhuesit e saj, i cili duhet të jetë plotësisht vendor për të siguruar një kujde-

stari vendore. Shembulli i Trashëgimisë kulturore pa kufij (shihni shtojcën 1) e ilustron këtë si opSION të mundshëm.

Shtëpia e Vizionit duhet të jetë më shumë se një organizatë tjetër jofitimprurëse apo joqeveritare. Kjo mund të bëhet 'shtëpi' dhe 'kafene'. Shtëpi e projektuar të shërbejë për vizionimin e komunitetit, e cila do t'i ofrojë hapësirat e nevojshme

punuese për vizionim dhe pajisjet e plotë të shkollës së vjetër dhe të 'kohëve të reja', duke filluar me notesa dhe 'skica'. Si kafene ajo do të ofronte vende për të diskutuar, vlerësuar, sjelle risi, iniciuar dhe eksperimentuar me mjete dhe teknika të ndryshme të angazhimit dhe përfshirjes qytetare: kafene në kuptimin e vërtetë dhe virtual (shih katrorin). Shtëpia e vizionit duhet të mirëpresë çdo qytetarë por politikant e partive duhet t'i mbajë në prag. Shtëpisë do t'i nevojitet një kod i fuqishëm i mirësjelljes për të vendosur kufij të qartë të cilët nuk mund të kalohen pa rrezikuar kredibilitetin e një qendre të pavarur qytetare. Financimi nga qeveritë e nivelit lokal dhe qendror duhet të kushtëzohet në mënyrë të qartë në kodin etik. Më e rëndësishme sesa të jetë një zyrë e mirë është punësimi dhe trajnimi i trajnerëve dhe facilitatorëve. Një grup themelor embrion prej 2 apo 3 facilitatorëve mund të trajnohet jashtë Kosovës, por të gjithë të tjerët duhet të trajnohen dhe të certifikohen brenda vendit. Grup themelor i punonjësve me orar të plotë mund të zgjerohet me ofrues privatë të shërbimeve të cilët janë të trajnuar dhe të certifikuar.

Shtëpia e vizionit duhet të jetë e pavarur nga organizatat ekzistuese vendore dhe ndërkombëtare, por qëndrueshmëria e saj do të varet shumë nga themelimi i marrëdhënieve të mira punuese me të gjitha palët relevante të interesit dhe klientët potencialë, siç janë komunat. Gjithashtu duhet të ekzistojë mundësia e



‘mbështetjes së avokimit’, që do t’iu ndihmojë komuniteteve në nevojë me fitime financiare, për shembull në vendbanimet e varfra joformale të cilat janë të privuara nga funksionet themelore urbane dhe sociale. Përmes zhvillimit të përvojave të veta, ‘Shtëpia e vizionit’/‘Kafeneja e botës’ gradualisht do të zhvillohet në një qendër të dokumentimit, një qendër informatike dhe qendër të mediave/marrëdhënieve me publikun. Ajo jo vetëm që do të ndihmojë me organizimin e punëtorive për vizionim, por edhe të konferencave, udhëtimeve studimore, seancave të trajnimeve, debeteve në media, debeteve elektronike, dhe sondazheve; si dhe do të botojë media të shtypura dhe virtuale (libra, artikuj, faqe të internetit, bloge (faqe interneti për diskutime), etj. Shtëpia e vizionit duhet të formojë lidhje të fuqishme me sektorin e arsimit (nga shkollat fillore deri tek universitetet), por pa u bërë pjesë e tij.

Një mënyrë e mirë për të hulumtuar atë se sa është i dëshiruar themelimi i një Shtëpie të vizionit, dhe sa e qëndrueshme do të ishte ajo, është përmes organizimit të një punëtorie për vizionim. Organizatat partnere të dhjetë punëtorive të vizionimit nga komuniteti duhet t’iu bëjnë ftesë publike shoqërisë civile të Kosovës për të menduar rreth idesë si dhe të mbajnë një punëtori shumëditore për të hartuar një deklaratë të përbashkët të vizionit dhe të misionit, përfshirë dizajnin e vizionit të ‘Shtëpisë së vizionit’/‘Kafenesë së botës’. ‘Charrette e planifikimit’ mund të nevojitet për të përgatitur një plan të hollësishëm (të punës), të gatshëm për zbatim të menjëhershëm.

KAFENEJA BOTËRORE

Kosova nuk është e njohur vetëm për makiatot, por është edhe më e njohur për bisedat që zhvillohen gjatë pirjes së kafesë. Ditëve të sotme, kafeja është larg të qenit e vetmja pije që konsumohet nëpër kafene dhe bare, por kultura e bisedimit nuk ka ndryshuar. Andaj, angazhimi civil do të ishte më i suksesshëm në ndonjë kafene të gjallëruar sesa në ndonjë sallë komunale të lënë pas dore. Kafeneja botërore, metodë kjo globale e pjesëmarrjes do të mund të integrohej mirë në kulturat lokale të Kosovës dhe të Ballkanit më gjerë. Kafeneja botërore është metodologji inovative por e thjeshtë për zhvillimin e bisedave rreth çështjeve që janë të rëndësishme. Këto biseda lidhen dhe zhvillohet nga lëvizjet e personave nëpër grupe, nga pasurimi i ideve dhe nga zbulimi i kuptimeve të reja rreth pyetjeve apo çështjeve më të rëndësishme në jetën e tyre, punën apo komunitetin. Si proces, kafeneja botërore mund të vë në pah inteligjencën kolektive të ndonjë grupi, duke i shtuar kështu kapacitetet e personave për veprime efektive në kërkim të synimeve të përbashkëta.

- Teksti dhe kornizat e internetit nga: www.theworldcafe.com



SHTOJCA 18

TERMAT E REFERENCËS PËR KËSHILLIN JOFORMAL TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

SFONDI

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal mbështet gjashtë qytete sekondare në Kosovë në hartimin e planeve zhvillimore komunale e urbane, derisa ndjek qasjen e cila vë theks të veçantë në pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme sociale dhe etnike në proces. Që procesi të jetë i suksesshëm, organizatat e shoqërisë civile dhe zyrtarët komunalë duhet të kuptojnë dobinë e një bashkëpunimi të tillë, dhe të pajtohen mbi parimet që do të udhëheqin bashkëpunimin e tillë.

Themelimi i Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile është hap vijues në proces, dhe është vazhdim i takimeve të mëhershme me zyrtarët komunalë që merren me organizatat e shoqërisë civile, promovimin e bashkëpunimit me to gjatë Konferencës Rajonale mbi Qeverisjen e Mirë dhe punëtoritë orientuese për organizatat e shoqërisë civile.

Ideja prapa ndërtimit të Këshillave Joformalë të Organizatave të Shoqërisë Civile është që të përafrojmë shoqërinë civile dhe qeveritë lokale më afër në përpjekjet e tyre të përmirësimit të cilësisë së jetës në komunat dhe qytetet e tyre. Pritet që me përafrimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe qeverisë lokale, ky bashkëpunim do të zyrtarizohet përmes një deklarimi të bashkëpunimit mes partnerëve, në formë të shkruar apo gojore, duke e kthyer Këshillin në një organ këshillues për qeverinë lokale mbi çështjet e qeverisjes lokale, duke përfshirë ndihmën në zbatimin e projekteve që dalin nga procesi i planifikimit.

PËRBËRJA

Këshilli Joformal i Organizatave të Shoqërisë Civile do të jetë i hapur për një gamë të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve që duan të marrin pjesë vullnetarisht në proces.

DETYRAT

Detyrat e Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile do të synojnë promovimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në debatet publike, seancat e shqyrtimit publik dhe forma të tjera të komunikimit mes qytetarëve dhe qeverive lokale, me qëndrimin e përforcimit të dialogut mes palëve, si dhe kontribuimin drejt një pjesëmarrjeje të rritur të shoqërisë civile në ndërtimin e pajtueshmërisë dhe proceset vendim-marrëse.

These will include, but will not be limited to, the following

- Promovimin e konceptit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në komunikim me qeveritë në frymën e bashkëpunimit dhe mbështetjes, si dhe zgjidhjen konstruktive të dallimeve,
- Ndihmën ndaj qeverive lokale për të mobilizuar pjesëmarrjen civile në debatet, shqyrtimet e konsultimet urbane, si dhe format tjera të dialogut,
- Inicimin e takimeve, përmes bashkëpunimit me qeveritë lokale, mbi çështjet që janë jetike për komunën dhe banorët e saj,

- Mundësimi i pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në planifikimin strategjik përfshirës dhe procesin e hartimit të politikave në komunë,
- Mbështetja dhe pjesëmarrja aktive në aktivitete që synojnë fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve për të marrë pjesë në konsultime të caktuara urbane dhe takime konsultuese për planifikimin dhe formulimin e politikave zhvillimore, si dhe ndihma në mundësimin e këtyre takimeve,
- Mbështetja e themelimit të mekanizmit të qëndrueshëm të bashkëpunimit mes organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisë lokale,
- Në bashkëpunim me pjesëmarrësit tjerë, bashkë me komunitetin afarist, ndihmë në identifikimin e prioriteteve për zhvillimin komunal dhe mbështetje aktive për zbatimin e tyre.

DOBITË

Anëtarët e Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile do të ftohen të marrin pjesë në punëtori, seminare dhe ngjarje tjera të synuara për përforcimin e kapaciteteve të OSHC-ve në kuptimin e proceseve të zhvillimit lokal.

Anëtarët e këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile do të kenë mundësi të lidhen në rrjet me anëtarët e organizatave tjera në Kosovë e rajon,

Anëtarët e Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile do të kenë rregullisht Buletinin e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal dhe do të ftohen të kontribuojnë në prodhimin e tij.

REFERENCAT

Acioly C. Jr a.o., 2006, "Knocking at the Mayor's Door. Participatory Urban Management in Seven Cities/Trokitja në derën e kryetarit të komunës. Menaxhimi urban me pjesëmarrje në shtatë qytete.", Eburon Delft

Albrechts L., 2010, "More of the same is not enough! How could strategic spatial planning be instrumental in dealing with challenges ahead?," in Environment and Planning: Planning and Design/ "Më shumë prej kësaj nuk mjafton! Si mund të jetë planifikimi hapësinor strategjik i rëndësishëm për trajtimin e sfidave të ardhshme?" Mjedis dhe planifikimi: Planifikimi dhe projektimi, vëllimi 37, fq.1115-1127

Arnstein S. R., 1969, "A Ladder of Citizen Participation/Shkallë e pjesëmarrjes qytetare," JAIP, vëllimi 35, nr. 4., 1969

Chambers C., 2004, "Participatory Workshops. A sourcebook of 21 sets of ideas & activities/Punëtoritë me pjesëmarrje. Burim i 21 pakove të ideve & aktiviteteve.", Earthscan ISBN 1-85383-862-4

Ministria e Danimarkës për Punë të Brendshme dhe Çështje Sociale, 2009, "Active Cultural Heritage in Urban and Rural Development/Trashëgimi aktive kulturore në zhvillimin urban dhe rural"

D'hondt F., 2008, "Re-Creating Kosovo Cities /Rikrijimi i qyteteve të Kosovës", Botim nga Isocarp, konferenca e 42-të e Isocarp 2008

D'hondt F., 2011, "The Transitional City. Post-conflict Kosovo and 'The New Charter of Athens/Qyteti në tranzicion. Kosova pas konfliktit dhe 'Karta e re e Athinës", që do të publikohet në Built Environment 2011

ECTP/CEU, 2002, "Try It This Way. Sustainable Development at Local Level/Provojeni kështu. Zhvillimi i qëndrueshëm në nivelin lokal". Këshilli evropian i planifikuesve të qyteteve, Udhërrëfyes për planifikuesit hapësinorë.

ECTP/CEU, 2003, "Karta e re e Athinës. Këshilli evropian i planifikuesve të qyteteve, Vizioni i planifikuesve të qyteteve për qytetet e shekullit 21."

Iniciativa Evropiane për Stabilitet, 2006, "Vizionet utopike, Dështimet e qeverisjes në kryeqytetin e Kosovës", Dokument për diskutim, qershor 2006

Iniciativa Evropiane për Stabilitet, 2006, "A Future for Prishtina's Past/Një e ardhme për të kaluarën e Prishtinës"

Green G., Haines A., Halebsky S., 2000, "Building Our Future: A Guide to Community Visioning/Ndërtimi i së ardhmes sonë: Udhërrëfyes për vizionim nga komuniteti", manuali për planifikim & projektim nga komuniteti

Hirt S., Stanilov K., 2009, "Revisiting Urban Planning in the Transitional Countries/Rivizitimi i planifikimit urban në shtetet në tranzicion", www.unhabitat.org/grhs/2009

Hough B., "A Practical Guide to Conducting a Successful Design Charrette/Udhëzim praktik për mbajtjen e një charrette të suksesshme për dizajnim", www.rexroadapg.com.

Innes J.E., Booher D.E., 2004, "reframing Public Participation: Strategies for the 21st Century/Rimodelimi i pjesëmarrjes pub-

like: Strategjitë për shekullin 21", in Planning Theory & Practice/ në Teorinë dhe praktikën për planifikim, vëllimi 5, nr. 4, f. 419-436

Landry C., 2002, "The Creative City. A Toolkit for Urban Innovators/Qyteti kreativ. Mekanizëm për novatorët urbanë.", Comedia-Earthscan

Lindsey G., Todd J.A., Hayter S.J., 2003, "A Handbook for Planning and Conducting Charrettes for High-Performance Projects/Doracak për planifikimin dhe mbajtjen e charrette për projekte të rëndësishme", NREL

Ludeking G., "Inclusive and strategic planning for Kosovo/ Planifikimi gjithëpërfshirës dhe strategjik për Kosovën", UN-Habitat

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, "Plani hapësinor i Kosovës 2010-2020+" (Draft 2006/2010)

Lidhja civile nacionale, 2000, "The Community Visioning and Strategic Planning handbook/Doracaku i vizionimit nga komuniteti dhe planifikimi strategjik, Denver, Kolorado

Poblet R., Mitchel N., 2009, "The Challenges of Spatial Planning in a Divided City: Mitrovica/Sfidat e planifikimit hapësinor në një qytet të ndarë: Mitrovica", në Dialog 101, A Journal for Planning and Building in the Third World/Gazetë për planifikim dhe ndërtim në botën e tretë, 2/2009

Slocum N., "Participatory Method Toolkit. A practitioner's manual/Mekanizëm i metodës pjesëmarrëse.", United Nations University

The Community Partnership, "The Community Planning & Design Handbook. The Power of Ideas/Partneriteti i komunitetit, "Doracaku për planifikim dhe projektim nga komuniteti. Fuqia e ideve."

Tofaj F., Gashi L., Jaha T., Toska E., Bakija D., 2010, "A është Juniku unik /Is Junik unique? Devising planning policy documents 'in-house/Përgatitja e dokumenteve të politikave të planifikimit brenda vendit", CORP2010

UNCHS, Building Bridges through Participatory Planning - Part 1/Ndërtimi i urave përmes planifikimit me pjesëmarrje – pjesa 1

UNDP, 2008, "Civil Society & Development. Human Development Report Kosovo 2008/Shoqëria civile & zhvillimi. Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2008.",

UN-Habitat, K.U.Leuven-PGCHS, 2004, "Urban Dialogues: Localizing Agenda 21/Trialogjet urbane: Lokalizimi i agjendës 21"

UN-Habitat, 2007, "Inclusive and Sustainable Urban Planning: A Guide for Municipalities/Planifikimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm urban: Udhërrëfyes për komunat.", vëllimi 1-4, ISBN 978-92-1-132024-4

Wates N., 2000, "The Community Planning Handbook. How people can shape their cities, towns and villages in any part of the world/Doracaku për planifikim nga komuniteti. Si mundën individët t' i formësojnë qytetet, qytezat dhe fshatrat e tyre në cilëndo pjesë të botës.", Earthscan ISBN 1-85383-654-0

BURIMET E FJALORTHIT

Ministria e Danimarkës për Punë të Jashtme, "Udhërrëfyesit për menaxhimin e ndihmave. Hague, C., Wakely, P., Crespin, J., Jasko C., 2006, "Making Planning Work – A Guide to Approaches and Skills/ Funksonalizimi i planifikimit – Udhërrëfyes për qasje dhe aftësi"

Udhërrëfyesi për Planifikim Komunitete të Qëndrueshme (2007)

Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), "Fjalorthi"

www.thefreedictionary.com

www.udg.org.uk

www.wikipedia.org

www.wiktionary.org

www.allbusiness.com

www.answers.com

www.communityplanning.net

www.communitiesscotland.gov.uk

Vizionimi është një vegël e fuqishme e planifikimit që bashkon palët e ndryshme të interesit, për të projektuar zhvillimin e ardhshëm. I përdorur në një shoqëri të post-konfliktit, vizionimi ka potencial për tejkalimin e konflikteve etnike dhe sociale. Ndjeshmëria ndaj nevojave specifike të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, të aftëve dhe të paaftëve, të vendosura në një sfond të pajtimit, i shton vlerë një vizioni për një qytetin, qytezën apo lagjen.

Ky botim synon të frymëzojë dhe të inkurajojnë planifikuesit lokalë, politikanët, shoqërinë civile dhe të gjitha mediat që duke përdorur vizionimin, të angazhohen në projektimin e të ardhmes së vendbanimeve njerëzore në një mënyrë bashkëpunuese.

HS Number: HS/084/12

ISBN Number: 978-92-1-132498-3

UNITED NATIONS HUMAN SETTLEMENTS
PROGRAMME

P.O.Box 30030, Nairobi 00100, Kenya;

Tel: +254-20-7623120;

Fax: +254-20-76234266/7 (Central Office)

infohabitat@unhabitat.org